



RAPORT VJETOR 2025


PËRMBAJTJA

01	FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM	FAQE/ 04
02	PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS	FAQE/ 06
03	KËSHILLI DREJTUES	FAQE/ 08
04	DIVIZIONI I ZHVILLIMIT TË BIZNESIT	FAQE/ 16
05	DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE	FAQE/ 04
06	QEVERISJA KORPORATIVE	FAQE/ 04
07	RAPORTI I AUDITORËVE	FAQE/ 06

FJALA E
DREJTORIT
TË PËRGJITHSHËM

D1

Credins Online



Mos lëviz nga vendi!
Paguaj faturat nga kudo që je.

Performanca e një viti të suksesshëm në Credins Bank!

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm

Credins bank përmbylli një vit jo thjeshtë të suksesshëm financiar por mbi të gjitha duke ju përshtatur edhe risive të tregut si dhe duke qenë pararojë me kërkesat dhe dëshirat e klientëve të saj. Me dëshirën dhe ambicjen për të qenë gjithmonë zgjedhja e shqiptarëve, ky vit e ka shoqëruar Credins edhe me shumë arritje të rëndësishme, që forcojnë çdo vit e më shumë pozitë e Credins bank.

Projektet e rëndësishme të bankës, kanë qenë të fokusuar kryesisht në rrugën drejt zhvillimit dhe përmirësimit të infrastrukturës digjitale. Implementimi me sukses i skemave të pagesave SEPA dhe përafrimi me standardet europiane të pagesave, ishin një nga prioritetet e Credins për vitin 2025.

Tradicionalisht përmes strategjisë së ndjekur, Credins edhe këtë vit ka një pozicionim të fuqishëm në sektorin bankar, duke vijuar të qëndrojë sërish e para për portofolin e kredive dhe e dyta për totalin e aktiveve, totalin e depozitave, për portofolin e investimeve në tituj, si dhe në tregues të tjerë financiarë.

Gjithashtu, kreditimi ka vijuar të jetë një nga motorët kryesorë të rritjes. Me mendësinë e një banke që kërkon të japë eksperiencën më të mirën, Credins, vijon të pozicionohet si lider në aktivitetin e kredihënies duke zgjeruar portofolin e saj të kredisë me 8.5 % krahasuar me vitin e kaluar. Fokusi ynë ka qenë mbështetja e sektorëve të rëndësishëm për ekonominë shqiptare si: turizmi, bujqësia, energjia etj. Kemi qenë pranë klientëve individë dhe bizneseve të vogla e të mesme, duke i këshilluar me kujdes dhe plotësuar nevojat e tyre në kohë tepër të

shkurtër dhe me procedurë të lehtësuara. Krahas treguesve financiarë pozitivë, banka zgjeroi bazën e klientëve të saj duke shënuar një numër prej 414,099 klientësh me një rritje prej 4.0 % krahasuar me një vit më parë. Credins sot numëron një rrjet shumë të gjerë degësh, aktualisht 52 degë dhe 99 ATM të vendosura në çdo qytet të Shqipërisë duke qenë pranë çdo klienti.

Një element tjetër kyç gjatë vitit 2025 ishte vazhdimi i investimeve në transformimin digjital. Numri i klientëve në platformën Credins Online arriti mbi 78 % të totalit të klientëve. Numri i transaksioneve në POS-e u rrit me mbi 31% krahasuar me vitin 2024. Rritje shënoi gjithashtu edhe numri i transaksioneve dhe volumit në ATM me 11% krahasuar me vitin 2024. Credins, si një bankë me rëndësi sistemike në sektor, ka luajtur një rol të rëndësishëm në zbatimin e strategjisë kombëtare të

promovimit dhe zgjerimit të pagesave elektronike në vend, duke përdorur bazën e gjerë të klientëve të saj. Implementimi i skemave të pagesave SEPA pritet të sjellë një rritje të efikasitetit në pagesa, dhe volume të rritura të pagesave elektronike.

Në aspektin financiar, përfitueshmëria e bankës mbeti e qëndrueshme, e mbështetur kryesisht nga të ardhurat nga interesat megjithëse e ndikuar nga luhatjet e kursit të këmbimit apo edhe të forcimit të monedhës Lekë, duke kërkuar një menaxhim më aktiv të bilancit.

Me kulturën e një biznesi ambicioz dhe avangard për shërbimet dhe produktet që ofron, Credins ka punuar jashtëzakonisht në infomimin dhe ndërgjegjësimin e audiencës për përdorimin e produkteve bankare, përmes teknologjisë. Fushatat e ndryshme të realizuara në shumë kanale komunikimi, kanë qenë jo vetëm informuese, por edhe shumë inkurajuese për klientët mbi përdorimin e kartave si instrument pagese, ose kanaleve të tjera digjitale. Credins ndër vite ka konsoliduar edhe staretëgjini e komunikimit përmes fushatave dhe eventeve dinamike të ndjekura 360 gradë, duke gjetur mekanizma të ndryshme ndërveprimi dhe komunikimi me klientët, koherente edhe me kohët moderne. Në këtë aspekt, dua të theksoj se tashmë fushatat, të cilat janë pasuruar vit pas viti, nuk kanë për qëllim thjeshtë për të reklamuar një produkt apo shërbim, por mbi të gjitha t'ju vijmë në ndihmë klientëve

tanë në tërësinë e stilit të jetesës, të cilët na kanë besuar për 23 vite. Credins gjithashtu vazhdon të ketë një vizion të qartë mbi mbështetjen për shumë projekte dhe nisma me impakt pozitiv duke ndihmuar komunitetin përmes projekteve të ndryshme si arti, arsimit, sporti, teknologjia, turizmi, etj. Jam krenar të shpreh se Credins nuk është vetëm banka që ofron shërbime financiare, por një institucion që ndërton marrëdhënie të qëndrueshme mbi besimin, ndjeshmërinë dhe përgjegjësinë ndaj shoqërisë. Ne besojmë se suksesi nuk matet vetëm me rezultate financiare, por me ndikimin real në komunitetin ku operojmë. Përmes një qasjeje empatike të ndërtuar ndër vite, jemi pranë çdo individi, duke reflektuar vlerat tona në çdo iniciativë. Kjo filozofi materializohet përmes angazhimeve tona në donacione dhe nisma sociale, të udhëhequra nga Fondacioni Credins dhe platforma Smile, të cilat synojnë të krijojnë njëkohësisht mundësi mbështetëse dhe integruese për komunitetin. Paralelisht me këtë angazhim social, ne kemi vendosur një fokus të qartë edhe tek transformimi digjital, si një shtyllë kyçe për zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje afatgjatë.

Në këtë kontekst, duke pasur parasysh se digjitalizimi është një trend me rritje eksponenciale në tërësinë e stilit të jetesës, padyshim që një nga transformimet më të rëndësishme prek edhe sektorin bankar. Megjithatë, eksperiencat ndërkombëtare tregojnë se ky proces nuk shoqërohet menjëherë me reduktimin e pranisë fizike të bankave. Në fazat e para të transformimit vërehet shpesh një bashkëjetesë e dy modeleve: zhvillimi i kanaleve digjitale bashkëkohore dhe, njëkohësisht, ruajtja e pranisë fizike në treg.

Në kontekstin e kulturës dhe traditës së vendit tonë, disa faktorë vijnë në ndihmë të ndërtimit të degëve fizike. Ekonomia shqiptare mbetet ende relativisht e bazuar në cash, pavarësisht reduktimit të tij në vitet e fundit si rezultat i politikave të ndërmarra nga qeveria shqiptare dhe Banka e Shqipërisë. Gjithashtu, klientët vazhdojnë të preferojnë kontaktin fizik me bankën, veçanërisht për produkte më komplekse si kreditë apo këshillimi financiar. Për këtë arsye, si për Credins ashtu edhe për sektorin bankar në tërësi, modeli hibrid po konsiderohet si një kombinim efektiv dhe i përshtatshëm për klientët. Në këtë drejtim, ndërsa kanalet digjitale përdoren kryesisht për transaksionet e përditshme, degët mbeten një komponent thelbësor si për ndërtimin e marrëdhënies me klientin, ashtu edhe për ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar. Megjithatë, ky ekuilibër pritet të evoluojë në vijim, në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe ndryshimin e sjelljes së klientëve. Kështu në një perspektivë afatmesme, pritët që struktura e rrjetit bankar të ndryshojë

gradualisht. Kjo do të ndodhë për shkak të disa zhvillimeve kryesore:

- Rritja e përdorimit të mobile banking dhe pagesave elektronike, sidomos nga gjeneratat e reja;
- Investimet në teknologji dhe automatizim, të cilat do të ulin nevojën për kryerjen e operacioneve manuale në degë;
- Integrimi me standardet dhe infrastrukturën europiane të pagesave, që nxisin përdorimin e kanaleve digjitale;


Në këto kushte, në vitet e ardhshme është e mundshme të shohim një transformim të rolit të degëve, nga degë tradicionale të transaksioneve bankare në qendra këshillimi financiar dhe shërbimi për klientët e tyre. Pra tranzicioni drejt një bankingu të digjitalizuar do të jetë gradual, edhe pse Credins e ka fuqizuar shumë aktivitetin digjital. Në të njëjtën kohë, ky transformim po zhvillohet paralelisht me një tjetër dinamikë të rëndësishme të tregut: rritjen e konkurrencës në sektorin bankar. Rritja e numrit të bankave në tregun shqiptar i cili është një zhvillim interesant, që e shton konkurrencën dhe njëherazi edhe ambicjen për të ofruar gjithmonë më të mirën për klientët, Credins vazhdon të ruaj pozita shumë të fuqishme në këtë treg. Hyrja e bankave të reja tregon se industria bankare vazhdon të jetë dominante për tregun shqiptar dhe një potencial në rritje, i mbështetur kryesisht nga disa faktorë: stabiliteti makroekonomik, rritja e kreditimit dhe nivelet relativisht të mira të kapitalizimit dhe likuiditetit të sistemit bankar. Megjithatë, në një perspektivë afatgjatë, është e mundshme që sistemi bankar të rikthehet sërish drejt një niveli më të lartë përqëndrimi. Kjo për disa arsye strukturore:

- Madhësia relativisht e vogël e tregut shqiptar, që kufizon numrin optimal të institucioneve bankare;
- Rritja e kërkesave rregullatore dhe të kapitalit, veçanërisht në kuadër të përafrimit me standardet europiane si kërkesë për integrimin në BE;
- Kostot e investimeve teknologjike dhe digjitalizimit të cilat, favorizojnë institucionet me shkallë më të madhe të operimit.

Për këtë arsye, hyrja e bankave të reja mund të interpretohet më shumë si një fazë dinamike e tregut, ku investitorë të rinj shohin mundësi për rritje dhe specializim

të asaj që ofrojnë, se sa si një ndryshim strukturor afatgjatë i modelit të tregut. Në këtë kuadër zhvillimesh, një nga treguesit më domethënës të evolucionit të sektorit mbetet edhe dinamika e kreditimit, veçanërisht në segmentet kyçe të tij. Kreditimi për pasuri të paluajtshme mbetet një nga segmentet më dinamike të kreditimit në vend. Aktualisht, kredia për blerje banesash përbën rreth 70% të kredive për individët, çka tregon peshën e madhe që ky segment ka në portofolin retail të bankave. Masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për kufizimin e kreditimit në këtë segment synonin forcimin e standardeve të huadhënies dhe uljen e rrezikut të mbingarkimit të familjeve me kosto të larta financimi. Megjithatë rritja e kreditimit në këtë segment ka vijuar e nxitur nga kërkesa e fortë për banesa dhe zhvillimi i tregut të pasurive të paluajtshme. Pavarësisht që kreditimi i këtij segmenti kërkon monitorim të vazhdueshëm për të siguruar cilësinë në kredidhënie, vlerësoj që rreziku mbetet i menaxhueshëm dhe cilësia e portofolit është e kënaqshme. Nga ana tjetër, është e rëndësishme të theksohet që kapitalizimi i sektorit bankar është i lartë dhe siguron amortizatorë të mjaftueshëm për të përballuar edhe skenarë më të pafavorshëm ekonomikë. Në këtë kontekst, ne si Credins mbetemi të fokusuar në një qasje të kujdesshme dhe të qëndrueshme ndaj rritjes së kreditimit, duke ruajtur

balancën midis zgjerimit dhe menaxhimit të rrezikut. Sfidat me të cilat sektori bankar pritet të përballet gjatë vitit 2026 do të jenë sërish zhvillimet teknologjike dhe investimet në kanalet digjitale. Pjesë e strategjisë sonë do të jetë fokusi në investime të vazhdueshme të përgjithshme të bankës dhe kryesisht në shërbimet digjitale. Implementimi me sukses i "Instant payment" do të shënojë një arritje të sektorit bankar ashtu si edhe implementimi i transfertave përmes sistemit SEPA, por sigurisht shoqërohet me kosto të ndjeshme implementimi dhe tkurrje të bazës së të ardhurave nga komisionet. Kërkesat rregullatore në rritje dhe përmbushja e limitit të ndërmjetëm të instrumenteve të kapitalit dhe detyrimeve të pranuara, i ka vendosur bankat e mëdha para nevojës për mbajtjen e treguesve të lartë të kapitalit rregullator duke krijuar presion mbi treguesit e përfitueshmërisë së bankave. Një tjetër projekt me rëndësi për sistemin raportues të bankave është implementimi i standardeve IFRS për të harmonizuar rregulloret e Bankës së Shqipërisë me kërkesat e raportimit sipas IFRS. Ndërkohë edhe siguria kibernetike përmes platformave teknologjike më të avancuara do të jetë sërish për Credins një nga prioritetet më të mëdha të investimeve tona.



MALTIN KORKUTI
Drejtore i Përgjithshëm

PËRGJEGJËSIA
SOCIALE E
KORPORATËS

02

Lounge
KEY



ÇDO UDHËTIM
KTHEJE NË PËRVOJË



CREDINS
BANK

Përgjegjësia Sociale e Korporatës

Credins bank,
një hap me kohën!

Credins bank, 22 vite evoluim!

Performanca financiare në rritje, është një nga elementet themelore dhe ambicioze për çdo institucion, por në një realitet të karakterizuar nga ritme të larta zhvillimi dhe kërkesash në evoluim të vazhdueshëm të shoqërisë në tërësi, nuk mjaftojnë më për të përcaktuar suksesin e një korporate. Diferenca krijohet nga aftësia apo gjetja e mekanizmave për të ndërtuar jo vetëm një vlerë të qëndrueshme por për të ditur të gjenerosh ndikim të matshëm në zhvillimin e shoqërisë. Ky transformim kërkon një rishikim të mënyrës se si institucionet konceptojnë rolin e tyre, duke kaluar nga modele tradicionale drejtimi drejt aftësive të reja që integrojnë gjithmonë e më shumë fleksibilitetin, inovacionin, kapacitetin për reagim të shpejtë ndaj ndryshimeve. Në këtë kuadër, institucionet që janë faktor dominues në ekonominë e një vendi mbartin njëherazi një përgjegjësi më të madhe dhe më impenjative, që shkon përtej funksionit të tyre tradicional. Kjo përgjegjësi materializohet në përfshirjen e angazhimeve sociale si pjesë tashmë thelbësore e modelit të zhvillimit, duke e kthyer ndikimin në komunitet në një standard jo thjesht të qëndrueshëm, por edhe të strukturuar mbi një strategji afatgjatë të institucionit.

Në këtë aspekt në vitin e 22-të të Credins bank, sfida jonë ka qenë të riformatojmë mënyrën e angazhimit, duke e drejtuar atë drejt një ndikimi më të strukturuar,

më të prekshëm dhe më të orientuar drejt progresit të shoqërisë. Angazhimi ynë nuk është fokusuar më vetëm në pjesëmarrje apo mbështetje të eventeve, por në ndërtimin e iniciativave që krijojnë vlerë të vazhdueshme. Me këtë dua të shpreh se orientimi ynë ka qenë edhe më selektiv, më i kuruar gjithashtu duke u orientuar drejt atyre iniciativave që krijojnë ndikim sa afatgjatë por edhe impakt të fortë e zhvillues. Paralelisht, kemi forcuar bashkëpunimet tona strategjike si me partnerët tanë kombëtar, ashtu edhe më shumë me ata ndërkombëtarë, duke marrë kështu nga përvoja e tyre. Jemi përpjekur të sjellim frymën e modeleve të ndryshme të përgjegjësisë sociale nga vendet e zhvilluara europiane. Kjo strategji e re ka sjellë një transformim në mënyrën sesi e konceptojmë përgjegjësinë



Kontributi ynë nuk është matur vetëm me numrin e aktiviteteve, edhe pse vazhdojmë të jemi shumë aktiv me mbi **170 aktivitete** për vitin që lamë pas, por mbi të gjitha me vlerën që ato gjenerojnë në çdo kohë.



MONIKA MILO
Zv. Drejtore e Përgjithshme

tonë korporative. Në këtë mënyrë, Credins bank vijon të ndërtojë një model angazhimi që nuk synon tashmë vetëm prezencën, por ndikimin konsistent dhe real në çdo kohë.

Angazhimi ynë nuk përkufizohet nga një formulë apo aksiomë e vetme veprimi, por materializohet në mënyrë të integruar në të gjithë ekosistemin tonë. Ai reflektohet në një sërë dimensionesh, që nga mënyra sesi konceptohen/dizenjohen produktet & shërbimet, tek vazhdimësia e fushatave shpërblyese, pjesëmarrja në evente & iniciativa me karakter social, e deri te mekanizmat që nxisin përfshirjen aktive të stafit, komunitetit, partnerëve, organizatave vendase dhe huaja, instancave shtetërore, duke u materializuar përmes programeve të dedikuara, kontributeve & dhurimeve, etj, të gjitha të integruara në një logjikë të unifikuar që synon të shumëfishojë ndikimin tonë. Në thelb për ne e gjithë kjo qasje strategjike përfaqëson një zhvendosje nga veprime të fragmentuara apo sporadike drejt një modeli konsistent, ku çdo iniciativë ndërtohet mbi ndikime pozitive që janë në koherencë edhe me vlerat tona si institucion. Kontributi ynë nuk është matur vetëm me numrin e aktiviteteve, edhe pse vazhdojmë të jemi shumë aktiv me mbi 170 aktivitete për vitin që lamë pas, por mbi të gjitha me vlerën që ato gjenerojnë në çdo kohë. Ajo që dua të shpreh është se jemi përpjekur të kemi iniciativa të strukturuar qartë duke bërë klasifikime sipas target-grupeve, fushave dhe kategorive të ndryshme, ku Credins mund të operojë. Kështu përgjatë vitit 2025, Credins përmes angazhimit social u fokusua në kontributin e disa shtyllave kryesore si:

Zhvillimi Ekonomik: Duke mbështetur sipërmarrjen dhe punësimin përmes produkteve financiare të aksesueshme dhe proceseve të thjeshtuara, si dhe zgjerim të vazhdueshëm të aksesit në financë si për individë ashtu edhe për biznese, duke kontribuar në këtë aspekt edhe në reduktimin e varfërisë.

Zhvillimi Social & Kulturor: Investime të ndryshme në arsim, shëndetësi, kulturë dhe projekte komunitare, në partneritet me organizata ndërkombëtare dhe vendase që sjellin ndikim afatgjatë për çdo target-grup.

Barazia & Gjithëpërfshirja: Nismat për fuqizimin e grave, luftën kundër diskriminimit dhe mbështetjen e grupeve

vulnerabël, edhe këtë vit kanë qenë në fokus tonë.

Kapitali Njerëzor: Fokus ynë i vazhdueshëm në zhvillimin profesional dhe mirëqenien e punonjësve, për një mjedis pune etik dhe gjithëpërfshirës përmes trajnimeve, orëve fleksibël verore, shpërblimeve etj, ashtu si çdo vit ishin në prioritet tona si bankë.

Investimet Mjedisore: Përmes mbështetjeve të ndryshme, që nga promovim mbi përdorimin e produkteve & shërbimeve digjitale bankare, investime në produktet "green" si dhe praktika që reduktojnë ndotjen e mjedisit dhe e pasurojnë me parqe/mbjellje pemësh, etj, ishin në axhendën tonë të përgjegjësisë sociale edhe për këtë vit.

Përmes kësaj filozofie dhe mënyrës sesi ne kemi implementuar të gjitha këto projekte, Credins ka arritur të pozicionohet tashmë si një markë me identitet të fortë dhe me një rol të qartë në zhvillimin e shoqërisë në 22 vite. Një rol që nuk mbështetet vetëm në kontribut financiar, por në aftësinë për të ndikuar, për të krijuar modele të qëndrueshme që i rezistojnë kohës duke sjellë praktika që i përgjigjen standardeve të vendeve të zhvilluara.

Aspirata për të mbajtur këtë nivel nuk lidhet me ruajtjen e status quo-së, por me vendosjen e një pritshmërie



Credins ka arritur të pozicionohet tashmë si një markë me identitet të fortë dhe me një rol të qartë në zhvillimin e shoqërisë në 22 vite. Një rol që nuk mbështetet vetëm në kontribut financiar, por në aftësinë për të ndikuar, për të krijuar modele të qëndrueshme që i rezistojnë kohës duke sjellë praktika që i përgjigjen standardeve të vendeve të zhvilluara.

gjithnjë e më të lartë për mënyrën se si operojmë dhe ndikojmë në komunitet, duke e trajtuar këtë si një proces të vazhdueshëm që i paraprin zhvillimit. Për Credins, kjo përkthehet në aftësinë për të evoluar me kohën dhe për të krijuar vlerë që ruan peshën dhe relevancën e saj në një mjedis në ndryshim të vazhdueshëm. Liderhipi ynë, si një korporatë që ka krijuar një impakt të padiskutueshëm ndër vite në komunitet, qëndron në aftësinë për të ridimensionuar vazhdimisht veten dhe për të ndërtuar versionin tonë më të mirë, në përputhje me dinamikën në zhvillim. Ambicia jonë është të materializojmë misionin dhe vizionin tonë në çdo hap të veprimtarisë/aktivitetit tonë, duke ndërtuar kështu një institucion që di t'i japë formë progresit dhe transformimit të shoqërisë.

KËSHILLI
DREJTUES

03



BAZUAR NË NGJARJE TË VËRTETË

Skano për
më shumë



Jori
DELLI

Heidi
BACI

Beniada
NISHANI

Mirupafshim PORTOFOL

iPhone juaj tani është karta juaj Mastercard.

Apple Pay e bën të thjeshtë çdo pagesë të përditshme me kartën tënde Credins. Pranohet në miliona pika shitjeje në mbarë botën, qoftë për një kafe në mëngjes, një blerje në supermarket pasdite, apo një darkë në restorantin tënd të preferuar. Mjafton të kërkosht logon Apple Pay ose simbolin contactless dhe kryen pagesën lehtësisht, shpejt dhe pa kontakt, kudo që ndodhesh.

© 2018 Apple Inc. Apple, iPhone, Apple Pay dhe Apple Pay logo janë shenja të Apple Inc. të regjistruara në SHBA dhe në vende të tjera. Mastercard dhe Mastercard logo janë shenja të Mastercard Inc. të regjistruara në SHBA dhe në vende të tjera. Credins Bank është një bankë e regjistruar në Kosovë. Të gjitha të drejtat rezervohen.

ELTON TORO
anëtar

JONAS HASSELROT
anëtar

RAIMONDA DUKA
anëtare

CLIVE MOODY
zv. kryetar

MONIKA MILO
anëtare

MALTIN KORKUTI
anëtar

SAJMIR SALLAKU
kryetar



DIVIZIONI I
ZHVILLIMIT
TË BIZNESIT

04



Telefoni yt tani
është karta jote Credins

Divizioni i Zhvillimit të Biznesit

Departamenti i Menaxhimit të Shitjeve në Degë

Viti 2025 përfaqësoi një fazë të rëndësishme konsolidimi dhe maturimi për rrjetin e degëve Credins, duke krijuar premisat e nevojshme për realizimin e objektivave të përcaktuara në përputhje me ndjekjen e strategjisë trevjeçare 2024 – 2026. Në një mjedis ekonomik dinamik dhe konkurrues, fokusi ynë mbetet i orientuar drejt forcimit të modelit të shërbimit me klientin në qendër, me synim rritje të qëndrueshme dhe cilësore, në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar. Gjatë vitit 2025 përqasja e stafit shitës në rrjetin e degëve përkrah rritjes numerike, u përqendrua edhe në ndërtimit të një performance të balancuar, ku ecin paralelisht, arritja e objektivave sasiore/cilësore dhe transformimi drejt inovacionit dixhital.

Objektivat e buxhetuara për rrjetin e degëve u realizuan në nivele të kënaqshme, përse i përket volumeve dhe evolucionit të portofolit të produkteve. Në terma shifrash, rrjeti i degëve realizoi objektivat sasiore dhe cilësore në shumicën e produkteve të bankës, mesatarisht në masën 99%. Shitjet e produkteve gjatë vitit 2025 rezultojnë mesatarisht 11% më shumë krahasuar me shitjet e produkteve të vitit të mëparshëm. Këto rezultate reflektojnë një angazhim të vazhdueshëm të rrjetit për të forcuar marrëdhëniet ekzistuese, për të zgjeruar bazën e klientëve dhe për të rritur penetrimin e produkteve ndaj klientëve nëpërmjet shitjes së kryqëzuar (cross sell).

Credins vijon të jetë banka e dytë në sistemin bankar për sa i përket totalit të depozitave të klientëve, duke shënuar

rritje të vazhdueshme vit pas viti me rreth 6.4%. Në rritjen e portofolit të depozitave të klientëve për total sistemin, rrjeti i degëve të Credins kryeson në marrjen e pjesës më e madhe të rritjes së tregut rreth 15.7%, duke konfirmuar besimin e klientëve dhe stabilitetin e modelit të biznesit. Kjo është arritur nëpërmjet adresimit ndaj klientëve të një shporte të gjerë produktesh, si edhe një shërbimi cilësor, profesional dhe të personalizuar për çdo klient të bankës, në përmbushje të vizionit të Credins bank "Të njihet si banka më e mirë në Shqipëri, e cila ofron të gjitha shërbimet, e klasifikuar si banka numër një për Shqiptarët!"

Portofoli i kredisë i gjeneruar nga rrjeti i degëve vijon të rritet në mënyrë të qëndrueshme, ku në mbyllje të vitit rezultoi me 10.8% rritje. Rritje të konsiderueshme kishte në portofolin e kredisë për Individë me 20.4% dhe në portofolin e kredisë për klientët Mikro me 21.6%. Rrjeti i degëve të Credins ka marrë rreth 9.1% të rritjes së kredisë retail të total sistemit. Vlen të theksohet që strategjia e Credins në ruajtjen e pozicionit të parë në kredidhënie në sistemin bankar, ka në fokus të veçantë rritjen e portofolit të kredisë dhe market share në retail.

Gjatë vitit 2025 u vendosën gjithashtu themelet për projekte strategjike inovatore që do të vijnë edhe në vitin 2026, në përputhje me drejtimin e transformimit dixhital të bankës. Zhvillim kyç për rrjetin


e degëve ishte implementimi i platformës CRM Creatio. Me anë të modulit 360° Client View ofrohet një pamje e plotë e profilin të klientit dhe produkteve, duke lehtësuar ndërveprimin dhe rritjen e efikasitetit të forcës shitëse në degë.

Në vitin 2026 është planifikuar implementimi i projektit Loan Origination, i cili synon automatizimin dhe standardizimin e procesit të aplikimit dhe aprovimit, reduktimin e kohës së procesimit, rrjedhimisht optimizimin e fleksibilitetit të kredidhënies ndaj klientëve. Ky projekt përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së efikasitetit operacionale dhe përmirësimit të eksperiencës së klientit, duke impaktuar në rritje të pozicionit të Credins për kredinë retail.

Për vitin 2026, stafi shitës në rrjetin e degëve, përkrah produkteve bankare si depozitat dhe kreditë, do të vijojë të ketë në fokus këshillimin e klientëve për produkte alternative, si Produktet e Investimeve, Produktet e Sigurimit, etj, së bashku me suportin e vazhdueshëm të klientëve për nxitjen e përdorimit të kanaleve dixhitale.

Cilësia e një shërbimi të shkëlqyer për klientët ruhet si një nga vlerat korporative themelore që na përfaqëson në çdo moment. Përmes optimizimit të proceseve, trajnimeve për rritjen e kompetencave të stafit dhe përfundimit të kulturës së bashkëpunimit, synohet ofrimi i një eksperience të qëndrueshme dhe profesionale në çdo pikë kontakti me klientin. Investimi në kapitalin njerëzor dhe në përmirësimin e proceseve operative do të kontribuojë drejtpërdrejt në arritjen e objektivave financiare, duke e shndërruar cilësinë në një avantazh konkurrues afatgjatë.

Totali i aktiveve



Departamenti i Marketingut

Departamenti i Marketingut, kurorëzoi gjatë vitit 2025 një fazë të rëndësishme evolucioni, duke e çuar strategjinë e Credins bank drejt një dimensionit më të avancuar dhe më të konsoliduar. Orientimi drejt inovacionit, risive të shërbimeve & produkteve bankare, erdhi me një koncept komunikimi duke i dhënë markës jo vetëm zë, por edhe karakter dominues në industrinë bankare dhe jo vetëm. Kjo filozofi e ndërtuar mbi standarde dhe praktika ndërkombëtare, u reflektua duke iu përshtatur dinamikave të tregut dhe njëherazi edhe sjelljes së konsumatorit. Nëpërmjet një aftësie të zhvilluar profesionale për të lexuar dhe interpretuar perceptimet në mënyrë shumëdimensionale, Departamenti i Marketingut, përmes iniciativave, fushatave, aktiviteteve dhe eventeve, arriti të ndërtojë edhe këtë vit një marrëdhënie unike dhe autentike me audiencën. Ambicia e stafit të marketingut vazhdon të jetë fuqizimi i pozicionimit të Credins bank, si një korporatë lider me një qasje sa avangarde aq edhe bashkëkohore.

Fushatat & Brand

Në një peizazh gjithnjë e më dinamik dhe konkurrues, fushatat e ndërmarra gjatë vitit u orientuan drejt zhvillimeve dhe risive, duke përcjellë një frymë moderne, në përputhje me prioritetet dhe drejtimin strategjik të bankës. Me një identitet të markës tashmë të konsoliduar dhe të diferencuar nga konkurrenca, fushatat risollën edhe një herë në vëmendje fuqinë kapitale dhe absolute të brandit. Të konceptuara strategjikisht mbi fuqinë e identitetit të ri që tashmë Credins ka prej vitit 2024, viti 2025 artikuloi edhe një herë linjën e një komunikimi që kalon kufijtë e një marketingu tradicional. Në një kohë kur industria e marketingut, në nivel lokal dhe global, konkurrenca në nivelet më të larta të kreativitetit dhe estetikës, Credins vijon të afirmojë jo vetëm një standard modern, por një perceptim të ndërlidhur me transformimin teknologjik të shërbimeve dhe eksperiencës bankare.

Përvoja dhe eksperiencia e klientit ishin kryefjala e çdo initiative të fushatave të marketingut, duke kaluar në një komunikim të personalizuar, në një linjë edhe me sloganin e Credins bank. Reflektimi në kohë reale i kërkesave dhe

pritshmërive u përkthye në një standard të ri në përjetimin e shërbimeve & produkteve bankare, duke konsoliduar një marrëdhënie më të qëndrueshme dhe me vlerë të shtuar për klientin. Mundësuam komunikim në kohë reale të të gjitha eventeve dhe ngjarjeve më të rëndësishme të bankës, duke ofruar informacion të plotë dhe transparencë për të gjithë klientët tanë. Departamenti i Marketingut ruajti një standard komunikimi, duke pasqyruar në çdo kohë vlerat, vizionin dhe misionin e bankës. Të gjitha fushatat, të cilat përveç stilit artistik dhe profesional, krijuan njëherazi një impakt pozitiv në rezultatet e shitjes së produkteve dhe shërbimeve, si tek klientët e rinj, ashtu edhe tek ata ekzistues të bankës. Segmentimi dhe targetimi i klientëve në çdo kanal komunikimi ishin një aftësi menaxheriale për të adresuar në mënyrë jo vetëm të diferencuar nevojat dhe pritshmëritë e secilit segment, por për të garantuar edhe një shpërndarje koherente që rrit efektivitetin dhe ndikimin e mesazhit tek audienca e gjerë. Në këtë aspekt, fushatat morën formë përmes disa shtyllave kryesore, duke reflektuar në mënyrë të unifikuar drejtimin strategjik të Credins:

Teknologjia dhe inovacioni digjital

- Fushatat e orientuara drejt teknologjisë dhe inovacionit reflektuan një drejtim të

rëndësishëm të bankës drejt transformimit digjital të shërbimeve. Zgjidhje inovative të produkteve dhe shërbimeve, si Apple Pay, Credins Online, etj, u shoqëruan me një linjë komunikimi të fokusuar në lehtësinë e përdorimit, fleksibilitetin si dhe cilësinë e përvojës së klientit. Implementimi për herë të parë i sistemit të avancuar CRM riformësoi mënyrën e komunikimit me klientin, duke mundësuar një ndërveprim të personalizuar dhe të sinkronizuar në kohë reale, në përputhje me nevojat e tij. Paralelisht, promovimi i zgjidhjeve fleksibël përmes shërbimit POS, i mbështetur në përvoja testimoniale reale, rikonfirmoi edhe një herë aftësinë e Credins për të integruar shërbimet bankare në mënyrë sa moderne aq edhe komode për klientët.

Fushatat e partneriteteve strategjike

- Fushatat me karakter strategjik, përmes partneriteteve me Federatën Shqiptare të Futbollit, si dhe bashkëpunimin me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), u pozicionuan si elemente të rëndësishme dhe të veçanta në ndërtimin e një identiteti të fortë brandi. Këto iniciativa tejkaluan dimensionin promovues, duke konsoliduar lidhjen emocionale me

publikun dhe duke e afruar edhe më shumë me produktet & shërbimet bankare, duke e bërë Credins si një markë lider në industrinë bankare.

Fushatat e besnikërisë

- Fushatat e besnikërisë, të zhvilluara në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtar si Mastercard dhe Visa, u materializuan në fushata strategjike shpërblimi dhe përfitimi për klientët, përmes mekanizmave të ndryshëm atraktivë, si eventet artistike, fushata POSI, etj, "Fito një udhëtim në Budapest me Credins Visa". Këto tipologji fushatash krijuan dhe sollën një marrëdhënie shumë interaktive me klientin drejt një modeli shumë miqësor (friendly) dhe gjithmonë shpërblyes.

Fushatat e segmentuara & edukative

- Fushatat e dedikuara për studentët, pensionistët, gratë, bizneset e vogla dhe të mëdha, startup-et dhe segmente të tjera të targetuara, si dhe iniciativat edukuese dhe ndërgjegjësuëse mbi përdorimin e produkteve dhe shërbimeve bankare, përbënë një tjetër shtyllë të rëndësishme në reflektimin e strategjisë së biznesit të Credins bank. Nëpërmjet tyre, kontribuam në ndërtimin e një raporti të informuar gjithmonë në kohë reale dhe më të qëndrueshëm me klientin.

Koncepti kreativ dhe e gjithë stilistika e fushatave edhe një herë risollën tone të forta emocionale, perceptim modern duke iu përshtatur trendeve dhe risive të kohës. Përmes narracioneve dhe historive të ndryshme, që përfshinë të gjitha tipologjitë e fushatave, u krijua një mozaik fragmentesh që ndërthur dinamika të larmishme, nga prezenca e figurave publike dhe personazheve të njohur, deri te momentet e lidhura drejtpërdrejt me përditshmërinë dhe jetën e klientëve. Fushatat u realizuan në përputhje të plotë me guideline e markës, duke përforcuar dhe identifikuar rolin dhe rëndësinë e Credins bank.

Evente

Eventet tashmë janë kryefjala e Departamentit Marketing,

duke e shndërruar Credins në një lider absolut të prezencës institucionale. Nën projektionin e disa eventeve madhështore verore, tashmë traditë që mbështeten ekskluzivisht nga Credins bank, u organizuan 4 eventet kulturore artistike më të mëdha të vitit, të cilat u bazuan në bashkëpunime të mirënjohura ndërkombëtare, duke sjellë artistët më të mirë për publikun. Në partneritet me Mastercard, Credins synoi, përmes organizimit të tyre të transmetojë fuqinë e markës dhe njëherazi edhe eksperiencën unike të shërbimeve dhe produkteve, përmes fushatave të ndryshme shpërblyese. Evente si Orhan Mahmut, Keine Music, UNUM Festival, Eagle Beat Festival, Topi i Artë, bënë bashkë jo vetëm spektatorin shqiptar, por edhe atë ndërkombëtar, duke i dhënë një jehonë të madhe edhe vlerave atraktive dhe turistike të Shqipërisë. I gjithë ky mekanizëm, u realizua përmes një mbulimi të plotë mediatik, duke përdorur kanalet e komunikimit, në mënyrë që audienca të ishte sa më e përfaqësuar dhe njëherazi edhe e informuar në kohë reale për produktet dhe shërbimet bankare të Credins. Përveç rëndësisë që Credins iu kushtoi këtyre projekteve, një fokus të veçantë mori edhe dizajni kreativ komercial si në aspektin komunikues ashtu edhe në atë marketues. Gjithmonë duke bashkëpunuar me agjenci kreative profesionale, Credins sërish erdhi për publikun me një stil komunikimi mjaft dinak, rinor, modern. Eventet outdoor u shoqëruan edhe me krijimin e hapësirave të veçanta marketimi si "chill zone", të cilat përmes dhuratave të shumta, lojërave dhe argëtimit të ndryshme krijuan një atmosferë unike për publikun dhe kryesisht për klientët e Credins bank.

Eventet informuese teknologjike apo mbi digjitalizimin e pagesave, të cilat rishtazi janë bërë pjesë edhe e vendit tonë, si "Connect Albania Forum 2025" për "Shqipëria Cashless 2030", Business 2030, Java Globale e Sipërmarrjes me tematikën "Financat e Gjelbra" etj. Të gjitha eventet përgjatë vitit bënë bashkë ekspertët financiarë më të mirë të vendit dhe ndërkombëtar, akademikë, sipërmarrës, ekspertë bankarë, institucione shtetërore, organizata të huaja, grupe të ndryshme interesi, etj, duke sjellë një vlerë të shtuar mbi informimin e publikut dhe mekanizmat e rinj apo hapat konkretë që do të ndërmerren për tema/fusha të rëndësishme mbi shërbimet e digjitalizuara bankare, orientimin e bizneseve drejt investimeve të gjelbra, mbi sfidat e ekonomisë shqiptare, etj.

Digital

Standardizimi i shërbimeve digjitale, i produkteve dhe shërbimeve të saj, ishte sërish një nga pjesët më të rëndësishme mbi politikat e Credins bank edhe përgjatë vitit 2025, me ambicien për të bërë më të mirën në çdo gjë që banka ofron për klientët e saj. Të gjitha fushatat e produkteve & shërbimeve, eventet artistike, aktivitetet e ndryshme edukuese, aktivitetet CSR, u pasqyruan në çdo rrjet social duke e bërë Credins të renditet në një pjesë të madhe të kanaleve të komunikimit digjital si një nga bankat me performancën më të mirë dhe më dinamike, krahasuar me bankat e tjera. Kjo falë aftësive për të ndjekur në çdo hap dhe për të adaptuar aplikacione, programe analitike, në koherencë me trendet teknologjike të korporatave më të mira ndërkombëtare. Segmentimi, duke fokusuar çdo target grup, përmes kanaleve të ndryshme si: Instagram, Facebook Ads, YouTube, LinkedIn, SMS, E-mail Marketing, ka qenë sërish një sukses, duke kombinuar shumëllojshmërinë e fushatave me interesat e klientëve, si dhe për t'i edukuar gjithmonë e më shumë në përdorimin e shërbimeve bankare digjitale. Tradicionalisht nuk munguan as lojërat promovionale të ndërlidhura me eventet artistike, si dhe me fushatat e ndryshme marketing, përmes "giveaway", quizzes, shorteve të ndryshme etj, erdhën si një alternativë për të shpërblyer klientët besnikë të Credins bank.

Përgjegjësia Sociale

Viti 2025 ishte një tjetër vit shumë impenjativ mbi projektet e dedikuara të përgjegjësisë korporative, që u ndoqën nga Departamenti i Marketingut, duke e bërë më të prekshme dhe më sociale profilin e Credins bank në komunitetin vendas. Përmes një strategjie vjetore dhe plani pune, u realizuan 171 evente & aktivitete të mbështetura nga Credins bank, duke qenë gjithmonë pranë komunitetit në fusha të ndryshme si: arsim, kulturë, sport, teknologji, turizëm, ekonomi, etj, duke kontribuar jo vetëm në rritjen e mirëqenies dhe zhvillimit të shoqërisë, por njëherazi duke sjellë një frymë të re në fushën e Përgjegjësisë Sociale. Në fokus ishin sërish edhe të rinjtë përgjatë vitit që lamë pas, përmes aktiviteteve edukuese financiare dhe marrëveshjeve të reja në panairin e punësimit. Vëmendje të veçantë morën intervistat, artikujt e ndryshëm PR si dhe kronikat e realizuara me drejtuesit e Credins bank në mediat audiovizive, të shkruara dhe ato digjitale, duke informuar në kohë reale klientët për çdo ndryshim, iniciativë humanitare, fushata sensibilizuese, risi apo zhvillim të produkteve dhe shërbimeve bankare, etj. Strategjikisht, gjithmonë edhe në përputhje me 17 Objektivat e OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm, eventet dhe aktivitetet e mbështetura nga Credins bank sollën një larmi tipologjish dhe tematikash si:

- Tradita e çeljes së ekspozitave artistike në hollin e bankës, nga artistët më të mirë vendas;
- Aktivitete të ndryshme në mbështetje të zhvillimit të arsimit & olimpiadat e ndryshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, lojërat olimpike me profesionistët në disiplinë të ndryshme, projektet sportive nëpër shkollat e Shqipërisë përmes KOKSH;
- Panairi ndërkombëtar "MUSE" i konceptuar si një panair muzikor që solli artistët më të mirë të disa zhanreve artistike, producentë, muzikantë, kantautorë, etj;
- Panairi Agro "Ditët e Bujqësisë 2025" & "Një ditë Fermer" me fokus mbështetjen e fermerëve;
- Pjesëmarrje të ndryshme të ekspertëve të sigurisë nga Credins bank në seminare mbi sigurinë kibernetike, për të ndarë eksperiencë dhe përvojë;
- Fushata të ndryshme ndërgjegjësuere kundër dhunës së gruas, apo pjesëmarrja në panairin dhe aktivitete që sjellin në fokus mbështetjen e grave sipërmarrëse;
- Tradita e aktiviteteve në bibliotekën Credins, për krijimin e një mjedisi më të zhvilluar pune për punonjësit e bankës;
- Aktivitete për fëmijët e stafit të bankës, apo aktivitete relaksuese si FunZone për stafin e Credins, trajnime, etj, të cilat përmes organizimit të Burimeve Njerëzore dhe Departamentit Marketing sollën energjinë e një institucioni që di të kujdeset në çdo kohë për stafin;
- Java Globale e Parasë, Startups Ecosystem, e shumë aktivitete të tjera që i japin zë përdorimit të produkteve dhe shërbimeve digjitale bankare;
- Projektet e ndryshme të platformës SMILE dhe Fondacionit Credins u mbështetën gjithashtu nga stafi i Departamentit të Marketingut të Credins bank.

Përgjatë vitit 2025, mes një morie aktiviteteve të realizuara, Departamenti i Marketingut zhvilloi bashkëpunime të suksesshme me partnerë të ndryshëm, duke evidentuar edhe një herë vlerat, misionin dhe vizionin e një banke e cila në zemër të saj ka gjithmonë përkujdesjen e klientëve në çdo dimension.

Departamenti Menaxhimit të Produkteve dhe Institucioneve

Departamenti i Menaxhimit të Produkteve dhe Institucioneve operon nën Divizionin e Zhvillimit të Biznesit dhe përbëhet nga:


Sektori i Menaxhimit të Produkteve, përgjegjës për dizajnimin dhe menaxhimin e produkteve e shërbimeve bankare, si dhe për krijimin e ofertave të personalizuar për klientët, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Bankës.

Sektori i Menaxhimit të Institucioneve, i angazhuar në bashkëpunimet me Institucione Publike për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve bankare për vetë institucionet si dhe pagamarrësit e tyre.

Gjatë vitit 2025, objektivi kryesor ka qenë krijimi i produkteve dhe shërbimeve konkurruese, njëhereazi duke ndjekur trendet e kohës, me fokusin në risitë e inovacionit dhe përmirësimin e efikasitetit. Viti nisi me disa oferta për disa segmente të dedikuara, duke vazhduar me të tjera dinamika shërbimesh dhe produkteve sipas linjës me politikat e biznesit të Credins bank.

- Në shkurt'25, Credins bank nënshkroi marrëveshjen për pjesëmarrjen në programin e financimit të biznesit mikro, të vogël dhe të mesëm në Shqipëri, një iniciativë e mbështetur nga Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.
- Në shtator 2025 Credins implementoi skemën e garancisë sovranë për sektorin e bujqësisë. Përmes këtij instrumenti financiar, Credins kontribuon në mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm në sektorin agro, një sektor me rëndësi strategjike për ekonominë e vendit.
- Në prill'25, Credins u bë pjesë e programit POSI, një iniciativë e zhvilluar në bashkëpunim me Mastercard, e cila synon zgjerimin dhe zhvillimin e rrjetit të pranimit të pagesave elektronike në tregun bankar shqiptar. Mastercard ka mbështetur për një periudhë njëvjeçare

Portofoli neto hua dhe qira financiare



bankat pjesëmarrëse për të nxitur rritjen e përdorimit të pagesave elektronike dhe për të zgjeruar rrjetin e tregtarëve që pranojnë pagesa me kartë. Programi synon gjithashtu të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimin të bizneseve për përfitimet e pranimit të pagesave elektronike. Në këtë kuadër, Credins është renditur ndër bankat me performancë të lartë në zbatimin e kësaj fushate, me rezultate veçanërisht të dukshme gjatë tremujorit të katërt të vitit, ku u realizua një zgjerim i konsiderueshëm i rrjetit të POS-ve dhe i bazës së tregtarëve që pranojnë pagesa me kartë. Përmes pjesëmarrjes në këtë iniciativë, Credins vijon të forcojë pozicionin e saj në tregun e pranimit të pagesave dhe të kontribuojë në zhvillimin e ekosistemit të pagesave elektronike në vend.

- Në tetor'25 Credins prezantoi një produkt financiar të dedikuar për sektorin agro, në bashkëpunim me kompani partnere, me qëllim mbështetjen e fermerëve dhe bizneseve që operojnë në fushën e bujqësisë dhe agropërpunimit. Klientët e këtij segmenti përfitojnë financim me normë interesi 0%, ndërsa interesi dhe komisioni i disbursimit mbulohen nga kompania partnere në momentin e disbursimit të kredisë. Ky model bashkëpunimi krijon

mundësi më të favorshme financimi për fermerët dhe sipërmarrjet në sektorin agro, duke lehtësuar aksesin në financim për investime dhe zhvillim të aktivitetit të tyre.

- Përgjatë vitit, implementimi i pajisjeve të reja POS Android, ishin një tjetër zgjidhje moderne për pranimin e pagesave elektronike të implemtuara nga Credins bank. Këto pajisje të reja POS të bazuara në teknologjinë Android ofrojnë një platformë më fleksibile dhe funksionale për tregtarët, duke mundësuar një gamë të zgjeruar funksionalitetesh dhe një përvojë më të avancuar në procesimin e pagesave. Përmes kësaj teknologjie, bizneset përfitojnë nga përpunimi më i shpejtë i transaksioneve dhe integrimi më i lehtë me sisteme të tjera menaxhimi të biznesit, si sistemet e kasave fiskale apo aplikacionet e menaxhimit të shitjeve. Në këtë mënyrë, Credins synon të mbështesë zgjerimin e pagesave elektronike duke përmirësuar përvojën e pagesës për klientët, në përputhje me tendencat bashkëkohore të digjitalizimit të shërbimeve financiare.
- Pagesat me Apple Pay - Gjatë vitit 2025, Banka Credins lançoi shërbimin Apple Pay, duke u ofruar klientëve mundësinë të kryejnë pagesa me kartat e tyre Credins përmes pajisjeve Apple, në mënyrë të shpejtë, të sigurt dhe pa kontakt. Në të njëjtën kohë, Banka Credins prej më shumë se një viti ofron gjithashtu pagesa mobile për përdoruesit e pajisjeve Android përmes shërbimit Google Pay, duke siguruar kështu që klientët të kenë akses në zgjidhje moderne pagese pavarësisht platformës së pajisjes që përdorin. Implementimi i këtyre shërbimeve është pjesë e investimeve të vazhdueshme të Bankës Credins në zhvillimin e zgjidhjeve teknologjike dhe digjitale, me qëllim përmirësimin e përvojës së klientëve dhe ofrimin e shërbimeve bankare që përputhen me standardet më të avancuara ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, këto iniciativa kontribuojnë në nxitjen e përdorimit të pagesave elektronike dhe reduktimin e përdorimit të parasë fizike, duke mbështetur zhvillimin e një ekonomie gjithnjë e më të digjitalizuar.
- Vëmendje ju kushtua edhe studentëve me produktin e veçantë Kredia Studentore, ku Credins nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) për implementimin e skemës së kredive studentore,

një iniciativë që synon të mbështesë financimin e studimeve të arsimit të lartë për studentët në Shqipëri. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, studentët përzgjidhen paraprakisht nga AKFAL, ndërsa aplikimet për kredi përpunohen nga Credins në përputhje me procedurat standarde të vlerësimit të kredisë. Përmes këtij produkti, banka synon të kontribuojë në rritjen e aksesit në financim për arsimin e lartë dhe në mbështetjen e zhvillimit profesional, duke i konsideruar të rinjtë një potencial të rëndësishëm dhe një bazë të qëndrueshme të klientelës së së ardhmes.

- Credins gjithashtu zhvilloi një produkt të dedikuar duke ofruar mundësinë e hapjes së një llogarie të posaçme për mbrojtjen e fondeve të klientëve, në përputhje me kërkesat rregullatore të Bankës së Shqipërisë (Institucionet e Parasë Elektronike). Në të njëjtën kohë, kjo iniciativë reflekton angazhimin e Credins për mbështetjen e ekosistemit Fintech në Shqipëri, duke ofruar zgjidhje bankare dhe infrastrukturore për institucionet që operojnë në këtë sektor. Gjatë vitit 2025, Credins ka mbështetur gjithashtu një tjetër Fintech në ofrimin e shërbimeve të pranimit të pagesave me kartë, duke mundësuar pranimin e pagesave me kartat Visa përmes infrastrukturës së saj. Këto nisma kontribuojnë në mbështetjen e Fintech-ve në fazat e hershme të zhvillimit të biznesit, duke u mundësuar atyre të operojnë dhe të ofrojnë shërbime në treg duke u mbështetur në infrastrukturën, eksperiencën dhe licencat e një banke të konsoliduar, si Credins bank. Në këtë mënyrë, banka kontribuon në zhvillimin e inovacionit dhe të zgjidhjeve të reja në tregun e pagesave dhe shërbimeve financiare në Shqipëri.

Sektori Menaxhimit të Institucioneve, ka vijuar të ruajë trendin e ecurisë pozitive, përse i përket arritjes së objektivave për vitin 2025, të cilat konsistojnë në menaxhimin dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet publike. Treguesit pozitiv të arritura përgjatë vitit 2025, tregojnë rëndësinë për të ofruar gjithmonë shërbime cilësor, të shpejta, të sigurt dhe produkte të personalizuar në varësi të kërkesave të klientëve. Credins bank, bashkëpunon me 999 Institucione në nivel qendror dhe lokal ku gjatë këtij viti, ka patër një rritje rreth 7% të institucioneve, që kanë filluar bashkëpunim, krahasuar me vitin paraardhës. Institucionet shtetërore karakterizohen nga volumni i lartë i fondeve dhe numri i punonjësve. Gjatë

vitit 2025 ka patur një rritje të numrit të klientëve pagamarrës prej 4%, krahasuar me fundin e vitit 2024.

Ofrimi për klientët pagamarrës i Paketave të Pagave, të cilat ndahen në Paketa Bazë dhe Paketa Plus ka ndikuar në një kanalizim të klientëve pagamarrës duke afruar më shumë klientin me bankën, ku 72 % e totalit të klientëve pagamarrës kanë zgjedhur një nga paketat nga të cilët, 39% e klientëve kanë zgjedhur Paketën Bazë dhe 33% Paketën Plus. Vlen të theksohet se numri i produkteve jo kredi ka një rritje relativisht të lartë, kryesisht në shërbimet online, ku vlen të theksohet pagesat nëpërmjet e-albania me institucione të rëndësishme si ASHK, DPSHTRR, etj. Gjithashtu përgjatë vitit 2025, për të parë kemi arritur marrëveshje me institucionet shtetërore për përdorimin e POS, risi për tregun shqiptar.

Këto rritje të produkteve dhe shërbimeve janë përkthyer edhe në rritjen e totalit të të ardhurave nga menaxhimi i marrëdhënies me institucionet, ku përfitueshmëria është rritur me 4 % krahasuar me vitin paraardhës.

Përgjegjësia sociale zë një peshe të rëndësishme për Credins bank, ku përgjatë vitit 2025 ka mbështetur shumë institucione duke u angazhuar që do të vazhdojë mbështetjen e saj edhe në vazhdimësi. Një fokus të veçantë kanë patur


institucione si arsimi, shëndetësia, bashkitë, por edhe institucionet e tjera të cilat kanë gjetur një bankë që i ka suportuar në pjesën më të madhe të kërkesave të tyre.

Departamenti i Bizneseve Alternative

Bizneset “alternative” kanë vijuar performancën e tyre shumë pozitive edhe përgjatë vitit 2025, duke reflektuar një rritje të qëndrueshme dhe të konsoliduar të aktivitetit të Departamentit të Bizneseve Alternative (DBA). Gjatë këtij viti, është demonstruar një kapacitet i lartë për të zgjeruar aktivitetin, për të rritur eficiencën operacionale, për të diversifikuar burimet e të ardhurave, duke u mbështetur si në përmirësimin e produkteve ekzistuese ashtu edhe në rritjen e penetrimit në treg. Të ardhurat totale të realizuara gjatë vitit 2025 arritën në rreth 83 milionë Lekë, nga rreth 67 milionë Lekë në vitin 2024, duke shënuar një rritje të konsiderueshme prej afërsisht 24%. Kjo ecuri pozitive konfirmon trendin rritës të viteve të fundit dhe pozicionin gjithnjë e më të rëndësishëm të këtij departamenti në strukturën e përgjithshme të të ardhurave të bankës.

Sikurse edhe në vitet e mëparshme, linja kryesore e biznesit mbetet ndërmjetësimi i siguracioneve, i cili zë pjesën dërmuese të të ardhurave të DBA. Gjatë vitit 2025, të ardhurat nga ndërmjetësimi i policave të sigurimit të kredimarrësve arritën në rreth 74 milionë Lekë, në rritje nga 61.6 milionë Lekë në vitin 2024. Paralelisht, numri i këtyre policave u rrit në 10,291 nga 9,447 në vitin paraardhës, duke reflektuar një zgjerim të qëndrueshëm të aktivitetit kreditues dhe integrimin efektiv të produkteve të sigurimit në këtë proces. Produktet kryesore në këtë segment vijojnë të jenë sigurimi i jetës për hua dhe sigurimi i kolateralit, të cilat mbeten bazë e fortë e të ardhurave dhe stabilitetit të këtij aktiviteti.

Një zhvillim veçanërisht i rëndësishëm gjatë vitit 2025 ka qenë rritja e ndjeshme e segmentit të siguracioneve vullnetare, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin kredidhënës. Të ardhurat nga ky segment arritën në rreth 8.1 milionë Lekë, krahasuar me 4.7 milionë Lekë në vitin 2024, duke u dyfishuar brenda një periudhe njëvjeçare.



Në të njëjtën kohë, numri i policave të ndërmjetësuar në këtë kategori arriti në një nivel rekord prej 9,624 policash, nga 6,623 në vitin e mëparshëm. Kjo rritje pasqyron një kombinim të suksesshëm të përpjekjeve për rritjen e ndërgjegjësimit të klientëve, zgjerimin e gamës së produkteve dhe përmirësimin e aftësive shitëse të rrjetit të degëve kudo në Shqipëri.

Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në këtë performancë pozitive gjatë vitit 2025, veçohen disa iniciativa strategjike të ndërmarra. Implementimi i mbulimit shtesë "sëmundje kritike" në policat e sigurimit të jetës për hua, për segmentet deri në 3,000,000 Lekë dhe me afat nga 1 deri në 7 vite, ka sjellë një rritje prej rreth 20% të të ardhurave në këtë kategori. Gjithashtu, forcimi i sektorit të ndërmjetësimit të siguracioneve vullnetare, i reflektuar në rritjen e ndjeshme të volumit të policave dhe të ardhurave, ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në diversifikimin e portofolit të të ardhurave. Një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe organizimi i trajnimeve të gjera për stafin e degëve, përfshirë drejtuesit, duke rritur nivelin e njohurive mbi produktet e sigurimit dhe duke përmirësuar ndjeshëm performancën në shitje.

Në drejtim të aktivitetit të depozitarit, gjatë vitit 2025 janë shënuar zhvillime të rëndësishme, megjithëse kontributi në të ardhura mbetet ende modest. Të ardhurat nga shërbimi i depozitarit vijnë të jenë të kufizuara për shkak të madhësisë relativisht të vogël të tregut dhe të aseteve nën menaxhim të fondeve të investimit për të cilat Banka luan rolin e depozitarit. Megjithatë, "on-boarding" i dy fondeve të reja të investimeve në valutë të huaj ka rritur numrin total të fondeve kliente në tre, duke përforcuar eksperiencën dhe kapacitetet e bankës në fushën e depozitarit. Një tjetër arritje e rëndësishme është licencimi i bankës si depozitar për fondet alternative të investimit, çka krijon baza të forta për zhvillimin e mëtejshëm të këtij aktiviteti në të ardhmen.

Në përfundim, viti 2025 përfaqëson një tjetër hap të rëndësishëm në konsolidimin dhe zgjerimin e aktivitetit të Departamentit të Bizneseve Alternative. Për vitin 2026 parashikohet një ecuri pozitive, me një rritje të projektuar prej rreth 10% të të ardhurave totale, e mbështetur nga vijimi i zhvillimit të produkteve të sigurimit, rritja e mëtejshme e segmentit të siguracioneve vullnetare dhe zgjerimi gradual i aktivitetit të depozitarit dhe bankngut investues.

Departamenti i Biznesit të Madh

Gjatë vitit 2025, Departamenti i Biznesit të Madh ka mbështetur në mënyrë aktive nevojat për financim të klientëve të Biznesit, duke ruajtur njëkohësisht standarde të larta cilësie në portofolin e kreditimit. Fokus i veçantë i është kushtuar financimit të bizneseve të konsoliduara, me qëndrueshmëri dhe histori të provuar në treg, si dhe sigurimit të ekspozimeve të kolateralizuara. Monitorimi i vazhdueshëm dhe ndjekja nga afër e klientëve në çdo fazë të zhvillimit të aktivitetit të tyre ka qenë një komponent thelbësor i qasjes sonë. Ky proces është realizuar duke marrë në konsideratë edhe ndikimin e faktorëve makroekonomikë në performancën e tyre, duke garantuar një menaxhim të kujdesshëm dhe proaktiv të marrëdhënies me këtë segment. Qasja ndaj klientit ka shkuar përtej financimit tradicional, duke përfshirë edhe ofrimin e shërbimeve cilësore, këshillimin profesional të dedikuar lidhur me investimet dhe planet e tyre të ardhshme. Në këtë mënyrë, banka ka forcuar rolin e saj si një partner i besueshëm dhe mbështetës strategjik për klientët e saj në çdo hap të zhvillimit të tyre.

Gjithashtu përgjatë vitit, rëndësi të veçantë i është kushtuar edhe transaksioneve jokreditore të klientëve të biznesit të madh, duke adresuar në

mënyrë të plotë nevojat e tyre për produkte dhe shërbime bankare pranë Credins bank. Një fokus të veçantë mori edhe aftësia menaxheriale e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet klientëve dhe departamenteve të ndryshme të bankës për operacione si: këmbimet valutore, transfertat ndërbankare, përdorimi i produkteve digjitale, etj. Në këtë kuadër, është promovuar përdorimi i platformës Credins Online dhe shërbimeve e-banking, me qëllim rritjen e efikasitetit operacional dhe reduktimin e nevojës për prezencë fizike në degë. Po ashtu, është inkurajuar përdorimi i pajisjeve POS, duke kontribuar në një eksperiencë më të plotë dhe moderne për klientin.

Në vijim, gjatë vitit 2026, me synimin për të ruajtur të njëjtat prioritetet strategjike të ndjekura në vitin 2025, theksi do të vendoset edhe më shumë në monitorimin proaktiv të aktivitetit të klientëve. Kjo do të mundësojë në këtë aspekt identifikimin dhe paraprirjen e ndikimeve të mundshme nga faktorët makroekonomikë, si inflacioni dhe luhatjet në kurset e këmbimit, duke garantuar një menaxhim më të qëndrueshëm dhe të kujdesshëm të portofolit.

Departamenti i Kanaleve Digjitale

Gjatë vitit 2025, kanalet digjitale kanë marrë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve bankare në Credins bank, duke reflektuar ndryshimin e sjelljes së klientëve drejt zgjidhjeve më të shpejta, të aksesueshme dhe të orientuara drejt përvojës së përdoruesit. Në këtë kuadër, Departamenti i Kanaleve Digjitale ka vijuar të zhvillojë dhe të menaxhojë kanalet alternative bankare, duke përfshirë Credins Online, POS dhe e-commerce, ATM-të si dhe kujdesin ndaj klientit përmes kanaleve digjitale.

Departamenti i Kanaleve Digjitale ka në fokus zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve bankare përmes këtyre kanaleve, duke synuar ofrimin e zgjidhjeve të sigurta, efikase dhe të lehta për përdorim për klientët. Në vitet e fundit, rritja e përdorimit të pagesave elektronike në treg dhe zgjerimi i pranimin të pagesave me kartë nga bizneset kanë reflektuar një interes gjithnjë e më të madh për shërbime financiare digjitale. Në këtë kuadër, banka ka vijuar investimet në zgjerimin e infrastrukturës së pranimin të pagesave dhe në përmirësimin e platformave digjitale, duke kontribuar në rritjen e përdorimit të këtyre kanaleve nga klientët.

Zgjerimi i rrjetit të terminalëve POS ka qenë një nga zhvillimet kryesore gjatë vitit raportues, duke mundësuar pajisjen e një numri më të madh tregtarësh me infrastrukturë për pranimin e pagesave me kartë. Si rezultat, numri i transaksioneve në POS është rritur me **40% krahasuar me një vit më parë**, duke reflektuar rritjen e përdorimit të pagesave elektronike dhe orientimin gradual të tregut drejt reduktimit të përdorimit të parasë fizike. Ky zhvillim është mbështetur edhe nga pjesëmarrja e bankës në iniciativa dhe fushata të realizuara në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë të skemave të pagesave, të cilat synojnë zgjerimin e pranimin të pagesave elektronike dhe inkurajimin e tregtarëve për pranimin e pagesave me kartë. Rritje e ndjeshme është vërejtur veçanërisht në sektorin e turizmit, në përputhje me shtimin e fluksit turistik në Shqipëri, sidomos në zonat bregdetare. Në të njëjtën kohë, banka ka zgjeruar praninë e saj në tregun e **E-commerce**, duke ofruar zgjidhje të sigurta dhe të personalizuara për bizneset që operojnë online dhe duke mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të pagesave digjitale.

Gjatë vitit raportues, banka ka vijuar të zhvillojë dhe të diversifikojë kanalet e komunikimit me klientët, duke i dhënë një rëndësi të veçantë përmirësimit të shërbimit të ofruar përmes Sektorit të Kujdesit ndaj Klientit online, i cili operon 24/7. Fokus i veçantë është vendosur në thjeshtimin e proceseve dhe rritjen e efikasitetit në trajtimin e kërkesave, me synim ofrimin e një përvojë sa më të shpejtë dhe cilësore për klientët. Në të njëjtën kohë, kanalet alternative të komunikimit, si WhatsApp dhe rrjetet sociale, kanë marrë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm, duke u kthyer në pika kontakti të drejtpërdrejta dhe të aksesueshme për klientët.

Platforma Credins Online ka vijuar të zhvillohet, duke përmirësuar përvojën e përdoruesve dhe aksesin në shërbimet bankare përmes një ndërfaqeje më moderne dhe funksionaliteve të avancuara. Mundësia për regjistrim online në e-banking për klientët ekzistues ka lehtësuar aksesin në shërbime, pa pasur nevojë për paraqitje fizike në degë. Zhvillimi i mëtejshëm i platformës mbetet një nga prioritetet për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve digjitale për klientët individë dhe biznes. Mbështetja për klientët në përdorimin e Credins Online ofrohet përmes kanaleve të kujdesit ndaj klientit, duke lehtësuar aksesin dhe përdorimin e shërbimeve digjitale.

Rrjeti i ATM-ve vijon të ofrojë akses në shërbimet bazë bankare, duke mbetur një kanal i rëndësishëm për klientët, në përputhje me zhvillimet e përgjithshme të shërbimeve bankare.

Në vijim të zhvillimit të kanaleve digjitale, gjatë vitit 2026 banka synon të zgjerojë zgjidhjet e pagesave, duke ofruar produkte të përshtatura me aktivitetin e klientëve dhe dinamikat e tregut. Në të njëjtën kohë, do të implementohen funksionalitete të reja që rrisin transparencën dhe mundësitë e zgjedhjes për klientët gjatë kryerjes së pagesave, veçanërisht në transaksionet ndërkombëtare.

Divizioni i Riskut

Gjatë vitit 2025, mjedisi në të cilin operon banka paraqitet më kompleks dhe dinamik, i ndikuar nga zhvillimet makroekonomike, rritja e shpejtë e digjitalizimit dhe kërkesat në rritje për transparencë dhe qëndrueshmëri. Në këtë kontekst, funksioni i menaxhimit të riskut ka vijuar të

forcojë qasjen e tij, duke kaluar nga një model tradicional, i orientuar drejt analizës historike, në një qasje më proaktive dhe të orientuar nga e ardhmja. Kjo qasje synon identifikimin në kohë të rreziqeve, rritjen e qëndrueshmërisë së portofolit dhe mbështetjen e vendimmarrjes strategjike të bankës.

Risku i Kreditit

Risku i kreditit mbetet komponenti kryesor i profilit të përgjithshëm të riskut të bankës dhe burimi kryesor i ekspozimit ndaj humbjeve potenciale. Gjatë vitit 2025, banka ka vijuar të ndjekë një qasje të kujdesshme dhe të strukturuar në menaxhimin e këtij risku, duke balancuar objektivat e rritjes me ruajtjen e cilësisë së portofolit. Portofoli i kredisë është monitoruar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet analizave të detajuara sipas segmenteve (individë, biznese të vogla dhe të mesme, si dhe korporata), sektorëve ekonomikë dhe shpërndarjes gjeografike, me qëllim identifikimin e përqendrimeve dhe ekspozimeve potencialisht më të rrezikuara. Vëmendje e veçantë i është kushtuar sektorëve më të ndjeshëm ndaj luhatjeve ekonomike. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së portofolit, banka ka forcuar mekanizmat e identifikimit të hershëm të kredive me rrezik të shtuar, duke përdorur indikatorë paralajmërues (early warning indicators) dhe modele analitike për vlerësimin e probabilitetit

të mospagimit. Gjithashtu, banka ka vijuar të përmirësojë praktikën e provigjionimit, duke reflektuar një qasje të kujdesshme dhe në përputhje me parimet e humbjeve të pritshme. Analizat e zhvilluara përfshijnë vlerësime forward-looking, të mbështetura në skenarë makroekonomikë, për të siguruar një pasqyrim sa më realist të rrezikut të kreditit. Menaxhimi i kolateralit ka mbetur një element kyç në mitigimin e riskut, ku banka ka forcuar proceset e vlerësimit dhe rivlerësimit periodik të aktiveve të vendosura si garanci, duke marrë në konsideratë zhvillimet e tregut dhe faktorët e jashtëm që mund të ndikojnë në vlerën e tyre. Në drejtim të menaxhimit të kredive me probleme, banka ka ndjekur një qasje aktive, duke përdorur strategji të ndryshme rikuperimi dhe ristrukturimi, me qëllim minimizimin e humbjeve dhe rikthimin e ekspozimeve në gjendje performuese kur është e mundur. Një tjetër fokus i rëndësishëm gjatë vitit ka qenë reduktimi i përqendrimit të riskut, nëpërmjet vendosjes së limiteve të brendshme për ekspozimet ndaj klientëve të mëdhenj dhe sektorëve të caktuar, si dhe përmes diversifikimit të mëtejshëm të portofolit.

ESG dhe Risku Klimatik

Gjatë vitit 2025, banka ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt integritetit të faktorëve mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes (ESG) në kuadrin e

saj të menaxhimit të riskut. Në këtë drejtim, është nisur vlerësimi i ekspozimeve ndaj sektorëve me ndikim të lartë mjedisor dhe është rritur vëmendja ndaj ndikimit të faktorëve klimatikë në vlerën e kolateralit dhe qëndrueshmërinë e klientëve. Banka synon të zhvillojë më tej këtë kuadër në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Divizioni Operacional

Departamenti Thesarit

Viti 2025 u mbyll me përmbushje të objektivave kryesore dhe rritje të konsiderueshme të rezultatit financiar për aktivitetin e Departamentit të Thesarit, duke tejkaluar nivelin e pritshmërive. Përgjatë vitit 2025 janë rishikuar objektivat e vendosura më parë dhe janë hartuar parashikimet për vitin e ardhshëm 2026. Mbështetur mbi dinamikën e tregjeve financiare, uljen e normës bazë të interesit në Amerikë dhe Angli, kemi qëndruar krah tendencave të tregut me qëllim menaxhimin efektiv të likuiditetit dhe investimeve afatgjata. Politika monetare e ndjekur nga bankat qendrore kudo në botë ka dhënë rezultate pozitive në uljen e normës së inflacionit, por jo në mënyrën absolute të prituri; si pasojë, përpjekjet për ta ulur normën e inflacionit brenda kufijve do të vazhdojnë me intensitet edhe gjatë vitit 2026.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2025, tregjet financiare u paraqitën me më shumë luhatshmëri për shkak të përpjekjeve për paqe në Ukrainë dhe Izrael, por edhe për rritjen e tensioneve në Lindjen e Mesme, bazuar në konfliktin me Iranin, duke kërkuar vëmendje të veçantë në menaxhimin e likuiditetit në valutë dhe veprimeve me tituj. Banka e Shqipërisë ka ulur normën bazë në korrik të vitit 2025 nga 2.75% në 2.50%, bazuar në të dhënat makroekonomike të qëndrueshme dhe inflacionin e moderuar. Ndikimi gjithëpërfshirës në ekonomi u pasqyrua me ndryshime te normat e interesit të kredive dhe depozitave dhe përmirësim të ekosistemit tregtar.

Departamenti i Thesarit përmbushi me sukses objektiva si: menaxhimi efektiv i likuiditetit, rritja e investimeve në tituj në ALL dhe në valutë, përmirësimi i proceseve të brendshme të punës, rritja e transaksioneve me tituj korporativë me klientë, mbështetja cilësore në veprimtaritë kyçe të bankës, rritja e të ardhurave nga veprimtaritë kryesore, zhvillimi i marrëdhënieve me bankat

vendase dhe të huaja, rritja e aktivitetit në tregun e parasë vendas me valutë të huaj, si dhe menaxhimi i aktivitetit ditor duke respektuar treguesit e brendshëm të riskut.

Marrëdhënia me bankat rezidente dhe jorezidente ka rëndësi në aktivitetin e departamentit për shkak të bashkëpunimit ditor dhe aksesit në tregjet financiare. Përmirësimi i vazhdueshëm në këto marrëdhënie është thelbësor dhe synon zhvillimin e mëtejshëm të çdo bashkëpunimi. Takimi vjetor me bankat korrespondente në 2025 na ofroi mundësi për zhvillim bashkëpunimi, ulje të kostove dhe zgjerim në produkte të reja, mekanizma të rinj për akses në tregjet financiare, rritje të limiteve të financimit dhe rritje të transaksioneve në produktet ekzistuese me kushte preferenciale. Rritja e veprimtarisë dhe transaksioneve e bën çdo vit e më solide marrëdhënien shumëvjeçare të Credins bank me bankat korrespondente. Ecuria pozitive e ekonomisë shqiptare ka rikthyer interesin e bankave të huaja për të operuar me bankat shqiptare, me kërkesa për hapje marrëdhëniesh nga banka të huaja me vlerësim të lartë risku.

Departamenti i Thesarit bashkëpunon me institucione financiare të njohura ndërkombëtarisht, duke siguruar për klientët çmimet më të mira për tituj dhe shpejtësi në çdo transaksion, si dhe duke krijuar diversifikim të mëtejshëm në partneritete dhe potencial për zhvillim të vazhdueshëm. Gjithashtu, bazuar në bashkëpunimin e sigurt me banka të huaja, janë shtuar alternativat për kryerjen e transaksioneve nëpërmjet platformave të dedikuara që çdo bankë e madhe ofron për partnerët e saj, duke siguruar akses të diversifikuar dhe të pavarur në tregjet financiare globale.

Të ardhurat nga veprimtaria e sektorit të tregut të parasë dhe titujve u rritën me 10% krahasuar me vitin 2024, duke shtuar më tej kapacitetet fitimprurëse. Objektivi kryesor është menaxhimi i likuiditetit në mënyrën më efikase të mundshme, bazuar në produktet ku kemi akses, si dhe investimi në tituj të Qeverisë Shqiptare dhe qeverive të huaja, në përputhje me politikën e investimit. Planifikimi i kujdesshëm dhe në kohën e duhur për investimet në tituj ka qenë në fokus gjatë vitit 2025, për shkak të normave të larta të interesit, duke rritur përfitimet për bankën dhe klientët.

Gjatë vitit 2026 do të përqendrohemi në ndryshimin e përbërjes së portofolit të titujve dhe ruajtjen e përfitimit mesatar të tij. Sektori i tregut të parasë i dha mbështetje klientëve në tregun sekondar të titujve, me flukse të

larta tregtimi, duke lehtësuar transaksionet dhe mbështetur nevojat e investitorëve individë dhe subjekteve. Credins bank ka mbajtur rolin e liderit përsa i takon likuiditetit në tregun vendas dhe ka qëndruar aktive në ankandet e titujve benchmark dhe tregtimin në tregun sekondar, duke mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të programit të Bankës Botërore për Market Maker.

Në Departamentin e Thesarit, pozicioni i dedikuar "Broker" si operator i specializuar për klientët në investimin dhe tregtimin e titujve shënoi zhvillim të aktivitetit me volume ditore. Zgjerimi i aktivitetit të brokerimit në shumëllojshmëri titujsh, si të qeverisë ashtu edhe korporativë, në ALL dhe valutë, duke i ofruar çdo klienti informacion dhe mbështetje në çdo transaksion, e pozicionoi bankën më afër klientit. Janë rishikuar procedurat e punës për të optimizuar infrastrukturën operacionale dhe për të lehtësuar investitorin.

Sektori Forex, nëpërmjet aktivitetit valutor, ka menaxhuar me sukses volume të larta tregtimi, duke qëndruar aktiv në ankandet FX Forward të organizuara nga Banka e Shqipërisë. Gjatë vitit 2025 vijoi trendi i forcimit të monedhës ALL, ndërsa sektori realizoi rritje fitimi prej 40% dhe volume të larta tregtimi. Viti 2025 shënoi gjithashtu rritje rekord të transaksioneve me lingota dhe monedha ari, si pasojë e rritjes së çmimeve në bursat ndërkombëtare.

Emetimet e reja të obligacioneve të Credins bank në 2025, nëpërmjet ofertës private, rezultuan të suksesshme, duke arritur një vlerë totale prej 57 milionë eurosh.

Për vitin 2025, departamenti ka rritur gjithashtu pjesëmarrjen në trajnime profesionale dhe ka përmirësuar procedurat e brendshme, duke rritur eficiencën operacionale dhe cilësinë e shërbimit ndaj klientit.

Departamenti Kartave

Departamenti i Kartave vijoi të luajë një rol kyç në zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve dixhitale edhe përgjatë vitit 2025, duke u përfshirë në projekte ambicioze strategjike me qëllim rritjen e përdorimit të pagesave elektronike, përmirësimin e cilësisë së ofrimit të tyre për klientët, shtimin dhe përmirësimin e elementeve të sigurisë, si dhe përmirësimin e eksperiencës së klientëve, etj.

Gjatë vitit 2025, Credins bank realizoi një transformim të rëndësishëm në fushën e pagesave dhe shërbimeve me kartë, duke pasur në fokus dixhitalizimin e pagesave dhe tokenizimin e kartave, modernizimin e infrastrukturës POS & ATM dhe duke synuar përputhshmëri me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, në fokus ka qenë zgjerimi i shërbimeve "instant" dhe e-commerce, si dhe zhvillimi

dhe lançimi i produkteve premium.

U implementua Google Pay me funksionalitetin In-App Provision për të gjithë portofolin e kartave Visa dhe Mastercard të bankës, duke mundësuar tokenizimin e kartave direkt nga aplikacioni Mobile Banking. Ky zhvillim shënoi kalimin nga "manual provisioning" në një proces të integruar dhe të automatizuar brenda aplikacionit, duke rritur ndjeshëm komoditetin dhe sigurinë për klientët. Paralelisht, u finalizua edhe aktivizimi i Apple Pay për të gjithë portofolin e kartave, nëpërmjet "manual provisioning", në përputhje të plotë me kërkesat teknike dhe funksionale të Apple.

Në drejtim të modernizimit të infrastrukturës, banka doli në treg me gjeneratat më të fundit të terminaleve Android POS, duke përmirësuar kapacitetet teknologjike dhe duke krijuar bazën për ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar për tregtarët. Po ashtu, u implementua funksionaliteti ATM Contactless, duke mundësuar tërheqje fondesh jo vetëm me kartë fizike, por edhe përmes telefonit celular nëpërmjet Apple Pay dhe Google Pay për kartat Visa dhe Mastercard. Ky zhvillim rriti nivelin e sigurisë dhe përmirësoi ndjeshëm eksperiencën e klientëve.

Një tjetër projekt i rëndësishëm ishte implementimi i Visa Direct, duke mundësuar transfertat e menjëhershme të fondeve në kartë (money send). Ky shërbim pritet të zgjerojë ofertën e bankës në segmentin e pagesave instant dhe krijon mundësi të reja për transferta card-to-card në kohë reale.

Në segmentin e pagesave online, u finalizua projekti Epay Credins, duke mundësuar pagesat e shërbimeve përmes portalit e-Albania nëpërmjet kanalit e-commerce. Ky zhvillim rriti prezencën e bankës në pagesat digjitale dhe kontribuoi në rritjen e volumit të transaksioneve online.

Në fushën e produkteve premium, viti 2025 u kurorëzua me lançimin e Visa Infinite, karta e parë metalike premium në Shqipëri. Ky produkt e pozicionon bankën në segmentin premium, duke ofruar benefite ekskluzive dhe një eksperiencë të diferencuar për klientët e saj elitare.

Gjatë vitit 2025 u rrit me 36% numri i tregtarëve VPOS (e-commerce), çka solli zgjerimin e përdorimit të pagesave online me 27% krahasuar me vitin 2024. Investimet në teknologji, siguri dhe optimizimin e proceseve online mundësuan zgjerimin e bazës së klientëve dhe rritjen e përdorimit të kartave për pagesa në internet. Si rezultat,

banka shënoi një rritje të qëndrueshme të numrit të klientëve aktivë dhe të volumit të transaksioneve elektronike, duke forcuar më tej pozicionin e saj në treg dhe duke iu përshtatur ndryshimeve në sjelljen e klientëve drejt kanaleve digjitale.

Ndërfaqja e pagesave e ofruar nga Credins u mundëson bizneseve procesimin e pagesave online duke drejtuar klientët e tyre në një ndërfaqe të sigurt dhe të audituar për mbledhjen e të dhënave sensitive të kartave (PCI DSS). VPOS Credins operon me protokollet e sigurisë 3DS 1.0 dhe 3DS 2.0, të cilët janë krijuar për të reduktuar rrezikun e mashtrimit, vjedhjes së identitetit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme gjatë transaksioneve CNP (Card Not Present). Ndërfaqja e pagesave është intuitive, e lehtë për t'u përdorur nga çdo kartëmbajtës dhe i përshtatet çdo pajisjeje elektronike në të cilën përdoret ("Responsive Design"). Ajo ofron opsione të shumta për menaxhimin dhe kontrollin e transaksioneve të kryera në faqen online të tregtarit. Çdo tregtari e-commerce i ofrohet akses në një platformë backoffice, në të cilën mund të monitorojë dhe menaxhojë transaksionet e kryera në dyqanin e tij online.

Përveç opsionit të menaxhimit përmes platformës backoffice në mënyrë manuale, tregtari mund të implementojë funksionalitete të automatizuara me anë të API-ve. Nëpërmjet platformës, klienti mund të realizojë rezervime/booking, rimbursime të pagesave (refund/partial refund), të monitorojë transaksionet në kohë reale, të dërgojë pagesa përmes krijimit të një linku "Pay By Link", etj. Shërbimi ofrohet në dy monedha, ALL dhe EUR.

Credins ka rritur gjithashtu prezencën e saj në treg me 24%, duke u ofruar klientëve (bizneseve) terminale POS fizike të një cilësie të lartë dhe teknologjie të avancuar, duke sjellë përmirësim të treguesve dhe parametrave që lidhen me cilësinë, kohën e procesimit, sigurinë, etj.

Të gjithë treguesit sasiorë dhe cilësorë, si në lëshimin e kartave ashtu edhe në pranimin e pagesave me kartë, kanë shënuar rritje, duke vërtetuar edhe këtë vit rëndësinë dhe prioritetin që banka i jep transformimit digjital të shërbimeve të pagesave, modernizimit të infrastrukturës, rritjes së standardeve të sigurisë dhe forcimit të pozicionit të Credins bank në tregun shqiptar të pagesave.



U implementua Google Pay me funksionalitetin In-App Provision për të gjithë portofolin e kartave Visa dhe Mastercard të bankës, duke mundësuar tokenizimin e kartave direkt nga aplikacioni Mobile Banking.

Divizioni i Teknologjisë dhe Informacionit

Teknologjia e informacionit vazhdon të jetë një nga shtyllat kryesore të zhvillimit dhe inovacionit në Credins bank. Gjatë vitit 2025, Divizioni i Teknologjisë së Informacionit ka vijuar të mbështesë transformimin digjital të bankës duke investuar në modernizimin e infrastrukturës teknologjike, përmirësimin e platformave digjitale dhe forcimin e sigurisë kibernetike. Fokusi kryesor i bankës ka qenë ndërtimi i një ekosistemi teknologjik modern, që garanton stabilitet, performancë të lartë dhe një eksperiencë gjithnjë e më të avancuar për klientët në përdorimin e shërbimeve bankare. Investimet e realizuara gjatë vitit kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve teknologjike dhe në mbështetjen e zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve të reja bankare, duke përmirësuar efikasitetin operacional dhe duke rritur fleksibilitetin e sistemeve në përballimin e kërkesave gjithmonë e në rritje të tregut.

Infrastruktura Teknologjike

Infrastruktura teknologjike e Credins mbështetet në sisteme moderne dhe të shkallëzueshme që garantojnë funksionimin e vazhdueshëm të operacioneve bankare dhe disponueshmërinë e shërbimeve për klientët. Gjatë vitit 2025 janë realizuar investime të rëndësishme në përmirësimin e platformave

e serverave, sistemeve të ruajtjes së të dhënave dhe rrjetit të komunikimit ndërmjet degëve dhe qendrës së të dhënave. Këto investime kanë mundësuar rritjen e performancës së sistemeve kritike dhe sigurimin e një infrastrukture të qëndrueshme për zhvillimet e ardhshme teknologjike. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar gjithashtu rritjes së kapaciteteve të sistemeve të backup, duke garantuar vazhdimësinë e operacioneve edhe në situata të jashtëzakonshme.

Siguria Kibernetike

Me rritjen e përdorimit të kanaleve digjitale dhe zhvillimin e vazhdueshëm të teknologjisë, siguria kibernetike mbetet një nga prioritetet kryesore të Credins bank. Gjatë vitit 2025, Credins ka vazhduar të investojë në sisteme të avancuara të mbrojtjes së rrjetit, monitorimit të trafikut dhe analizës së logeve, me qëllim identifikimin dhe parandalimin e kërcënimeve kibernetike. Arkitektura e sigurisë së bankës përfshin mekanizma të shumtë kontrolli dhe monitorimi që garantojnë mbrojtjen e të dhënave të klientëve dhe integritetin e sistemeve bankare, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat rregullatore të autoriteteve mbikëqyrëse.

Zhvillimet Teknologjike në "core banking"

Gjatë vitit 2025, Credins ka vazhduar të zhvillojë dhe modernizojë platformën e saj "core banking" për të mbështetur transformimin digjital të bankës dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara ndaj klientëve. Zhvillimet e realizuara kanë synuar rritjen e fleksibilitetit të sistemeve qendrore bankare, duke mundësuar integrimin më të shpejtë të produkteve dhe funksionaliteteve të reja në kanalet digjitale dhe në operacionet e rrjetit të degëve. Përmirësimet në arkitekturën e integritetit dhe në përpunimin e të dhënave kanë kontribuar në rritjen e efikasitetit të proceseve bankare dhe në përmirësimin e eksperiencës së klientëve në përdorimin e shërbimeve financiare. Modernizimi i platformës Core Banking përbën një element të rëndësishëm të strategjisë teknologjike të bankës dhe krijon bazën për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve digjitale dhe inovacioneve në produktet bankare.

Në përputhje me strategjinë e saj të zhvillimit, Credins, do të vazhdojë të investojë në teknologji dhe inovacion, me fokus digjitalizimin e proceseve, përmirësimin e përvojës së klientëve si dhe rritjen e nivelit të sigurisë së sistemeve bankare. Teknologjia do të mbetet një faktor

kyç në zhvillimin e produkteve të reja financiare dhe në përmirësimin e efikasitetit operacional të bankës, duke kontribuar në forcimin e pozicionit të Credins në tregun bankar.

Departamenti i Menaxhimit të Projekteve

Në vitin 2025, Departamenti i planifikimit strategjik dhe menaxhimit të projekteve ka luajtur një rol të rëndësishëm në drejtim të koordinimit të iniciativave që mbështesin zhvillimin strategjik dhe transformimin e bankës. Nëpërmjet një qasjeje të strukturuar të menaxhimit të portofolit të projekteve dhe monitorimit të iniciativave strategjike, departamenti ka siguruar që prioritetet strategjike institucionale të përkthehen në iniciativa konkrete dhe të zbatohen në mënyrë sa më eficiente.

Gjatë vitit, fokusi ka qenë në mbështetjen e transformimit digjital të bankës dhe përmirësimit të proceseve të brendshme të bankës. Programi i transformimit digjital të Bankës, i cili ka disa vite që është ndërmarrë, ka qenë prioritet strategjik edhe gjatë vitit 2025. Në këtë kuadër, gjatë vitit, departamenti ka koordinuar dhe monitoruar një sërë projektsh strategjike, të cilat synojnë modernizimin e infrastrukturës operative të bankës dhe forcimin e kapaciteteve për të ofruar shërbime gjithnjë e më të orientuara drejt klientit.

Objektivat kryesorë të departamentit gjatë vitit 2025 kanë qenë:

- Forcimi i procesit të planifikimit strategjik dhe monitorimit të performancës
- Menaxhimi dhe monitorimi efektiv i portofolit të projekteve strategjike
- Mbështetja e iniciativave të transformimit digjital
- Optimizimi i proceseve të brendshme dhe rritja e eficiencës operationale

Projektet kryesore në të cilat departamenti ka qenë i angazhuar gjatë vitit 2025 kanë qenë:

Implementimi i sistemit CRM (modulet 360 gradë, marketing, contact centre)

Gjatë vitit 2025, nisi puna për projektin e implementimit të sistemit CRM. Pasi u realizua studimi i fizibilitetit dhe një analizë e thelluar, u përzgjodh platforma Creatio për zhvillimin dhe implementimin e sistemit CRM. Qëllimi i këtij projekti është zhvillimi dhe implementimi i një sistemi CRM që do të përdoret për të menaxhuar dhe analizuar ndërveprimet dhe të dhënat gjatë gjithë ciklit të jetës së klientit, me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj klientit, rritjen e jetëgjatësisë së bashkëpunimit, si dhe rritjen e shitjeve. Rezultati i pritshëm i projektit është implementimi i një sistemi të centralizuar të të dhënave të klientit, i dizenuar për të organizuar, automatizuar dhe sinkronizuar proceset e biznesit dhe aktivitetet e shitjes, duke përfshirë marketingun, shërbimin ndaj klientit dhe suportin teknik.

Gjatë vitit janë implementuar tre modulet e para të platformës: Customer 360 Degree, moduli i marketingut dhe ai i Contact Center. Të tre janë module të reja, të cilat do të sjellin përmirësimin e menaxhimit të klientëve, automatizim dhe ndërveprim efektiv në shumë procese që prekin aktivitetet e shitjes. Rishikimi dhe optimizimi i proceseve (projekt i cili është ende në vazhdim). Ky projekt ka si qëllim përmirësimin e eficiencës së operationeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të brendshme të bankës, si dhe krijimin e një modeli shërbimi më efektiv. Një numër i madh procesesh janë standardizuar, thjeshtuar



Programi i transformimit digjital ka qenë prioritet strategjik edhe gjatë vitit 2025, me modernizimin e infrastrukturës së bankës dhe forcimin e kapaciteteve digjitale për të ofruar shërbime të dedikuara për klientin.

dhe automatizuar, duke rritur ndjeshëm eficiencën, duke ulur kostot e burimeve njerëzore dhe materiale, dhe në të njëjtën kohë duke ndikuar në përmirësimin e shërbimit dhe eksperiencës së klientëve. Në këtë aspekt, rezultatet kanë qenë të dukshme dhe të suksesshme.

- Një numër i madh procesesh janë standardizuar, thjeshtuar dhe automatizuar, duke rritur ndjeshëm eficiencën, duke ulur kostot e burimeve njerëzore dhe materiale, dhe në të njëjtën kohë duke ndikuar në përmirësimin e shërbimit dhe eksperiencës së klientëve.
- Janë rishikuar të gjithë format dhe formularët e ofruar klientëve për rritjen e saktësisë, transparencës dhe cilësisë së shërbimit.
- Automatizimi i procesit të menaxhimit të kontratave me palët e treta.
- Automatizimi i disa proceseve, duke kursyer kohë dhe burime.

DEPARTAMENTI
BURIMEVE
NJERËZORE

5

 **CREDINS
BANK**



Zgjidhje e zgjuar
Vlerë për **biznesin**

Departamenti Burimeve Njerëzore

Gjatë vitit 2025, Departamenti i Burimeve Njerëzore vijoi të mbështesë strategjinë e bankës përmes zhvillimit të kapitalit njerëzor, forcimit të kulturës organizative dhe promovimit të një mjedisi pune gjithëpërfshirës të orientuar drejt performancës. Prioritetet kryesore përfshinë menaxhimin e talenteve, zhvillimin profesional, mirëqenien e punonjësve si dhe krijimin e mundësive për balancën mes jetës profesionale dhe asaj personale.

Rekrutimi dhe zhvillimi i talenteve

Përmes nismave të ndryshme të rekrutimit si pjesëmarrja në panairë punësimi, përfshirë panairin "Work & Study" në Tiranë, si dhe panairë punësimi në qytetet Kukës, Peshkopi, etj., Credins vazhdon të japë prioritet punësimit të rinjve. Në kuadër të rekrutimit & zhvillimit të talenteve të reja, gjatë vitit u lançua sërish programi "You Are Credins", i cili përfshiu 10 studentë. Pas përfundimit të fazës teorike të trajnimit, pjesëmarrësit vijuan me trajnimin praktik në disa degë të bankës. Duke parë edhe dinamikat që tregu ofron mbi zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionit, drejtues të disa njësive morën pjesë në një trajnim të specializuar mbi Inteligjencën Artificiale.

Vlerësimi dhe motivimi i punonjësve

Vlerësimi i performancës përbën një ndër shtyllat kryesore të Credins, duke garantuar harmonizimin e objektivave individuale me ato organizative. Ky proces jo vetëm që mbështet zhvillimin dhe rritjen profesionale të punonjësve, por gjithashtu kontribuon drejtpërdrejt në realizimin e objektivave strategjike të bankës. Në të njëjtën kohë, ai shërben si një instrument i rëndësishëm për vendimmarrje, duke orientuar promovimet, trajnimet dhe lëvizjet e brendshme brenda organizatës.

Bazuar në rezultatet e vlerësimit të performancës për vitin 2024, gjatë vitit 2025 u zbatua një rritje pagash për 825

punonjës në Zyrën Qendrore dhe në Rrjetin e Degëve. Shpërblimi i punonjësve më të mirë bazuar në rezultatet e arritura ka qenë vazhdimisht në qendër të strategjisë tonë. Në këtë aspekt, Credins vijoi politikën e shpërblimit sipas performancës së mirë.

- > 684 Punonjës u vlerësuan dhe u shpërblyen financiarisht me të paktën një bonus;
- > 142 Punonjës nga Drejtoria Qendrore përfituan bonus;
- > 542 Punonjës nga Rrjeti i Degëve përfituan bonus;
- > Zhvillimi i karrierës së punonjësve mbeti një nga prioritetet më të rëndësishme me 144 promovime, nga të cilat 21 në pozicione drejtuese.

Mirëqenia dhe balanca punë-jetë

Mirëqenia e punonjësve vazhdon të mbetet një prioritet i rëndësishëm për Credins bank.

Gjatë muajve të verës Qershor, Korrik dhe Gusht, u aplikua iniciativa "Summer Friday", e cila u mundësoi punonjësve të përfundonin orarin e punës në

orën 14:30, të premteve.

Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies erdhën si prioritet edhe përmes organizimeve të disa aktiviteteve si:

- > Sesioni edukues "Rëndësia e Kujdesit Kiropraktik për Shëndetin Fizik dhe Mendor", me pjesëmarrjen e rreth 40 punonjësve. Ky sesion u fokusua në promovimin e mirëqenies fizike, parandalimin e problemeve të shkaktuara nga qëndrimi në punë dhe mbështetjen e shëndetit mendor.
- > Iniciativa "Tetori – Muaji i Shëndetit dhe Mirëqenies" e cila kishte për qëllim promovimin e mirëqenies fizike dhe mendore të punonjësve, ishte një tjetër investim i kujdesshëm për punonjësit tanë.

Si pjesë e iniciativave të bankës për të promovuar kulturën e leximit dhe mësimin e vazhdueshëm, u organizuan gjithashtu edhe disa aktivitete të veçanta të lidhura me librin.

Angazhimi social dhe aktivitetet për komunitetin

Credins vazhdoi edhe përgjatë vitit 2025, të mbështesë nisma sociale dhe komunitare, duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive të punonjësve. Për të shtatin vit radhazi, punonjësit iu bashkuan nismës "Dhuro gjak, shpëto një jetë", ku 35 punonjës u angazhuan vullnetarisht për të dhuruar gjak për njerëzit në


nevojë. Gjithashtu u organizuan aktivitete të ndryshme për të forcuar bashkëpunimin dhe frymën e ekipit, ndër të cilat:

- > Kampionati i Volejbollit në Plazh në Rana e Hedhun, Shëngjin, me pjesëmarrjen e 92 punonjësve të organizuar në 16 skuadra, promovoi rëndësinë e aktivitetit fizik në cilësinë e punës dhe angazhimit të punonjësve si dhe rritjen e bashkëveprimit në skuadra.
- > Festa për Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve në Farm Hub, Ndroq, me pjesëmarrjen e rreth 150 fëmijëve në një ambient të gëzueshëm, festiv dhe gjithëpërfshirës përmes aktiviteteve të ndryshme kreative dhe edukative.
- > Kurse basketbolli për 40 fëmijë të punonjësve, që synuan promovimin e aktivitetit fizik dhe disiplinës, duke forcuar njëkohësisht lidhjen mes bankës dhe familjeve të punonjësve.


Struktura dhe organizimi i stafit

Në fund të vitit 2025, Credins numëronte 1,164 punonjës, ose 2.8% më shumë krahasuar me vitin 2024, duke e renditur ndër korporatat kryesore në vend për sa i përket punësimit dhe zhvillimit të talenteve. Qarkullimi i punonjësve gjatë vitit 2025 ishte 9.5%, ndjeshëm më i ulët se mesatarja e sistemit bankar prej 13.2%. Moshë mesatare e stafit është 36.5 vjeç, ndërsa struktura sipas gjeneratave paraqitet si më poshtë:

Moshë mesatare e stafit është 36.5 vjeç



Raporti gjinor në bankë në fund të vitit 2025 ishte:



Në nivel menaxherial, **19.8%** e punonjësve mbajnë pozicione drejtuese, ku:

Trajnimi dhe zhvillimi profesional



Trajnimi dhe zhvillimi profesional i stafit mbeti një prioritet i rëndësishëm gjatë vitit 2025, me fokus të veçantë tek stafi i degëve.

Në total u realizuan 43,755 orë trajnimi, të ndara si më poshtë:

- > 15,115 orë trajnime për stafin ekzistues;
- > 16,800 orë trajnime për punonjës të rinj;
- > 11,840 orë trajnime për stafin e promovuar ose që ka ndryshuar pozicion

Grafika e statistikave të trajnimeve:



43.755
totali i orëve
të trajnimit



7.293
totali i ditëve
të trajnimit



6,64
mesatarja ditë trajnimi
për 1 punonjës



1.115
punonjës ekzistues
të trajnuar

Politika e pagave dhe shpërblimeve

Credins bank zbaton Politikën e Pagave dhe Shpërblimeve, e cila përshkruan të gjitha format dhe elementet e shpërblimit përfshirë pagën, bonuset, përfitimet e tjera financiare dhe jo financiare si dhe përfitimet nga pjesëmarrja në skemat e pensioneve vullnetare. Credins është një nga punëdhënësit lider në treg, mbështetur fort në individë të kualifikuar, me përvojë dhe të dedikuar në shërbimin ndaj klientit, që është thelbësore për përmbushjen e objektivave të biznesit. Gjithashtu, Credins përcakton nivele konkurruese pagash në sektorin bankar dhe shpërblime që u ofrojnë punonjësve siguri dhe motivim. Politika që ndjek Credins në përcaktimin e shpërblimeve synon të realizojë dhe garantojë arritjen e objektivave:

- > Shpërblimin mbi performancën dhe cilësinë e punës;
- > Mbajtjen e bankës në një pozicion konkurrues në treg;
- > Motivimin e punonjësve nëpërmjet shpërblimit të diferencuar për përgjegjësi, pozicion pune dhe aftësi profesionale të diferencuara;
- > Shpenzimet e bankës për pagat në totalin e kostos së personelit dhe buxhetit të bankës në tërësi të jenë në parametra të pranueshëm.

Shpërblimet në Credins bank përbëhen nga dy elementë kryesorë:

- **Elementi i pandryshueshëm**, që është Paga Bazë, një element i përhershëm, i paracaktuar dhe i parevokueshëm. Përfaqëson pjesën më të lartë në totalin e shpërblimit, me qëllim që të lejojë funksionimin e politikave elastike/fleksibël për elementin e ndryshueshëm në shpërblim;
- **Elementi i ndryshueshëm (bonuset dhe skemat nxitëse)** i shpërblimit përcaktohet në varësi të situatës financiare të bankës, performancës së përgjithshme të saj si dhe performancës individuale të njësive të biznesit. Elementi i ndryshueshëm i shpërblimit (pra bonuset dhe skemat incentivuese) përcaktohet në varësi të situatës financiare të bankës, performancës së përgjithshme dhe performancës individuale të çdo njësie të biznesit.

Përfitimet shtesë përfshijnë elementë monetarë dhe jo-monetarë që synojnë të përmirësojnë mirëqenien e punonjësve, si:

Shpërblimet monetare (Bonuset)

- > Bonuse tremujore për forcën shitëse, bazuar në rezultatet e shitjeve të produkteve të ndryshme bankare;
- > Bonuse 6 mujore për stafin e Drejtorisë Qendrore, sipas Politikës së Punonjësve me Rezultate të larta dhe në përputhje me buxhetin e miratuar;
- > Bonuse për drejtuesit ekzekutivë dhe pozicione të tjera kyçe;
- > Pagë të 14-të si një bonus vjetor, që shpërndahet i plotë, nëse rezultati i parashikuar financiar i bankës është realizuar në masën mbi 80%;
- > Bonusi i fundvitit;
- > Shpërblime në rast fatkeqësish/sëmundjesh;
- > Kjo politikë e balancuar shpërblimi synon të krijojë një ambient pune të drejtë, motivues dhe të qëndrueshëm, ku çdo punonjës ndjehet i vlerësuar për kontributin e tij.

Përfitime të Tjera

- > Ditë shtesë leje sipas vjetërsisë në punë;
- > Kontroll mjekësor periodik;
- > Norma preferenciale për produktet e bankës
- > Rimbursime telefonie sipas pozicioneve të caktuara;
- > Aktivitete speciale që synojnë "Team Building"
- > Kontribut në Fondin Vullnetar të Pensionit Privat nga Punëdhënësi;

- > Dhurata apo organizime të ndryshme për fëmijët e punonjësve të stafit me rastin e festave;ndryshme për fëmijët e punonjësve të stafit me rastin e festave;

Format dhe elementet e shpërblimit për Drejtuesit Ekzekutivë të Credins bank sha:

Format dhe elementet e shpërblimit për Drejtuesit Ekzekutivë të Credins bank sha:

Vlera totale e agreguar e pagave dhe shpërblimeve për vitin	E menjëhershme për periudhën aktuale 2025	Për periudhën e mëparshme 2024
Elemente të pandryshueshëm të shpërblimit	93,178,430	91,483,498
Cash/Bonus	93,178,430	91,483,498
Aksione		
Të tjera		
Elemente të ndryshueshëm të shpërblimit	40,631,759	36,427,153
Cash/Bonus	40,631,759	36,427,153
Aksione		
Të tjera		

Format dhe elementet e shpërblimit për Këshillin Drejtues të Credins bank sha:

Vlera totale e agreguar e pagave dhe shpërblimeve për vitin	E menjëhershme për periudhën Aktuale 2025	Për periudhën e mëparshme 2024
Elemente te pandryshueshem te shperblimit	5,265,450	3,614,220
Cash/Bonus	5,265,450	3,614,220
Aksione		
Të tjera		
Elemente të ndryshueshëm të shpërblimit	15,116,267	12,653,762
Cash/Bonus	15,116,267	12,653,762
Aksione		
Të tjera		

QEVERISJA
KORPORATIVE

06



Sepse çdo fëmijë
meriton të luajë

dhuro në  smile.al

Qeverisja Korporative

Banka operon në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator për sistemin bankar në Shqipëri dhe me tërësinë e akteve të brendshme të hartuara për një qeverisje sa më të mirë bazuar në praktikatat më të mira ndërkombëtare të qeverisjes korporative.

Themeli i besimit midis aksionarëve, drejtorëve dhe menaxherëve përbëhet nga katër shtylla të qeverisjes korporative:

- **Transparenca:** Dhënia e informacionit të saktë dhe në kohën e duhur publikut dhe palëve të treta të interesuara në lidhje me çështjet materiale të korporatës, përfshirë situatën financiare, performancën, pronësinë dhe qeverisjen e bankës.
- **Përgjegjshmëria:** Drejtorët janë përgjegjës për vendimet dhe veprimet e tyre ndaj aksionarëve dhe në raste të caktuara, ndaj palëve kryesore të interesit.
- **Paanshmëria:** Banka është e detyruar të mbrojë të drejtat e aksionarëve dhe të sigurojë një trajtim të barabartë të të gjithë aksionarëve, përfshirë aksionarët me pakicë aksionesh.
- **Përgjegjësia:** Drejtuesit i kryejnë detyrat e tyre me ndershmëri, paanshmëri dhe integritet. Banka i njeh të drejtat e palëve të tjera të interesit siç janë të parashikuara në ligje dhe rregullore, si dhe inkurajon bashkëpunimin për krijimin e ndërmarrjeve të qëndrueshme dhe financiarisht stabël.

Struktura e qeverisjes së përgjithshme e Credins bank

Asambleja e Aksionarëve përfaqësohet dhe përbëhet

nga aksionarët e bankës që zotërojnë aksione me të drejtë vote në përputhje me pjesëmarrjen në kapitalin e bankës. Është organi më i lartë vendimmarrës i bankës që vendos për çështje të caktuara me shumicë të thjeshtë ose të cilësuar, siç përcaktohet në Statut dhe në Ligjin Nr. 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Vendimet e këtij organi, të marra në përputhje me ligjin, janë të detyrueshme për të gjithë aksionarët, këshillin drejtues, drejtorinë dhe punonjësit, apo përfaqësuesit e bankës.

Këshilli Drejtues është një organ vendimmarrës, përgjegjës për drejtimin strategjik të bankës dhe përbëhet nga 7 anëtarë (drejtorë jo-ekzekutivë dhe drejtorë ekzekutivë) të cilët ushtrojnë kompetencat për një periudhë jo më të gjatë se katër vjet, me të drejtë rizgjedhjeje pa kufizim. Këshilli Drejtues ushtron kompetencat e tij, në përputhje me dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve të Bankës së Shqipërisë dhe të statutit të kompanisë.

Gjatë vitit 2025, Këshilli Drejtues u mbledh fizikisht 5 herë në përputhje me planin vjetor. Kuorumi në çdo mbledhje ka qenë me 100% pjesëmarrje.

Nëpërmjet raportimeve periodike tremujore të njësive kryesore, Këshilli Drejtues ka mbikëqyrur gjendjen financiare të bankës, funksionimin e strukturave organizative dhe veprimtarinë e drejtorisë; zbatimin e politikave dhe strategjive të bankës në lidhje me planin e biznesit, administrimin e riskut dhe buxhetin vjetor për vitin 2025 duke përcaktuar dhe monitoruar realizimin e objektivave afatgjata dhe efektivitetin e praktikave të drejtimit të bankës. Për këtë

qëllim, në mbledhjen e muajit dhjetor 2025 u shqyrtuan rezultatit praparak financiar për mbylljen e vitit 2025, buxheti si dhe plani i biznesit për vitin e ardhshëm.

Këshilli Drejtues miraton paraprakisht me 2/3 e votave të gjitha veprimet e bankës, rezultati i të cilave sjell ose rrit ekspozimin e bankës ndaj klientëve me ekspozim mbi 10% të kapitalit rregullator dhe personave me një marrëdhënie të veçantë me bankën. Ky organ ka monitoruar dhe trajtuar në mënyrë të vazhdueshme konfliktet e mundshme të interesit të Drejtorëve, të Anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe të Aksionarëve, përfshirë këtu edhe trajtimin e konflikteve të mundshme të interesit, që mund të rrjedhin nga keqpërdorimi i mjeteve të bankës dhe veprimet me personat e lidhur.

Gjithashtu, përgjatë vitit Këshilli Drejtues ka rishikuar dhe ka miratuar një numër të madh aktesh të brendshme rregullative, të ndryshuara ose të hartuara për herë të parë në përputhje me nevojat e brendshme të kompanisë dhe kërkesat e rregullatorit.

Përbërja aktuale e Këshillit Drejtues është sa më poshtë:

Anëtari	Pozicioni	Mandati
Saimir Sallaku	Kryetar	qershor 2022 – qershor 2026
Clive Moody	Zv. Kryetar	qershor 2022 – qershor 2026
Maltin Korkuti	Anëtar	qershor 2022 – qershor 2026
Monika Milo	Anëtare	qershor 2022 – qershor 2026
Elton Toro	Anëtar	tetor 2025 – qershor 2029
Raimonda Duka	Anëtare	maj 2024 – maj 2028
Jonas Hasselrot	Anëtar	dhjetor 2023 – dhjetor 2027

Shumica e anëtarëve të Këshillit Drejtues janë individë të cilët, në çastin e zgjedhjes dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së mandatit nuk janë të lidhur me marrëdhënie interesash private

me bankën, apo me aksionarët e saj, të cilët sipas ligjit, konsiderohen se ushtrojnë kontroll mbi bankën dhe as me drejtuesit e saj ekzekutivë. Në zbatim të përgjegjësisë të tyre, anëtarët e Këshillit Drejtues iu nënshtrohen standardeve më të larta të etikës dhe veprojnë në bazë të informacioneve të mjaftueshme, të duhura me mirëbesim

dhe në interesin më të mirë të bankës, si dhe me përkujdesje, të përkushtuar plotësisht ndaj përgjegjësi-ve të tyre, në mbrojtje të sigurisë dhe vazhdimësisë së aktivitetit bankar dhe financiar të bankës.

Drejtoria organizon dhe drejton në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e bankës. Mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësi-ve të deleguara në përputhje me politikat dhe procedurat e miratuara. Ndërmerr masat e nevojshme për të monitoruar dhe administruar të gjitha risqet ndaj të

cilave është e ekspozuar banka në përputhje me strategjitë e miratuara. Zbaton politikat dhe strategjitë e miratuara si dhe siguron që proceset e administrimit të riskut të jenë në përshtatje të vazhdueshme me profilin e riskut të bankës dhe planin e biznesit.

Drejtoria përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe një Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm.

Anëtar	Pozicioni	Mandati
Maltin Korkuti	Drejtor i Përgjithshëm	maj 2023 – maj 2026
Monika Milo	Zv.Drejtores e Përgjithshme	dhjetor 2023 – dhjetor 2026

Drejtori i Përgjithshëm është dhe Kryetar i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve. Ai emërohet për një afat jo më të gjatë se 3 (tre) vjet me të drejtë rizgjedhjeje dhe përfaqëson ligjërisht bankën. Këshilli Drejtues për çështje të veçanta mund të autorizojë përfaqësimin e bankës nga dy anëtarët e drejtorisë së bashku.

Drejtoria informon rregullisht Këshillin Drejtues në mënyrë të plotë dhe në kohën e duhur për çështjet e rëndësishme që lidhen me operacionet e bankës. Në veçanti Drejtoria gjithashtu informon për administrimin e riskut, zbatimin e strategjive dhe politikave si dhe për çdo shmangie nga objektivat e miratuara. Është përgjegjëse për mbajtjen e kontabilitetit të bankës në mënyrën e duhur dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me ligjin.

Drejtoria i paraqet Këshillit Drejtues pasqyrat financiare vjetore të paktën brenda tre muajve pas datës së mbylljes së vitit financiar.

Komitetet në nivel këshilli dhe në nivel banke

Në përputhje me statutin e shoqërisë, Këshilli Drejtues ka miratuar krijimin e komiteteve si më poshtë. Çdo komitet është i formalizuar në aktet e brendshme rregullative.

Komitete në nivel Këshilli					Komitete në nivel banke					
	Komiteti i Kontrollit	Komiteti i Riskut	Komiteti i Shpërbli-meve dhe Emëri-meve	Komiteti ALCO	Komiteti Drejtues i Projekteve	Komiteti i Implemen-timit të Strategjisë	Komiteti i Rishikimit të Politi-kave dhe Proçedur-ave	Komiteti i Produk-teve dhe Shërbi-meve	Komiteti i Sigurisë Kiberne-tike	Komiteti i Riskut Op-eracional

Kryetar	Elton Toro	Jonas Hasselrot	Raimonda Duka	Drejtor i Përgjith-shëm	Drejtor i Përgjith-shëm	Drejtor i Departa-mentit të Planifikimit Strategjik dhe Me-naxhimit të Projekteve	Drejtor i Përgjith-shëm	Drejtor i Përgjith-shëm	Drejtor i Përgjith-shëm	Drejtor i Përgjith-shëm
Anëtar	Raimonda Duka	Maltin Korkuti	Clive Moody	Zv. Drejtor i Përgjith-shëm	Zv. Drejtor i Përgjith-shëm	Drejtor i Divizionit të Admin-istrimit të Riskut	Zv. Drejtor i Përgjith-shëm	Zv. Drejtor i Përgjith-shëm	Zv. Drejtor i Përgjith-shëm	Zv. Drejtor i Përgjith-shëm
Anëtar	Eva Pango	Saimir Sallaku	Jonas Hasselrot	Drejtor i Divizionit të Financës	Drejtor i Divizionit të Admin-istrimit të Riskut	Drejtor i Divizionit të Financës	Drejtor i Depar-tamentit Juridik	Drejtor i Divizionit të Financës	Drejtor i Divizionit Operacio-nal	Drejtor i Divizionit të Admin-istrimit të Riskut
Anëtar				Drejtor i Divizionit Operacio-nal	Drejtor i Departa-mentit të Planifikimit Strategjik dhe të Menax-himit të Projekteve	Drejtor i Divizionit të Te-knologjisë së Infor-macionit	Drejtor i Departa-mentit të Për-puthshmërisë dhe Parandalimit Pastrimit të Parave	Drejtor i Divizionit Operacio-nal	Drejtor i Divizionit të Te-knologjisë së Infor-macionit	Drejtor i Divizionit të Financës
Anëtar				Drejtor i Divizionit të Admin-istrimit të Riskut	Drejtor i Divizionit Operacio-nal	Drejtor i Departa-mentit të Menax-himit të Shitjeve në Degë		Drejtor i Divizionit të Admin-istrimit të Riskut	Drejtor i Departa-mentit të Sigurisë së Infor-macionit dhe Vazhdimë-sisë së Biznesit ¹	Drejtor i Divizionit Operacio-nal
Anëtar				Drejtor i Divizionit të Zhvil-limit të Biznesit	Drejtor i Divizionit të Zhvil-limit të Biznesit	Drejtor i Depar-tamentit Marketing		Drejtor i Divizionit të Zhvil-limit të Biznesit	Drejtor i Departa-mentit të Infrastruk-turës dhe Teknolog-jisë së Infor-macionit ²	Drejtor i Divizionit te Zhvillimit te Biznesit
Anëtar				Drejtor i Departa-mentit të Thesarit ³	Drejtor i Divizionit të Te-knologjisë së Infor-macionit	Drejtor i Departa-mentit të Burimeve Njerëzore		Drejtor i Depar-tamentit Juridik	Drejtor i Drejtorisë së Ap-likacionit Bankar ⁴	Drejtor i Divizionit të Te-knologjisë së Infor-macionit
Anëtar					Drejtor i Div-izionit të Financës			Drejtor i Departa-mentit të Menax-himit të Produk-teve dhe Insti-tucione-ve ⁵	Drejtor i Drejtorisë së Analizës së Biznesit të Brendshmeve ⁶	Drejtor i Departa-mentit të Kontrollit të Brend-shëm ⁷

¹ Pa të drejtë vote

² Pa të drejtë vote

³ Pa të drejtë vote

⁴ Pa të drejtë vote

⁵ Pa të drejtë vote

⁶ Pa të drejtë vote

⁷ Pa të drejtë vote

Anëtar					Drejtor i Departamentit të Burimeve Njerëzore					Drejtor i Departamentit të Risqeve të Integruara
Anëtar										Drejtor i Departamentit të Burimeve Njerëzore
										Drejtor i Departamentit Juridik
										Drejtor i Departamentit të Planifikimit Strategjik dhe Menaxhimit të Projekteve
										Drejtor i Departamentit të Sigurisë
										Drejtor i Departamentit të Përputhshmërisë dhe Parandalimit dhe Pastrimit të Parave
										Drejtor i Departamentit të Sigurisë së Informacionit dhe Vazhdimësisë së Biznesit

Komiteti i Kontrollit përbëhet nga tre anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Aksionarëve. Ky Komitet kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë. Rekomandon Këshillin Drejtues për mangësitë dhe problemet kryesore të konstatuara në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe mënyrat për përmirësimin e tyre. Rishikon planin vjetor të auditimit sipas nevojës dhe i propozon ato për aprovim në Këshillin Drejtues. Shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte. Propozon

ekspertin kontabël të autorizuar dhe realizon komunikimin ndërmjet tij dhe kontrollit të brendshëm të bankës, bën vlerësimin e situatës financiare të bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar. Kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së bankës me aktet ligjore dhe nënligjore. Në çdo rast njofton për përfundimet Këshillin Drejtues

të bankës, i jep mendim Këshillit Drejtues të bankës për të gjitha problemet që i kërkojnë prej këtij të fundit. Miraton raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka me qëllim publikimin e tyre. Monitoron statusin e implementimit të rekomandimeve të lëna nga eksperti kontabël i autorizuar në vijim të auditimit ligjor vjetor. Rishikon konstatimet dhe monitoron statusin e implementimit të rekomandimeve të lëna nga autoritetet mbikqyrëse ekzaminuese etj.

Gjatë vitit 2025 Komiteti i Kontrollit zhvilloi 5 mbledhje të zakonshme ku ndër të tjera shqyrtoi raportin vjetor të auditit të brendshëm për vitin 2024, rishikoi dhe aprovoi planin vjetor të auditimit për vitin 2025. Gjithashtu në çdo tremujor ka shqyrtuar aktivitetin e Departamentit të Auditit të Brendshëm dhe ka rishikuar pasqyrat financiare të bankës. Komiteti i Kontrollit shqyrtoi ofertat dhe propozoi audituesin ligjor për vitin 2025 si dhe letrën e menaxhimit dhe pasqyrat financiare për vitin paraardhës. Ndoqi statusin e rekomandimeve të grupit të inspektimit të Bankës së Shqipërisë me baza 3-mujore, rekomandimet e audituesit të jashtëm si dhe statusin e plotësimit të rekomandimeve të viteve të mëparshme të lëshuara nga Departamenti i Auditit të Brendshëm.

Komiteti i Riskut përbëhet nga tre anëtarë me të drejtë vote. Dy anëtarë të KR-së janë drejtorë jo ekzekutivë dhe

njëri drejtor ekzekutiv. Kryetari është drejtor i pavarur. Të gjithë anëtarët e komitetit janë drejtorë të zgjedhur për kompetencat dhe përvojën e tyre në sektorin bankar dhe administrimin e riskut.

Ky Komitet ka zhvilluar 5 mbledhje gjatë vitit 2025, në të cilat ka vlerësuar dhe rishikuar informacionin e vënë në dispozicion nga CRO-ja lidhur me të gjitha risqet që është përballur banka në çdo tremujor, me riskun e kredisë, të tregut, të likuiditetit, operacional, të mashtrimit, të reputacionit etj. Nëpërmjet raportimeve në çdo mbledhje të Këshillit Drejtues, ky komitet ka asistuar dhe këshilluar këtë organ në funksion të përmbushjes së përgjegjësisë lidhur me profilin aktual dhe strategjinë e ardhshme të riskut të bankës. E gjitha kjo, duke marrë në konsideratë mjedisin aktual dhe të ardhshëm financiar e makroekonomik, harmonizimin e aktivitetit të brendshëm të bankës me kuadrin e jashtëm ligjor dhe rregullator, sigurinë e të dhënave dhe vazhdimësisë së biznesit, shqyrtimin, rekomandimin për miratimin mbi këshillin e oreksit të përgjithshëm të riskut të kredisë si dhe kuadrin të qeverisjes së riskut. Komiteti i Riskut ka shqyrtuar dhe monitoruar në mënyrë aktive përgjatë gjithë vitit ecurinë e ekspozimeve të mëdha të bankës mbi 10% të kapitalit rregullator, të personave me një marrëdhënie të veçantë me bankën duke këshilluar strukturën e riskut rast pas rasti si dhe duke bërë rekomandimet përkatëse pranë Këshillit Drejtues për një vendimmarrje të shëndoshë në përputhje me strategjinë e riskut të bankës.

Komiteti i Shpërblimeve dhe Emërimeve përbëhet nga tre anëtarë, të cilët janë drejtorë jo ekzekutivë me të drejtë vote. Kryetari është drejtor jo ekzekutiv i pavarur. Ky komitet mbikëqyr në çdo rast emërimet dhe sistemin e shpërblimeve. Rishikon, vlerëson dhe i rekomandon Këshillit Drejtues aprovimin e politikave dhe praktikave të emërimeve dhe shpërblimeve. Rishikon kandidaturat e Drejtuesve Ekzekutivë dhe Jo-Ekzekutivë, shpërblimet e tyre, duke u siguruar që kompensimet janë të përshtatshme, në përputhje me objektivat strategjike të bankës, strategjitë afatgjatë të biznesit dhe riskut, performancën, mjedisin e kontrollit, pritshmëritë si dhe kërkesat e rregulloreve.

Gjatë vitit 2025, komiteti është mbledhur 5 herë dhe ka shqyrtuar aktivitetin e Departamentit të Burimeve Njerëzore në çdo tremujor, ka mbikëqyrur vendosjen e objektivave vjetore të Drejtorëve të Divizioneve dhe Drejtorit të Auditit të Brendshëm dhe realizimin e objektivave të vitit të mëparshëm. Ky komitet ka

udhëhequr procesin e vetëvlerësimit të performancës dhe përshtatshmërisë të anëtarëve të Këshillit Drejtues individualisht dhe në mënyrë kolektive, të Administratorëve të tjerë dhe personave me pozicion kyç në bankë. Ka shqyrtuar procesin e rishikimit të performancës dhe procesin e rishikimit të pagave në bankë kundrejt buxhetit, gjithashtu rishikimin e performancës dhe shpërblimin e anëtarëve të Drejtorisë.

Komitetet për aprovimin e Kredive ndiqen nga Divizioni i Riskut sipas shumave, profilit të riskut të kredimarrësit dhe segmentit përkatës. Këto komitete shqyrtojnë dhe aprovjnë ekspozimet kreditore dhe çdo çështje lidhur me kreditimin.

Komiteti i Aktiv Pasiv (ALCO). Anëtarët dhe Kryetari i Komitetit janë të emëruar nga Këshilli Drejtues për një periudhë të pacaktuar.

Qëllimi kryesor i ALCO-s është të mbrojë kapitalin e bankës, mënyrën e investimit të tij me qëllim harmonizimin e aktiveve dhe pasiveve të bankës duke konsideruar strukturën e çmimit (pricing structure) si dhe të maturiteteve, në përputhje me ligjet respektive dhe rregulloret e brendshme. Komiteti ALCO mbledhet të paktën një herë në muaj si dhe sa herë kërkohet në aktet e brendshme rregullative. Kryetari i Komitetit mund të kërkojë mbledhje të jashtëzakonshme nëse e konsideron të nevojshme.

Komiteti i Produkteve dhe Shërbimeve (KPSH) është krijuar me vendim të Këshillit Drejtues të bankës. Anëtarët dhe Kryetari i Komitetit janë të emëruar nga Këshilli Drejtues për një periudhë të pacaktuar.

Qëllimi kryesor i KPSH-së është miratimi i produkteve dhe shërbimeve, të cilat do të gjenerojnë të ardhura për bankën. Ky miratim vjen në përputhje me strategjinë dhe planin e zhvillimit të biznesit të miratuar nga Këshilli Drejtues i bankës, në përputhje me zhvillimet, kërkesat e tregut, klientelës së synuar, si dhe modifikimi i atyre ekzistueseve.

Komiteti Drejtues i Projekteve (KDP) ka për qëllim të administrojë, rishikojë, mbikëqyrë si dhe të vendosë përparësitë lidhur me projektet në bankën Credins nga pikëpamja shumë funksionale.

Ai siguron dhe këshillon drejtuesit e bankës për zbatimin me sukses të projekteve dhe iniciativave strategjike në

përputhje me strategjinë e miratuar të bankës.

Roli i Komitetit Drejtues të Projekteve është të mbikëqyrë mbarëvajtjen e projekteve, të sigurojë mbështjen dhe orientimin e nevojshëm për arritjen e objektivave të tyre dhe përputhshmërinë me strategjinë e bankës.

KDP-ja është krijuar me vendim të Këshillit Drejtues të bankës. Kryetari emërohet nga Këshilli Drejtues, ndërkohë që zv. kryetari dhe anëtarët e komitetit emërohen nga kryetari. KDP-ja do të mbledhet sa herë është e nevojshme dhe ka kërkesa nga kryetari dhe/ose anëtarët.

Komiteti i Rishikimit të Politikave dhe Procedurave (KPP) Është krijuar me vendim të Këshillit Drejtues të bankës. Anëtarët dhe kryetari i komitetit emërohen nga Këshilli Drejtues për një periudhë të pacaktuar.

Qëllimi kryesor i KPP-së është krijimi, miratimi apo modifikimi, në përputhje me kuadrin ligjor të jashtëm dhe atë rregullativ të brendshëm, i politikave, procedurave, rregulloreve, udhëzimeve, manualeve dhe metodologjive si dhe akteve të tjera rregullative të bankës për të siguruar që aktiviteti i brendshëm të jetë i rregulluar në të gjitha aspektet dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në rast të barazimit të votave gjatë votimit, vota kryetarit është vendimtare. KPP-ja mbledhet sa herë kërkohet nga Kryetari i Komitetit, në

përputhje me nevojat e bankës dhe kërkesat e Këshillit Drejtues apo të ligjvënësit.

Komiteti i Sigurisë Kibernetike ka për qëllim të administrojë, rishikojë, mbikëqyrë dhe të vendosë përparësitë lidhur me aktivitetin dhe iniciativat e IT-së në Bankën Credins nga pikëpamja teknike dhe e sigurisë kibernetike, si dhe të sigurojë dhe këshillojë Menaxhmentin e Bankës në kuadër të të gjitha nismave të ndërmarra nga Banka për sigurinë e informacionit. Komiteti i Sigurisë Kibernetike koordinon, komunikon qeverisjen, programin e teknologjisë si dhe atë të sigurisë së informacionit. Ai siguron dhe këshillon Menaxhmentin e Bankës për zbatimin me sukses të iniciativave të sigurisë së informacionit në përputhje me objektivat e Bankës.

Komiteti i Riskut Operacional është një komitet i përhershëm vendimmarrës dhe këshillues për drejtuesit e bankës, misioni i të cilit është të sigurojë një menaxhim të kualifikuar dhe kompetent të çështjeve të riskut operacional (risku i KTI-së/Kibernetik, risku ligjor,etj.) në përputhje me rregulloret e brendshme dhe kuadrin rregullativ të jashtëm. Ka për qëllim të rishikojë, mbikëqyrë dhe vendosë përparësitë për administrimin e riskut operacional në përputhje me oreksin për risk të bankës. Veprimtaria e këtij komiteti fokusohet në ngritjen e politikave, planeve të menaxhimit të riskut

operacional, përcaktimin dhe monitorimin e treguesve të riskut operacional. Gjithashtu ky komitet, shqyrton, aprovon mbi politikat e riskut operacional, rishikon modelet e përdorura për identifikimin si dhe vlerësimin e riskut operacional.

Kriteret e përzgjedhjes dhe emërimit të Administratorëve

Banka ka hartuar një politikë të veçantë për përzgjedhjen, vlerësimin dhe shpërblimin e Administratorëve të saj, e cila bazohet në kuadrin ligjor dhe rregulator në fuqi, si dhe në praktikën më të mira të qeverisjes korporative.

Këshilli Drejtues vlerëson dhe sigurohet në çdo kohë, që kandidati i ri ose kandidati që promovohet në një pozicion Administratori të jetë i përshtatshëm dhe të përmbushë të gjitha kriteret dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore.

Gjatë intervistave për emërimet e reja do të merren në konsideratë edhe sjelljet që kandidatët për drejtorë joekzekutivë kanë gjasa të shfaqin, për të siguruar që në sallën e Këshillit të ruhet një mjedis në të cilin sfidat priten dhe arrihen. Objektivi i Këshillit është që shumica e anëtarëve të KD-së të përbëhet nga drejtorë joekzekutivë të pavarur, përfshirë kryetarin e këshillit dhe kryetarët e komiteteve kryesore të këshillit, të cilët duhet të kenë përvojë në sektorin bankar dhe/ose financiar.

Ndër faktorët që luajnë rol në konstatimin e pavarësisë së qenësishme dhe të perceptuar të anëtarit të KD-së janë:

- Gjatë viteve të fundit nuk ka qenë punëmarrës i shoqërisë tregtare;
- Nuk ka asnjë marrëdhënie tregtare me rëndësi materiale me shoqërinë tregtare;
- Nuk merr pagë (tjetër) nga shoqëria tregtare gjatë mandatit si anëtar i këshillit (përveç oreve jashtë orarit);
- Nuk ka lidhje të afërta familjare me asnjërin prej këshilltarëve, anëtarë të këshillit apo punëmarrësve kryesorë të shoqërisë tregtare;
- Nuk është anëtar i këshillit ose nuk ka lidhje të rëndësishme me anëtarët e tjerë të këshillit përmes përfshirjes në shoqëri tregtare apo organe të tjera;
- Nuk përfaqëson një aksionar të rëndësishëm;

- Nuk është anëtar i këshillit për një periudhë të gjatë;

Në rishikimin e përbërjes së këshillit do të konsiderohen avantazhet e larmishmërisë, përfshirë përbërjen gjinore të këshillit, si dhe do të shikohet që të sigurohet një përzierje gjeografike e drejtorëve, bashkë me eksperiencën në sektorë të ndryshëm të industrisë. Të gjithë kandidatët për emërim duhet të vërtetojnë njohuritë e kërkuara në fushën financiare për të kuptuar si duhet veprimtaritë e bankës dhe risqet që i shoqërojnë ato.

Në çdo kohë, Këshilli Drejtues gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për antarë të KD-së ose gjatë procesit të rivlerësimit ose rizgjedhjes së anëtarëve aktualë siguron që njohuritë, eksperiencat dhe kualifikimet ndërthuren njëkohësisht me ato të anëtarëve të tjerë, në mënyrë që të krijohet një kualifikim kolektiv, i përshtatshëm dhe i balancuar.

Sistemi i Kontrollit të Brendshëm dhe i Menaxhimit të Riskut lidhur me raportimin financiar

Këshilli Drejtues dhe Drejtoria janë përgjegjës për krijimin dhe përcaktimin e një sistemi të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm dhe të menaxhimit të riskut që përfshin të gjithë procesin e raportimit financiar duke respektuar në të njëjtën kohë kërkesat e kompanisë.

Banka dhe organet e saj të qeverisjes janë angazhuar maksimalisht që sistemi i kontrollit të brendshëm të ofrojë një siguri të arsyeshme në lidhje me integritetin dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare të konsoliduara, mbrojtjen e aseteve nga përdorimi ose disponimi i paautorizuar, parandalimin si dhe zbulimin e raporteve financiare mashtruese.

Këshilli Drejtues nëpërmjet Komitetit të Kontrollit ka vlerësuar sistemin e kontrollit të brendshëm të kompanisë sipas kriterëve për një kontroll të brendshëm të efektshëm. Këto kriterë përbëhen nga pesë komponentë të ndërlidhur të cilët janë: mjedisi i kontrollit, vlerësimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informacioni, komunikimi dhe monitorimi.

Deklarata e Këshillit Drejtues mbi oreksin dhe tolerancën ndaj rrezikut të ndërmarrë në përmbushje të objektivave strategjike të bankës

Gjatë vitit 2025, Këshilli Drejtues i Credins bank ka vijuar të ushtrojë funksionin e tij mbikëqyrës dhe strategjik në përputhje me objektivin për të garantuar që banka të operojë brenda një strukture të qëndrueshme të menaxhimit të riskut.

Një nga shtyllat kryesore të kësaj strukture është përcaktimi dhe zbatimi i një oreksi për risk që është në harmoni me kapacitetin financiar të bankës, planifikimin strategjik dhe përkushtimin ndaj kërkesave rregullatore dhe plotësimit të shërbimit ndaj klientëve.

Këshilli ka miratuar një kornizë të qartë për oreksin për risk e cila shërben për vendimmarrjen në të gjitha nivelet e bankës. Kjo kornizë përcakton nivelin dhe natyrën e riskut që banka është e gatshme të pranojë në funksion të arritjes së objektivave të saj afatshkurtra dhe afatgjata, duke përfshirë rritjen e qëndrueshme të portofolit të kredisë, përmirësimin e efikasitetit operativ, forcimin e pozitës së kapitalit dhe zhvillimin e inovacionit.

Gjatë këtij viti Këshilli Drejtues i bankës ka riafirmuar dhe mbikëqyrur zbatimin e oreksit për risk, duke garantuar se është në përputhje me kapacitetin e pranueshëm të riskut dhe me qëllimin e bankës për rritje të qëndrueshme, qeverisje të mirë dhe menaxhim efektiv të burimeve.

Në linjë me filozofinë e përgjithshme të menaxhimit të

riskut, oreksi për risk i bankës është kufizuar në drejtim të:

- Riskut të kredisë, duke ruajtur standardet e huadhënies dhe një angazhim të qartë ndaj analizës së kujdesshme të klientëve dhe sektorëve ku banka operon;
- Riskut operacional, në drejtim të humbjeve operacionale dhe përshkallëzimit të treguesve kyç të riskut operacional;
- Riskut të likuiditetit të tregut duke përshkallëzuar treguesit rregullatorë të brendshëm në nivele paralajmëruese si dhe zbatimin e masave korrigjuese në kohën e duhur;
- Treguesve të kapitalit, duke përcaktuar tregues që sigurojnë përmbushjen e normave minimale të përcaktuara nga rregullatori, shtesave makroprudenciale, nevojave për kapital për zhvillimin sipas strategjisë së bankës dhe efektin e goditjeve të faktorëve makroekonomik;
- Riskut të përqendrimit në funksion të uljes së nivelit të këtij risku dhe nxitjes së diversifikimit;

Banka ka një tolerancë minimale për riskun reputacional dhe atë të përputhshmërisë, duke vepruar gjithmonë në përputhje me pritshmëritë e klientëve, rregullatorëve si dhe standardeve etike.

Në këtë kontekst, Këshilli Drejtues e konsideron oreksin

për risk jo si një koncept statik, por si një element dinamik që duhet të rishikohet dhe përditësohet në përputhje me zhvillimet në tregje, ndryshimet rregullatore si dhe evolucionin e vetë modelit të biznesit të bankës. Gjatë vitit 2025, janë ndërmarrë rishikime periodike për të siguruar që oreksi për risk të mbetet i përshtatshëm në përputhje me klimën makroekonomike.


Këshilli nënvizon gjithashtu rëndësinë e ndërtimit të një kulture institucionale që e vendos menaxhimin e riskut në themel të proceseve vendimmarrëse, ku çdo nivel i organizatës ka përgjegjësi të qartë për të operuar brenda kufijve të përcaktuar të riskut si dhe për të kontribuar në mbrojtjen dhe forcimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të bankës.

Në përfundim, Këshilli Drejtues riafirmmon përkushtimin e tij për të mbikëqyrur në mënyrë efektive oreksin për risk dhe për të siguruar që banka të ecë drejt objektivave të saj strategjike me përgjegjësi, transparencë dhe integritet të plotë.

Rrjeti i Degëve

89
atm

52
degë



RAPORTI I AUDITOREVE

07



CREDINS
BANK

Ne fitore dhe në sfida, kudo
së bashku pranë Kombëtares.



**BËHU ZËRI MBËSHTETËS
I KOMBËTARES**

Raporti i Auditoreve

BANKA CREDINS SHA

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më

31 Dhjetor 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

Raporti i Audituesit të Pavarur.....	i-iii
Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes.....	i
Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar	3
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimit të kapitalit	4
Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare	5
1 Të përgjithshme	6
2 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare.....	6
3 Baza e matjes	6
4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes.....	6
5 Paraqitja e pasqyrave financiare të konsoliduara	6
6 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.....	7
7 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpjegimet.....	8
8 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	9
9 Të ardhura neto nga interesat.....	21
10 Të ardhura neto nga komisionet	21
11 Të ardhura të tjera, neto.....	21
12 Humbje nga zhvlerësimi i instrumentave financiarë	22
13 Shpenzime Personeli	22
14 Shpenzime Administrative	22
15 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22
16 Mjete monetare dhe ekuivalente.....	23
17 Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore.....	24
18 Hua dhe paradhënie bankave.....	25
19 Marreveshjet e anasjellta të riblerjes	26
20 Letra me vlerë të matura me VDPFH.....	26
21 Letra me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	27
22 Letra me vlerë të borxhit me kosto të amortizuar.....	30
23 Investime në filiale dhe emri i mirë.....	32
24 Investime në pjesëmarrje.....	32
25 Qira financiare.....	32
26 Hua dhe paradhënie klientëve	35
27 Prona të riposeduara.....	38
28 Prona të mbajtura për investim.....	38
29 Aktive afatgjata materiale	39
30 Aktive jo-materiale.....	40
31 Aktive të drejta-në-përdorim.....	40
32 Aktive të tjera	41
33 Aktive tatimore të shytyra	41
34 Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare.....	41
35 Detyrime ndaj klientëve	42
36 Huatë	42
37 Borxh i perfaqësuar nga letrat me vlerë (MREL).....	43
38 Borxhi i varur	43
39 Detyrimet e qirasë	44
40 Detyrime të tjera.....	44
41 Provizione	44
42 Kapitali aksionar	45
43 Primi i kapitalit.....	45
44 Rezerva e përgjithshme	45
45 Analizë maturiteti për aktivet dhe detyrimet.....	46
46 Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara.....	47
47 Shënime për palët e lidhura	49
48 Administrimi i rrezikut financiar.....	50
49 Ngjarje pas datës së raportimit financiar	73

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Aksionarëve dhe Bordit Drejtues të "Banka Credins Sh.a."

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të "Banka Credins Sh.a." ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet shpjeguese, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2025, si dhe performancën financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të konsoliduara" të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionalë të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi BSNEKP"), si dhe me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, si dhe për kontrollin e brendshëm që drejtimi e konsideron të nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë si rezultat i mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar në vijimësi, për zbulimin, kur është e zbatueshme, të çështjeve që lidhen me vijimësinë dhe për përdorimin e parimit të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi synon të likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetin, ose nuk ka alternativë tjetër reale përveçse ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare të konsoliduara, në tërësi, nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë si rezultat i mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të zbulojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në mënyrë të agreguar, mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, qoftë si rezultat i mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe zbatojmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve dhe sigurojmë evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm që është i rëndësishëm për auditimin, për të hartuar procedura auditimi që janë të përshtatshme në rrethana, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe zbulimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Arrijmë në një përfundim mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi parimit të vijimësisë dhe, bazuar në evidencat e auditimit të marra, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e përgjithshme të pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë zbulimet, dhe nëse ato përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet bazë në një mënyrë që siguron paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Bankës lidhur me, ndër të tjera, shtrirjen dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit.

Informacione të Tjera

Informacionet e tjera përfshijnë informacionin e përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Përveç pasqyrave financiare të konsoliduara dhe këtij raporti të audituesit, drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera të kërkuara me ligj, të cilat pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie lidhur me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë, ne kemi përgjegjësi të lexojmë informacionet e tjera kur ato të bëhen të disponueshme dhe të vlerësojmë nëse ato janë materialisht të papajtueshme me pasqyrat financiare të konsoliduara ose me njohuritë tona të fituara gjatë auditimit. Nëse identifikojmë mospërputhje materiale ose anomali të dukshme materiale, jemi të detyruar të raportojmë këtë fakt dhe ta komunikojmë çështjen me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Bujar Bendo
Auditues Ligjor
RSM Albania
Tiranë, 2 qershor 2026



Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025¹

	Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2025 Lek '000	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2024 Lek '000
Të ardhura nga interesat	9	19,151,447	16,679,416
Shpenzime për interesat	9	(5,176,511)	(4,083,381)
Të ardhura neto nga interesat	9	13,974,936	12,596,035
Të ardhura nga komisionet	10	3,037,028	2,771,729
Shpenzime për komisione	10	(1,262,399)	(1,035,963)
Të ardhura neto nga komisionet	10	1,774,629	1,735,766
Shpenzime të tjera	11	(620,476)	(721,672)
Të ardhura të tjera	11	232,807	660,317
Fitimi nga kurset e këmbimit		577,304	271,592
Të ardhura të tjera bankare		189,635	210,237
Humbje nga zhvlerësimi i instrumentave financiarë	12	(3,436,756)	(3,804,978)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	23	(705,688)	(557,611)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	24	(246,927)	(107,164)
Amortizimi i të drejtave-në-përdorim	25	(533,056)	(573,438)
Shpenzime personeli	13	(2,928,022)	(2,661,350)
Shpenzime administrative	14	(4,049,809)	(3,618,755)
		(11,900,258)	(11,323,296)
Pjesa e humbjes së investimit në pjesëmarrje	18	(589)	(641)
Fitimi para tatimit		4,038,353	3,218,100
Shpenzime tatimi mbi fitimin	15	(785,334)	(608,908)
Fitimi neto i periudhës		3,253,019	2,609,192

¹Shënimet 1 deri 49 në faqet 6 deri 73 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025²

Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2025 Lek '000	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2024 Lek '000
Fitimi neto i periudhës	3,253,019	2,609,192
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse <i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse neto për t'u riklasifikuar në fitim ose humbje në periudhat pasardhëse:</i>		
<u>Investime në letra me vlerë me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse:</u>		
Rivlerësimi i aktiveve financiare	29,653	326,705
Efekti i tatimit fitimit	(3,842)	(49,009)
Fitimi/ (humbja) neto për aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse:	25,811	277,696
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse neto për t'u riklasifikuar në fitim ose humbje në periudhat pasardhëse:	25,811	277,696
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, pas tatimit fitimit	25,811	277,696
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pas tatimit mbi fitimin	3,278,830	2,886,888
Për:		
Aksionerët e Mëmës	3,171,424	2,917,228
Interesi jo-kontrollues	107,406	(30,340)
	3,278,830	2,886,888

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë miratuar nga Bordi Drejtues i Banka Credins sh.a më 15 Maj 2026 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

Z. Maltin Korkuti
Drejtor i Përgjithshëm

Znj. Valentina Prodani
Drejtoresh Departamenti Finance - Kontabilitet



²Shënimet 1 deri 49 në faqet 6 deri 73 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar

më 31 dhjetor 2025¹

Shënime	31 dhjetor 2025 '000 LEK	31 dhjetor 2024 '000 LEK
Aktivët		
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	16	17,043,023
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	17	18,895,639
Hua dhe paradhënie bankave	18	2,249,526
Marrëveshjet e anasjellta të riblerjes	19	1,419,103
Letra me vlerë të matura me VDPFH (të mbajtura për tregtim)	20	3,288
Instrumenta borxhi të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	21	45,972,892
Instrumenta borxhi të mbajtura me kosto të amortizueshme	22	102,029,394
Kuota në fondin e investimit	23	397,522
Investime në pjesëmarrje	24	12,609
Emri i mirë	23	43,371
Qira financiare	25	4,482,905
Hua dhe paradhënie për klientët	26	165,820,729
Tatimi korent	15	-
Prona të riposeduara	27	15,388,543
Prona të mbajtura për investim	28	6,988,837
Aktive afatgjata materiale	29	4,293,872
Aktive afatgjata jomateriale	30	688,304
Aktive të drejta-në-përdorim	31	2,908,383
Aktive të tjera	32	1,886,664
Totali i aktiveve	390,524,604	355,923,597
Detyrimet		
Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare	34	5,856,457
Detyrime ndaj klientëve	35	327,481,595
Huatë	36	1,677,651
Borxh i përfaqësuar nga letrat me vlerë	37	7,002,706
Borxhi i varur	38	11,725,311
Detyrimi tatimor		159,221
Detyrimet tatimore të shtyra	33	401,722
Detyrimet e qirasë	39	3,179,272
Detyrime të tjera	40	783,455
Provizione	41	86,440
Totali i detyrimeve	358,353,830	330,308,213
Kapitali		
Kapitali aksionar	42	20,422,093
Primi i aksioneve	43	5,310,647
Rezerva	44	951,696
Rezerva e rivlerësimit të letrave me vlerë	21	363,955
Fitime të pashpërndara		3,032,771
Totali kapitalit të shoqërisë mëmë	30,081,162	24,962,708
Interesi jo-kontrollues ("NCI")		2,089,612
Total kapitali	32,170,774	25,615,384
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksionar	390,524,604	355,923,597

¹Shënimet 1 deri 49 në faqet 6 deri 73 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimit të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025¹

	Primi i		Rezerva e		Rezerva	Fitimi i		Interesi jo	
	Kapitali aksionar	lidhur me aksionin	përgjithshme	rivlerësimi		pashpërndarë	Total	kontrollues	Total kapitali
	'000 LEK	'000 LEK	'000 LEK	'000 LEK	'000 LEK	'000 LEK	'000 LEK	'000 LEK	'000 LEK
Gjendja më 1 janar 2024	12,480,211	3,855,876	3,725,946	62,163	701,329	20,825,525	491,629	21,317,154	
Fitimi i vitit	-	-	-	-	2,634,648	2,634,648	(25,456)	2,609,192	
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto	-	-	-	282,579		282,579	(4,884)	277,695	
Totali - të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	282,579	2,634,648	2,917,227	(30,340)	2,886,887	
Diferenca në valutë	-	-	-	(4,905)	21,090	16,185	(24,023)	(7,838)	
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë (shënimi 42,44)	1,086,625	-	357,503	-	(1,444,128)	-	-	-	
Dividentë	-	-	-	-	-	-	-	-	
Emetim i aksioneve të reja (shënimi 42)	642,629	561,142	-	-	-	1,203,771	-	1,203,771	
Rritja e investimit në filial nga interesi Jo-kontrollues	-	-	-	-	-	-	-	215,410	
Gjendja më 31 dhjetor 2024	14,209,465	4,417,018	4,083,449	339,837	1,912,939	24,962,708	652,676	25,615,384	
Fitimi i vitit	-	-	-	-	3,135,452	3,135,452	117,568	3,253,020	
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto	-	-	-	35,972	-	35,972	(10,162)	25,810	
Totali - të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	35,972	3,135,452	3,171,424	107,406	3,278,830	
Diferenca në valutë	-	-	-	(11,854)	(106,114)	(117,968)	24,071	(93,897)	
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë (shënimi 42,44)	4,872,044	-	(3,131,753)	-	(1,740,291)	(169,215)	(2,066)	(171,281)	
Dividentë	-	-	-	-	(169,215)	-	-	2,234,213	
Emetim i aksioneve të reja (shënimi 42)	1,340,584	893,629	-	-	-	2,234,213	-	1,307,525	
Rritja e investimit në filial nga interesi Jo-kontrollues	-	-	-	-	-	-	-	1,307,525	
Gjendja më 31 dhjetor 2025	20,422,093	5,310,647	951,696	363,955	3,032,771	30,081,162	2,089,612	32,170,774	

¹Shënimet 1 deri 49 në faqet 6 deri në 73 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025¹

	Shënime	Viti i mbyllur	Viti i mbyllur
		31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
		'000 LEK	'000 LEK
Aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		4,038,353	3,218,100
<i>Rregullimet për:</i>			
Amortizimin dhe zhvlerësimin	29,30	952,615	664,775
Aktivet afatgjata të nxjerra jashtë përdorimi	29	27,260	290,897
Aktivet e së drejtës së përdorimit	31	122,215	610,924
Zhvlerësimi i mjeteve financiare	12	3,436,757	2,340,591
Pjesa takuese e humbjes së investimit në pjesëmarrje	24	589	641
Ndryshimi ne vlerën e drejtë		(301,480)	(7,009)
Zhvlerësimi i pronave të riposeduara	27	329,033	236,676
Të ardhurat neto nga interesat	9	(13,974,936)	(12,596,035)
Efekti i kursit të këmbimit në borxhin e varur		1,673,409	2,212,643
Flukset e mjeteve monetare të përdorura në aktivitetet operative përpara ndryshimeve në kapitalin e punues		(3,696,185)	(3,027,797)
Ndryshimi në hua dhe paradhënie bankave	18	748,025	(872,011)
Ndryshimi në hua dhe paradhënie klientëve	26	(18,588,263)	(13,203,090)
Ndryshimi në qiranë financiare	25	(882,250)	(819,090)
Ndryshimi në shumat e kushtëzuara me Bankën Qëndrore	17	(973,275)	66,993
Ndryshimi në pronat e riposeduara	27	(5,768,050)	(3,052,703)
Ndryshimi në pronat e mbajtura për investim	28	(807,540)	(1,212,498)
Ndryshimi në aktive të tjera	32	(316,101)	(417,733)
Ndryshimi në detyrimet ndaj bankave	34	(3,062,775)	3,332,164
Ndryshimi në detyrimet ndaj klientëve	35	24,636,552	15,150,361
Ndryshimi i detyrimit të qirasë financiare	39	(45,445)	(616,776)
Ndryshimi në detyrime të tjera	40,41	(43,270)	307,130
Interesi i arkëtuar		18,978,952	15,878,464
Interesi i paguar		(4,751,808)	(4,546,243)
Tatim fitimi i paguar		(626,113)	(658,525)
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		4,802,454	6,308,646
Aktivitetet investuese			
Blerje sipas marrëveshjes Repo	20,21,22	(215,188,353)	1,211,376
Blerje e letrave me vlerë	20,21,22	(106,203,716)	(61,199,838)
Shitje e letrave me vlerë	20,21,22	1,232,254	2,081,227
Letra me vlerë të maturuara	20,21,22	297,877,870	21,858,022
Investime në filiale	24	300	(6,243)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	29	(997,650)	(1,103,099)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	30	(372,868)	(212,214)
Flukset monetare neto nga aktivitetet investuese		(23,652,163)	(37,370,769)
Aktivitetet financuese			
Flukse hyrëse nga detyrimi i perfaqësuar nga L.Vlerë	37	3,491,985	3,542,034
Flukse hyrëse nga borxhi i varur	38	2,072,772	1,929,096
Flukse dalëse të borxhit të varur	38	(1,075,637)	(1,071,346)
Pagesa të financimeve të reja	36	1,622,144	(37,306)
Pagesa te dividentëve		(171,281)	-
Emetim i kapitalit		3,428,803	1,419,181
Flukset monetare neto nga aktivitetet financuese		9,368,786	5,781,659
Rritje në aktive monetare dhe ekuivalentë me to		(9,480,923)	(23,678,563)
Aktive monetare dhe ekuivalentë me to më 1 janar	16	26,523,946	50,202,509
Aktive monetare dhe ekuivalentë me to, më 31 dhjetor	16	17,043,023	26,523,946

¹Shënimet 1 deri 49 në faqet 6 deri 73 janë pjesë integrale e këtyre pasqyra financiare të konsoliduara

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

1 Të përgjithshme

Banka Credins SHA (këtej e tutje “Mëma”) është një institucion financiar Shqiptar i themeluar më 31 janar 2003 në bazë të ligjit tregtar në Shqipëri dhe është licencuar nga Banka e Shqipërisë më datë 31 mars 2003 për të ushtruar aktivitetin e saj si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me Ligjin nr. 8365 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, miratuar në Korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i Ligjit nr. 8269, miratuar në dhjetor 1997, “Mbi Bankën e Shqipërisë” (këtej e tutje referuar si “Banka Qendrore”). Këto pasqyra financiare të konsoliduara përfshijnë Bankën dhe filialet e saj (kolektivisht, Grupi).

Më 31 dhjetor 2025 Grupi kishte 1,313 punonjës (31 dhjetor 2024: 1,270 punonjës). Adresa e zyrave qendrore të Grupit dhe vendit kryesor të ushtrimit të aktivitetit është: Rruga “Vaso Pasha,” Nr. 8, Tiranë, Shqipëri.

Filialet

Në 31 dhjetor 2025 Banka zoteron 83.22% të aksioneve të "Banka Credins Kosovë" sh.a.". Banka Credins Kosovë operon në territorin e Kosovës që në tetor të vitit 2020. (2024: 60.20%). Gjatë vitit 2025, Banka investoi një shtesë prej 6.13 milionë eurosh në filial, duke përfshirë një rritje kapitali prej 3.13 milionë eurosh nëpërmjet blerjes së aksioneve nga aksionarët ekzistues, e cila u miratua nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në mars 2026.

Banka zotëron 76% të aksioneve të "CREDINS INVEST sh.a. - Shoqëria administruese e Fondeve të Pensioneve dhe Sipermarreve të Investimeve Kolektive (nga “Shoqeria Administruese e Fondit të Pensionit “SiCRED” sh.a.”) nga "SiCRED sh.a." (2024: 76%)

Banka zotëron 52.56% të aksioneve të "Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG" sh.a. Në vitin 2024 Banka mbante 52.56% të aksioneve të ALREG.

Në 31 dhjetor 2025 Banka zotëron 45.59% të aksioneve të "Bursa Shqiptare e Titujve ALSE" sh.a." (2024: 45.59%).

Në vitin 2025 Banka Credins zotëron 18 aksione pranë SWIFT SCR në një vlerë prej 108,730 euro. (2024 18 aksione)

2 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Detaje mbi politikat kontabël të Grupit, dhe ndryshimet e tyre, paraqiten në shënimin 8.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë, pasi Drejtimi është konfident që Banka ka burime të mjaftueshme për të vazhduar aktivitetin për të ardhmen e parashikueshme. Për kryerjen e këtij vlerësimi, Drejtimi ka marrë në konsideratë informacione të cilat përfshijnë parashikimet e fitimit, kërkesat për kapital rregullator dhe nevojat për fonde. Vlerësimi merr gjithashtu në konsideratë skenarët e një rënie ekonomike dhe ndikimin e tyre të mundshëm në përfitueshmërinë, kapitalin dhe likuiditetin e Grupit.

3 Baza e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç instrumenteve financiare derivative, aktiveve dhe detyrime financiare të matura me VDPFH dhe instrumente borxhi dhe kapitali të matura me VDP të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe pronave të riposeduara të matura me më të voglën ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Grupit. Përveç rasteve kur shprehet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është në mijë LEK, i rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

5 Paraqitja e pasqyrave financiare të konsoliduara

Grupi e paraqet pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar kryesisht sipas rendit të likuiditetit. Një analizë lidhur me arkëtimin ose shlyerjen brenda 12 muajve pas datës së raportimit (korrente), dhe më vonë se 12 muaj nga data e raportimit (jo korrente) paraqitet në shënimin 44.

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Grupi gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Te ardhurat dhe shpenzimet nuk paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet, dhe siç shpjegohet në mënyrë specifike në politikat kontabël të Grupit. Janë bërë disa riklasifikime nga viti kaluar për tu prezantuar më mirë me klasifikimin aktual.

Pasqyrat financiare të konsoliduara përfshijnë pasqyrat financiare të Mëmës dhe filialeve të saj më 31 dhjetor 2025. Kontrolli arrihet kur Mëma ekspozohet, ose i lind e drejta të përfitojë nga përfshirja e tij në filial, të ardhura të cilat mund të jenë të variueshme, si dhe nëse ka aftësinë të afektojë këto rezultate nëpërmjet ndikimit të tij mbi filialin.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

6 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare të Grupit kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumën e raportuar të të ardhurave, blerjeve, aktiveve dhe detyrimeve, si dhe shënimet shpjeguese shoqëruese, si dhe shënimet shpjeguese të detyrimeve kontigjente (nëse ka). Pasiguria rreth këtyre supozimeve dhe vlerësimeve mund të cojë në rezultate që kërkojnë një rregullim material të vlerës kontabël të aktiveve ose detyrimeve të prekura në periudhat e ardhshme. Në procesin e aplikimit të politikave të kontabilitetit të Grupit, Drejtimi ka bërë gjykimet dhe supozimet e mëposhtme në lidhje me të ardhmen dhe burimet e tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e raportimit, që kanë një rrezik të rëndësishëm për të kërkuar një rregullim material të vlerës së aktiveve dhe detyrimet brenda vitit tjetër kontabël.Rrethanat ekzistuese dhe supozimet për zhvillimet e ardhshme mund të ndryshojnë për shkak të rrethanave përtej kontrollit të Grupit dhe pasqyrohen në supozimet nëse dhe kur ato ndodhin. Artikujt me efektin më të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare të konsoliduara me gjykim të konsiderueshëm të menaxhimit dhe / ose vlerësime, janë mbledhur më poshtë në lidhje me gjykimet / vlerësimet e përfshira.

6.1 Humbjet nga zhvleresimi për aktivet financiare

Grupi konsideron ekspozimet si joperformues/të zhvlerësuar kur ka ndodhur një ose më shumë nga rrethanat e mëposhtme të cilat kane një ndikim përkeqësues në mjetet monetare të pritshme:

- Ditët në vonesë për një llogari më shumë se 90 ditë,
- Kredia është e kategorizuar nga një vlerësim në rënie (kredi që kanë një vlerësim të barabartë me 7 ose një vlerësim ekonomik të barabartë me 10)
- Kredia është subjekt i një ekspozimi baze për zhvlerësim individual në nivel GCC

Përkufizimi i vonesës së përmendur më sipër (zhvlerësimit) përdoret në nivel llogarie (kredie).

Kreditë të cilat nuk janë të testuara individualisht për zhvlerësim vlerësohen kolektivisht. Në zhvlerësimin kolektiv përfshihen gjithashtu edhe kredite që kanë një ekspozim me pak se 10,000 mijë leke në nivel GCC.

Zhvlerësimi kolektiv llogaritet në lidhje me stadin 2 dhe 1.

Stadi 2: Për llogaritë e testuara kolektivisht fondi i zhvlerësimit është e njëjta me Humbjet e Pritshme (ECL) të gjithë jetes (kohezgjatjes) së kredisë. ECL e gjithë jetes përcaktohet si humbja e të gjitha eventeve të mundshme përgjatë gjithë jetes së një instrumenti financiar (p.sh, rreziku i daljes në vonesë që ndodh në një instrument financiar gjatë jetës së pritshme të tij).

Stadi 1: Për llogaritë e testuara në grup (kolektiv) në Stadin 1, llogaritët ECL 12 mujore. 12-muaj ECLs është humbja që pritet të materializohet në 12 muajt në vijim – kështu probabiliteti 12 mujor shumezohet me Ekspozimin në Risk (EAD) aktuale dhe Humbja e Ndodhur (LGD) koresponduese. Në rastet kur maturiteti i mbetur është me pak se 12 muaj, në vend të Probabilitetit të Dështimit (PD) 12 mujore përdoret PD e gjithë jetes.

Matja e humbjeve nga zhvlerësimi sipas SNRF 9 në të gjitha kategoritë e aktiveve financiare të përfshira kërkon gjykimin, në veçanti, vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve monetare të ardhshme dhe vlerave të kolateralit gjatë përcaktimit të humbjeve nga zhvlerësimi dhe vlerësimit të një rritje të rëndësishme të rrezikut të kredisë. Këto vlerësime janë të nxitura nga një numër faktorësh, ndryshime në të cilat mund të rezultojë në nivele të ndryshme të zhvlerësimit.

Llogaritjet ECL të Grupit janë rezultatet e modeleve komplekse me një numër supozimesh themelore të zgjedhura në inputet e ndryshueshme dhe ndërvlerësive të tyre. Elementet e modeleve ECL që konsiderohen gjykime dhe vlerësime kontabël përfshijnë:

- Modeli i brendshëm i klasifikimit të kredive të Grupit, i cili cakton PD-të në nivelet individuale
- Kriteret e Grupit për të vlerësuar nëse ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë dhe kështu që lejimet për aktivet financiare duhet të maten në bazë të Humbjeve të Pritshme Përgjatë Jetës (LTECL) dhe vlerësimi cilësor
- Segmentimi i aktiveve financiare kur ECL-ja e tyre vlerësohet në baza kolektive
- Zhvillimi i modeleve ECL, duke përfshirë formulat e ndryshme dhe zgjedhjen e inputeve.
- Përcaktimi i lidhjeve midis skenarëve makroekonomikë dhe inputeve ekonomike, siç janë nivelet e papunësisë dhe vlerat e kolateralit, si dhe efektet në PD, EAD dhe LGD
- Përzgjedhja e skenarëve makroekonomikë të parashikuar nga pikëpamjet dhe koeficientet e tyre të probabilitetit, për të nxjerrë inputet ekonomike në modelet ECL

Ka qenë politika e Grupit për të rishikuar rregullisht modelet e saj në kontekstin e përvojës aktuale të humbjes dhe përshtatur kur është e nevojshme.

6.2 Vlera e drejtë e instrumentave financiarë

Vlera e drejtë e instrumentave financiarë është çmimi që do mund të merej për shitjen e një aktivi apo do paguhej për transferimin e një detyrimi në një transaksion normal në një treg të rregulluar (ose më i leverdisshëm) në datën e matjes në kushtet e tregut (p.sh., një çmim daljeje) pavarësisht nëse ai çmim është lehtësisht i observueshëm ose i vlerësuar nëpërmjet teknikave të vlerësimit. Kur vlera e drejtë e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që njihet në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të nxirret nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një varietet të teknikave të vlerësimit që përfshijnë përdorimin e modeleve të vlerësimit. Inputet në këto modele meren nga tregjet e observueshme kur është e mundur, por kur kjo nuk është e mundur, kërkojnë vlerësime për përcaktimin e vlerave të drejta. Gjykimet dhe vlerësimet përfshijnë marrjen në konsideratë të likuiditetit dhe modeleve të inputeve që lidhen me zëra të tillë si risku i kredisë (të vetes dhe të pales tjetër), financimi i rregullimeve të vlerës, korelacioni dhe ndryshueshmëria. Për më shumë detaje mbi përcaktimin e vlerës së drejtë referojuni shënimin 8.4.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

6 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

6.3 Metoda e Normës Efektive të Interesit

Metoda e Normës së Interesit Efektiv të Grupit, sikurse shpjegohet në shënimin 8.7.1, njeh të ardhurën nga interesi duke përdorur një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një norme konstante kthimi përgjatë jetës së pritshme të kredive dhe depozitave dhe njeh efektin e një norme potenciale interesi të ndryshme që i ngarkohet në stade të ndryshme si dhe karakteristikave të tjera të ciklit të jetës së produktit (duke përfshirë parapagimet dhe shpenzimet dhe penalitetet). Ky vlerësim, nga natyra, kërkon një element gjykimi në lidhje me sjelljen e pritshme dhe ciklin e jetës së instrumentit.

6.4 Tatim fitimi i shtyrë aktiv

Tatim fitimi i shtyrë aktiv njihet në lidhje me humbjet fiskale në masën që është e mundshme që të ketë fitime të tatueshme në të ardhmen që kundrejt të cilit mund të përdoren humbjet fiskale. Edhe pse në Shqipëri humbjet fiskale mund të përdoren për 3 vjet nga data e ndodhjes, kërkohet gjykim për të përcaktuar vlerën e tatim fitimit të shtyrë aktiv që mund të njihet, bazuar mbi kohën e mundshme dhe nivelin e fitimeve të tatueshme të ardhshme, sëbashku me strategjitë e ardhshme të planifikimit-fiskal (shih shënimin 15 dhe shënimin 33).

6.5 Përcaktimi i kushteve të qirasë për kontratat e qirasë me opsionin e rinovimit apo përfundimit (Grupi si qiramarrës)

Grupi përcakton kushtet e qirasë si kushtet e pa-anullueshme të qirasë, sëbashku me periudhat e mbuluara nga opsioni për shtyrjen e qirasë nëse është në mënyrë të arsyeshme e sigurtë që do të ushtrohet, ose ndonjë periudhë të mbuluar nga opsioni për ta përfunduar qiranë, nëse është në mënyrë të arsyeshme e sigurtë që nuk do ushtrohet.

Grupi ka disa kontrata qiraje që përfshijnë opsionin e përfundimit apo rinovimit. Grupi aplikon gjykimin në vlerësimin nëse është e sigurtë apo jo që do të ushtrojë opsionin për ta rinovuar apo përfunduar qiranë. Dhënë kjo, ajo konsideron të gjithë faktorët që ndikojnë për të krijuar një nxitje ekonomike për të, për të ushtruar ose rinovimin ose përfundimin. Pas datës së fillimit të kontratës, Grupi rishikon kushtet e qerasë në rast ndryshimi të rrethanave apo ngjarjeve madhore, të cilat mund të jenë nën kontrollin e Grupit dhe ndikojnë në ushtrimin e rinovimit apo përfundimit të kontratës (p.sh, konstruktive ose ndryshime të rëndësishme të pronës me qera) ose cdo event tjetër që ndikon në përdorimin e pronave nga Grupi.

6.6 Vlerësimi i normës rritëse të borxhit

Grupi nuk mund të përcaktojë lehtësisht normën e brëndshme të nënkuptuar të qirasë, dhe për rrjedhojë, ajo përdor normën rritëse të borxhit (NRB) për të matur detyrimet e qirasë. NRB është norma e interesit që Grupi do të duhet të paguante nëse do merte një borxh me kushte të ngjashme, dhe me siguri të ngjashme, fondet e nevojshme për të siguruar një aktiv me vlerë të ngjashme me aktivin e drejta-në-përdorim në një mjedis ekonomik të ngjashëm. NRB në këtë mënyrë pasqyron atë çfarë Grupi “do të paguante”, gjë e cila kërkon vlerësim kur nuk ka të dhëna të observueshme (të tilla si filialet të cilat nuk hyjnë në transaksione financiare) ose kur nevojiten të rregullohen për të reflektuar kushtet dhe termat e qirasë (për shembull, kur qiratë nuk janë në monedhën funksionale të filialit). Grupi vlerëson NRB duke përdorur inpute të observueshme (të tilla si normat e interesit të tregut) kur janë të disponueshme dhe kërkohet të bëhen disa rregullime specifike për entitetin (të tilla për të reflektuar termat dhe kushtet e qirasë).

6.7 Zhvlerësimi i investimeve në letra me vlerë

Grupi shqyrton letrat e saj të borxhit të klasifikuara si investime të matura me VDP të ardhurave të tjera gjithëpërfshirësenë çdo datë të pasqyrave financiare për të vlerësuar nëse ato janë zhvlerësuar. Kjo kërkon gjykim të ngjashëm si ai i përdorur për vlerësimin individual të huave dhe paradhënieve.Trajtimi i instrumentave financiare (obligacionet qeveritare dhe ekspozimet me bankat) është ndryshe nga trajtimi i pergjithshem ne lidhje me percaktimin e parametrave. Nderkohe qe LGD është 45% (sipas rregullave CRR), Probabiliteti i voneses (PD) lidhet me vlerësimin e shtetit specifik sipas S&P. Meqënëse nuk ka pasur përkeqësim të rëndësishëm në rrezikun e kredisë për vlerën e portofolit të letrave me vlerë është llogaritur vetem PD 12 mujore kumulative.

7 Ndryshimet ne politikat kontabël dhe shpjegimet

7.1 Standarde të reja dhe të rishikuara dhe interpretime

Grupi aplikoi për herë të parë disa standarde dhe amendime, të cilat janë efektive për periudhën që fillon me ose pas 1 janar 2025. Standardet dhe ndryshimet që hynë në fuqi nga 1 janari 2025 dhe që mund të jenë të zbatueshme për Grupin

- Mungesa e këmbyeshmërisë (Ndryshime në IAS 21) (në fuqi nga 1 janari 2025)

Grupi nuk ka përshtatur ndonjë standard tjetër, interpretim apo amendim që është emetuar, por nuk është ende efektiv. Këto ndryshime nuk kane patur ndikim në pasqyrat financiare te bankes dhe për këtë arsye shenimet shpjeguese nuk janë përgatitur.

7.2 Standarde dhe interpretime të publikuara por jo në fuqi

Disa standard te reja jane efektive per periudhat qe fillojne pas dates 1 janar 2025 dhe per te cilat aplikimi i hershem eshte i lejuar; Ne pergatitjen e ketyre pasqyrave financiare Grupi nuk ka aplikuar paraprakisht keto standard te reja apo te dnryshuara sepse nuk kane ndonje ndikim te rendesishem ne keto pasqyra. Keto standard te reja dhe te ndryshuara jane si vijon:

- Ndryshimet në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshime në IFRS 9 dhe IFRS 7) (në fuqi nga 1 janari 2026)
- IFRS 18 “Paraqitja dhe Shpalosja në Pasqyrat Financiare” (në fuqi nga 1 janari 2027)
- IFRS 19 “Shoqëritë bijë pa përgjegjësi publike: Shpalosjet” (në fuqi nga 1 janari 2027)

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

8 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara në vijim janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme nga grupi në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

8.1 Bazat për konsolidimin

i) Kombinimi i bizneseve

Kombinimi i bizneseve kontabilizohet duke përdorur metodën e blerjes kur grupi i aktiviteteve dhe aseteve të blera plotëson kushtet e klasifikimit si biznes dhe kontrolli i transferohet Grupit.

Në përcaktimin nëse një grup i caktuar aktiviteteve dhe aktiveve është një biznes, Grupi vlerëson nëse grupi i aktiveve dhe aktiviteteve të blera përfshin, të paktën, një proces hyrës dhe thelbësor dhe nëse grupi i blerë ka aftësinë për të prodhuar rezultate. Grupi ka një mundësi për të aplikuar një "test përqendrimi" që lejon një vlerësim të thjeshtuar nëse një grup aktiviteteve dhe aktiveve të blera nuk është një biznes. Testi opsional i përqendrimit plotësohet nëse në thelb e gjithë vlera e drejtë e aktiveve bruto të blera është e përqendruar në një aktiv të vetëm të identifikueshëm ose grup aktiveve të ngjashme të identifikueshme.

Shuma e transferuar në blerje matet përgjithësisht me vlerën e drejtë, siç janë aktivet neto të identifikueshme të blera. Çdo emër i mirë që lind testohet çdo vit për zhvlerësim. Çdo fitim nga blerja njihet menjëherë në fitim ose humbje. Kostot e transaksionit raportohen në shpenzime në momentin e ndodhjes, përveç nëse lidhen me emetimin e letrave me vlerë të borxhit ose kapitalit.

Shuma e transferuar nuk përfshin shumat që lidhen me zgjidhjen e marrëdhënieve para-ekzistuese. Shuma të tilla përgjithësisht njihen në fitim ose humbje.

Çdo shumë e kushtëzuar matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes. Nëse një detyrim për të paguar shumën e kushtëzuar që plotëson përkufizimin e një instrumenti financiar klasifikohet si kapital, atëherë ai nuk rimatet dhe shlyerja kontabilizohet brenda zërave të kapitalit. Shumat e tjera të kushtëzuara rimaten me vlerën e drejtë në çdo datë raportimi dhe ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë të shumës së kushtëzuar njihen në fitim ose humbje.

ii) Filialet

"Filiale" janë subjekte të kontrolluara nga Grupi. Grupi 'kontrollon' një njësi ekonomike nëse është e ekspozuar ose ka të drejta ndaj kthimeve të ndryshueshme nga përfshirja e tij me njësinë ekonomike dhe ka aftësinë të ndikojë në këto kthime nëpërmjet fuqisë së tij mbi njësinë ekonomike. Grupi rivlerëson nëse ka kontroll, në rast se ka ndryshime në një ose më shumë elementë të kontrollit. Kjo përfshin rrethanat në të cilat të drejtat mbrojtëse të mbajtura (p.sh. ato që rezultojnë nga një marrëdhënie huadhënieje) bëhen thelbësore dhe çojnë në fuqinë e Grupit mbi një investim. Pasqyrat financiare të filialeve përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara nga data në të cilën kontrolli fillon deri në datën në të cilën kontrolli përfundon.

iii) Interesat jo-kontrolluese

Interesat jo-kontrolluese maten fillimisht me pjesën proporcionale të aktiveve neto të identifikueshme të njësisë së blerë në datën e blerjes. Ndryshimet në interesin e Grupit në një filial, që nuk rezultojnë në humbje të kontrollit, kontabilizohen si transaksione të kapitalit neto.

iv) Humbja e kontrollit

Kur Grupi humbet kontrollin mbi një filial, ai çregjistron aktivet dhe detyrimet e filialit, dhe çdo interes jo-kontrollues të lidhur me të dhe përbërës të tjerë të kapitalit neto. Çdo fitim ose humbje që rezulton njihet në fitim ose humbje. Çdo interes i mbajtur në këtë filial matet me vlerën e drejtë kur humbet kontrolli.

v) Transaksionet e eliminuara në konsolidim

Gjendjet e llogarive dhe transaksionet e realizuara Brenda grupit, si dhe çdo e ardhur dhe shpenzim i perealizuar (përveç fitimeve ose humbjeve nga transaksionet në valutë të huaj) që rrjedhin nga transaksionet brenda grupit, eliminohen. Humbjet e perealizuara eliminohen në të njëjtën mënyrë si fitimet e perealizuara, por vetëm në masën që nuk ka tregues për zhvlerësim.

8.2 Monedhat e huaja

i) Transaksionet në monedhë të huaj

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, transaksionet në valuta të ndryshme nga monedha funksionale e Grupit njihen me kursin e këmbimit të çastit në datën e transaksioneve.

Aktivët dhe detyrimet monetare të shprehura në valuta të huaja përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv, zhvlerësimin dhe pagesat gjatë vitit, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivët dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj, që maten me vlerën e drejtë, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jomonetarë në monedhë të huaj, që maten në bazë të kostos historike konvertohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga konvertimi njihen përgjithësisht në fitim ose humbje.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

8 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

8.2 Monedhat e huaja (vazhdim)

Kurset e këmbimit të aplikueshme (Lekë ndaj një njësie të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
USD	82.46	94.26
Euro	96.77	98.15
GBP	110.76	118.16
CHF	103.97	104.27
CAD	60.20	65.56
XAU	11,425.17	7,915.28

ii) Veprimtaritë e huaja

Aktivët dhe detyrimet e veprimtarive të huaja, duke përfshirë emrin e mirë dhe rregullimet e vlerës së drejtë që rrjedhin nga blerja, konvertohen në lekë me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Të ardhurat dhe shpenzimet e veprimtarive me jashtë përkthehen në lekë me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Diferencat në valutë të huaj njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe akumulohen në rezervën e konvertimit, me përjashtim të shumës që shpërndahet për interesat jo-kontrolluese.

Kur një operacion i huaj shitet tërësisht ose pjesërisht dhe grupi humbet kontrollin, shuma kumulative në rezervën e konvertimit që lidhet me atë operacion të huaj riklasifikohet në fitim ose humbje si pjesë e fitimit ose humbjes nga shitja. Nëse Grupi shet vetëm një pjesë të interesit të tij në një filial që përfshin një operacion të huaj, duke mbajtur kontrollin, atëherë pjesa përkatëse e shumës kumulative i riatribuohet interesave jo-kontrolluese.

8.3 Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja e mëpasshme

8.3.1 Data e njohjes

Të gjithë aktivët dhe detyrimet financiare, me përjashtim të kredive dhe paradhënieve dhënë klientëve janë njohur fillimisht në datën e transaksionit, datë kur Grupi bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit. Kreditë dhe paradhëniet dhënë klientëve njihen kur fondet transferohen tek llogaritë e klientëve. Grupi njih detyrimet ndaj klientëve kur fondet janë transferuar tek Grupi.

8.3.2 Matja fillestare e instrumentave financiarë

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga kushtet e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit për menaxhimin e instrumenteve, siç përshkruhet në shënimin 8.5.1.1. Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e tyre të drejtë (siç përcaktohet në Shënimin 8.4), përveç rasteve kur aktivët financiare dhe detyrimet financiare regjistrohen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH), kostot e transaksionit shtohen ose zbriten nga kjo shumë. Të arkëtueshmet tregtare maten me çmimin e transaksionit. Kur vlera e drejtë e instrumenteve financiare në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Grupi llogarit fitimin ose humbjen e ditës së parë, siç përshkruhet më poshtë:

Fitimi ose humbja në ditën e parë

Kur çmimi i transaksionit të instrumentit ndryshon nga vlera e drejtë e origjinës dhe vlera e drejtë bazohet në një teknikë vlerësimi duke përdorur vetëm inputet e vëzhgueshme në transaksionet e tregut, Grupi njih dallimin midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë në të ardhurat neto të tregtimit. Në rastet kur vlera e drejtë bazohet në modele për të cilat disa nga inputet nuk janë të vëzhgueshme, diferenca midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë zhvlerësohet dhe njihet në fitim ose humbje vetëm kur inputet bëhen të vëzhgueshme ose kur instrumenti çregjistrohet.

Grupi i klasifikon të gjitha aktivët e saj financiare bazuar në modelin e biznesit për menaxhimin e aktiveve dhe kushteve kontraktuale të aktivit, të matura me:

- Kosto të amortizuar, siç shpjegohet në Shënimin 8.5.1

- Vlerën e Drejtë nëpërmjet të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse ("VDATGj"), siç shpjegohet në Shënimet 8.5.4 dhe 8.5.5

- Vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH), siç shpjegohet në Shënimin 8.5.6.

Grupi klasifikon dhe i mat derivatet e portofolin e saj të tregtimit me VDPFH siç shpjegohet në Shënimet 8.5.2 dhe 8.5.3. Grupi mund të caktojë instrumenta financiarë me VDPFH, nëse kështu eliminon ose ul ndjeshëm mospërputhjet e matjes ose të njohjes, siç shpjegohet në Shënimin 8.5.6.

Detyrimet financiare, përveç angazhimeve të huasë dhe garancive financiare, maten me koston e amortizuar ose me VDPFH kur ato mbahen për tregtim dhe instrumenta derivative ose zbatohet përcaktimi i vlerës së drejtë, siç shpjegohet në Shënimin 8.5.6.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

8 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

8.3 Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja e mëpasshme (vazhdim)

8.3.4 Çregjistrimi i aktiveve financiare

8.3.4.1 Çregjistrimi për shkak të modifikimit thelbësor të termave dhe kushteve

Grupi çregjistron një aktiv financiar, të tillë si një hua për një klient, kur termat dhe kushtet janë rinegocuar në atë masë që, në thelb, bëhet një hua e re, me diferencën e njohur si fitim ose humbje nga çregjistrimi, deri në masën e një humbje të paregjistruar nga zhvlerësimi. Huatë e reja të njohura klasifikohen si Faza 1 për qëllimet e matjes ECL, përveç rasteve kur kredia e re konsiderohet të jetë POCl. Kur vlerëson nëse duhet ta njohë ose jo një kredi për një klient, ndër të tjera, Grupi merr në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimi në monedhën e huasë;
- Prezantimi i nje karakteristikë kapitali;
- Ndryshimi në palën tjetër;
- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti nuk do të përmbushë më kriterin e SPPI.

Nëse modifikimi nuk rezulton në flukse të mjeteve monetare që janë thelbësisht të ndryshme, modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin. Bazuar në ndryshimet në flukset e mjeteve monetare të skontuara me normën efektive të interesit në origjinë, Grupi regjistron një fitim ose humbje modifikimi, në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar. Për detyrimet financiare, Grupi merr në konsideratë një modifikim të bazuar në thelb në faktorët cilësorë, dhe nëse kjo rezulton me një diferencë prej, ose më shumë se dhjetë për qind midis vlerës aktuale të përshtatur e të skontuar dhe shumës fillestare të detyrimit financiar. Për aktivët financiare ky vlerësim bazohet në faktorët cilësorë.

8.3.4.2 Çregjistrimi përveçse për ndryshime thelbësore

8.3.4.2.1 Aktivët financiare

Një aktiv financiar (ose, kur është e mundur, një pjesë e një aktivi financiar ose një pjesë të një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) çregjistrohet kur të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar kanë skaduar. Grupi gjithashtu çregjistron aktivin financiar nëse ka transferuar aktivin financiar dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim. Grupi ka transferuar aktivin financiar nëse dhe vetëm nëse:

- Grupi ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar; Ose
- Ajo ruan të drejtat e flukseve të mjeteve monetare, por ka marrë përsipër detyrimin për të paguar flukset monetare të marra në tërësi pa vonesë materiale për një palë të tretë sipas një marrëveshjeje të "kalimit".

Marrëveshjet e kalimit janë transaksione ku Grupi ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi origjinal"), por merr një detyrim kontraktual për t'ia paguar këto flukse monetare një ose më shumë subjekteve ('përfituesit eventualë '), kur plotësohen të trija kushtet e mëposhtme:

- Grupi nuk ka asnjë detyrim të paguajë shumat për përfituesit eventualë, përveç nëse ka arkëtuar shuma ekuivalente nga aktivi origjinal, duke përjashtuar paradhëniet afatshkurtra me të drejtën e rimbursimit të plotë të shumës së huasë plus interesin e përlogaritur me normat e tregut.
- Grupi nuk mund ta shesë ose ta lërë peng asetin fillestar përveçse si siguri për përfituesit eventual.
- Grupi duhet të dorëzojë çdo fluks parash që mbledh në emër të përfituesve eventual pa vonesë materiale. Për më tepër, Grupi nuk ka të drejtë të riinvestojë flukse monetare të tilla, me përjashtim të investimeve në mjete monetare ose ekuivalente të mjeteve monetare, duke përfshirë interesin e fituar, gjatë periudhës ndërmjet datës së mbledhjes dhe datës së dërgesës së kërkuar te marrësit eventual.

Një transferim kualifikohet për çregjistrim vetëm nëse:

- Grupi ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit; Ose
- Grupi nuk ka transferuar as mbajtur thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, por ka transferuar kontrollin e aktivit.

Grupi e merr në konsideratë kontrollin që do të transferohet nëse dhe vetëm nëse transferuesi ka aftësinë praktike për ta shitur asetin në tërësinë e tij te një palë e tretë e palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë atë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa vendosur kufizime shtesë për transferimin. Kur Grupi nuk ka transferuar dhe as ka mbajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet e përfitimet, si dhe ka mbajtur kontrollin e aktivit, ky i fundit vazhdon të njihet vetëm në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Grupit. Në këtë rast, Grupi njih edhe një pasiv shoqërues. Aktivët e transferuara dhe pasivi shoqërues maten në një bazë që pasqyron të drejtat dhe detyrimet e mbajtura prej Grupit. Përfshirja e vazhdueshme që merr formën e një garancie mbi aktivin e transferuar matet me vlerën më të ulët të vlerës kontabël fillestare të aktivit dhe shumën maksimale të vlerësimit që mund t'i kërkohej Grupit të paguajë. Nëse përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni të shkruar ose të blerë (ose të dyja) në aktivin e transferuar, atëherë, ajo matet me vlerën që Grupit do t'i kërkohej të paguajë pas riblerjes. Në rastin e një opsioni të vënë me shkrim mbi një aktiv që matet me vlerën e drejtë, shkalla e përfshirjes së vazhdueshme të subjektit kufizohet me vlerën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit të transferuar dhe çmimit të ushtrimit të opsionit.

8.3.4.2.2 Detyrimet financiare

Detyrimi financiar çregjistrohet kur detyrimi për përmbushjen e detyrimit financiar hiqet, anulohet ose skadon. Kur i njëjti huadhënës e zëvendëson një pasiv financiar ekzistues me një tjetër, në kushte thelbësisht të ndryshme ose në rast se kushtet e një pasivi ekzistues modifikohen në mënyrë të ndjeshme, një zëvendësim ose modifikim i tillë trajtohet si çregjistrimi i pasivit fillestar dhe njohja e pasivit të ri. Diferenca midis vlerës kontabël të pasivit financiar fillestar dhe vlerës së paguar njihet në fitim ose humbje.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

8 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

8.4 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Për të treguar se si janë nxjerrë vlerat e drejta, instrumentet financiare klasifikohen në bazë të një hierarkie të teknikave të vlerësimit, siç përmbledhet më poshtë.

- Instrumentet financiare të nivelit 1 - Ato ku inputet e përdorura në vlerësim janë çmime të kuotuar të parregulluara nga tregjet aktive për aktivet ose pasivet identike që Grupi mund të përdorë në datën e matjes. Grupi i konsideron tregjet si aktive vetëm nëse ka aktivtete të mjaftueshme tregtare në lidhje me vëllimin dhe likuiditetin e aktiveve ose pasiveve identike dhe kur ka kuotime çmimesh të detyrueshme dhe të ushtrueshme, të cilat janë të disponueshme në datën e bilancit.
- Instrumentet financiare të nivelit 2 - Ato, ku inputet që përdoren për vlerësim dhe janë të rëndësishme, rrjedhin nga të dhënat e tregut të vëzhguara në mënyrë direkte ose jo, të cilat janë të disponueshme gjatë gjithë periudhës së jetës së instrumentit. Këto inpute përfshijnë çmimet e kuotuar për aktivet ose pasivet e ngjashme në tregjet aktive, çmimet e kuotuar për instrumente identikë në tregjet joaktive dhe inputet e vëzhgueshme, përveç çmimeve të kuotuar, si normat e interesit dhe kurbat e normave të interesit, luhatjet e nënkuptuara dhe marzhet e kredisë. Përveç kësaj, mund të kërkohen rregullime për gjendjen ose vendndodhjen e aktivit ose shkallën me të cilën ai lidhet me zërat që janë të krahasueshëm me instrumentin me vlerë. Gjithsesi, nëse këto rregullime bazohen në inpute të pakontrollueshme të cilat janë të rëndësishme për të gjithë matjen, Grupi do t'i klasifikojë instrumentet si Niveli 3.
- Instrumentet financiare të nivelit 3 – Janë ato që përfshijnë një ose më shumë të dhëna të pavëzhgueshme që janë të rëndësishme për matjen në tërësi.

Grupi rishikon periodikisht teknikat e saj të vlerësimit duke përfshirë metodologjitë e miratuara dhe kalibrimet e modelit. Megjithatë, modelet bazë nuk mund të kapin plotësisht të gjithë faktorët që lidhen me vlerësimin e instrumenteve financiare të Grupit si rreziku i kredisë (CVA), kredia e vet (DVA) dhe / ose kostot e financimit (AUV). Për pasojë, Grupi përdor teknika të ndryshme për të vlerësuar rrezikun e kredisë që lidhet me instrumentet e tij financiare të matura me vlerën e drejtë, të cilat përfshijnë një përjasje me bazë portofoli, që vlerëson ekspozimin neto të pritshëm për një palë përgjatë gjithë jetës së aktiveve individuale, me qëllim për të pasqyruar rrezikun e kredisë e palëve individuale për instrumentet financiare jo të lëna kolateral. Grupi vlerëson vlerën e kredisë së saj nga të dhënat e vëzhgueshme të tregut, të tilla si çmimet dytësore për borxhin e saj të tregtuar, marzhin e kredisë në kontratat e shkëmbimit për mospagimin e kredisë dhe borxhet e tregtuara në vetvete. Në Shënimin 47.7 (Matja e vlerës së drejtë) jepen më tepër detaje lidhur me këtë praktikë. Grupi vlerëson nivelimin në secilën periudhë raportuese bazuar në intrumente dhe i riklasifikon instrumentet kur është e nevojshme, bazuar në faktet e disponueshme në fund të periudhës raportuese.

8.5 Aktivet dhe detyrimet financiare

8.5.1 Detyrimet nga bankat, Huatë dhe paradhëniet për klientët, investimet financiare me kosto të amortizuar

Grupi mat vetëm *Detyrimet nga bankat, Huatë dhe paradhëniet për klientët* dhe investimet e tjera financiare me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- Aktivit financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim mbajtjen e mjeteve financiare për të mbledhur flukse kontraktuale të mjeteve monetare;
- Kushtet kontraktuale të aktivit financiar japin datat e përcaktuara për flukset e mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesat e principalit dhe interesit (SPPI) në outstanding e shumës së principalit.

Detajet e këtyre kushteve përshkruhen më poshtë.

Grupi përcakton modelin e saj të biznesit në nivelin që pasqyron më mirë mënyrën e menaxhimit të grupeve të aseteve financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit.

- Rreziqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe aseteve financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi) dhe në veçanti në mënyrën se si menaxhohen ato rreziqe;
- Si kompensohen menaxherët e biznesit (për shembull, nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të administruara ose në flukset kontraktuale të arkëtuara).

Shpeshtësia e pritur, vlera dhe koha e shitjeve janë gjithashtu aspekte të rëndësishme të vlerësimit të Grupit.

Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenarë të pritshëm, pa marrë në konsideratë skenarët “pesimistë” ose skenarët e "rasteve të stresit". Nëse pas njohjes fillestare, flukset e mjeteve monetare realizohen në një mënyrë të ndryshme nga pritshmëritë fillestare të Grupit, kjo e fundit nuk e ndryshon klasifikimin e aktiveve të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por e përfshin këtë informacion gjatë vlerësimit të aktiveve financiare të reja ose të blera së fundmi.

Si një hap i dytë i procesit të klasifikimit, Grupi vlerëson kushtet kontraktuale të aktiveve financiare për të identifikuar nëse ato përmbushin testin “vetem principal dhe interes” (SPPI). ‘Principal’ për qëllim të këtij testi përcaktohet si vlera e drejtë e aktivit financiar në njohjen fillestare dhe mund të ndryshojë gjatë jetës së aktivit financiar (për shembull, nëse ka shlyerje të principalit ose amortizim të primit / zbritjes).

Elementët më të rëndësishëm të interesit në kuadër të marrëveshjes së huadhënies janë zakonisht vlera kohore e parasë dhe rreziku i kredisë. Për të kryer vlerësimin e SPPI, Grupi analizon dhe merr në konsideratë faktorët përkatës si monedhën e aktivit financiar dhe periudhën për të cilën përcaktohet norma e interesit.

Në të kundërt, termat kontraktuale që paraqesin një ekspozim më të vogël se rreziqet ose paqëndrueshmëria në flukset e mjeteve monetare kontraktuale që nuk lidhen me një marrëveshje bazë huadhënie nuk krijojnë flukse monetare kontraktuale që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit në shumën e papaguar. Në raste të tilla, aktivet financiare kërkohen të matet në VDPFH.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

8 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

8.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

8.5.2 Derivativet e njohur me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Një derivativ i përbërë është një element i një instrumenti hibrid, i cili gjithashtu përfshin një kontratë bazë jo-derivative me efektin që disa nga flukset e mjeteve monetare të instrumentit të përbërë ndryshojnë në mënyrë të ngjashme me një derivativ të pavarur.

Nga një derivativ i përbërë mund të përftohen disa ose të gjitha flukset e mjeteve monetare që në të kundërt do të kërkohen nga kontrata të modifikohen sipas një norme interesi të caktuar, çmimit të instrumentit financiar, çmimit të mallrave, kursit të këmbimit, indeksit të çmimeve ose normave, indeksit të klasifikimit të kredisë ose kredisë, apo sipas njëvariabli tjetër, me kusht që në rastin e një variabli jofinanciar, nuk është specifike për një palë pjesë të kontratës. Derivativi që i bashkangjitet një instrumenti financiar, por që transferohet në mënyrë kontraktuale i pavarur nga ai instrument, ose ka një kundërparti të ndryshme nga ai instrument, nuk është derivativ i përfshirë, por një instrument financiar i veçantë. Aktivet financiare klasifikohen në bazë të modelit të biznesit dhe vlerësimeve të SPPI siç përshkruhet në Shënimin 8.5.1.1.

8.5.3 Instrumentat financiarë me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Grupi i klasifikon aktivet financiare ose detyrimet financiare të mbajtura për tregtim kur ato janë blerë ose lëshuar kryesisht për fitimin afatshkurtër nëpërmjet aktiviteteve tregtare ose formojnë një pjesë të një portofoli të instrumenteve financiare që menaxhohen së bashku, për të cilat ekzistojnë prova për një model të fundit të fitimit afatshkurtër. Aktivet dhe detyrimet e mbajtura për tregtim regjistrohën dhe maten me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar. Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në të ardhurat neto të tregtimit. Të ardhurat ose shpenzimet e interesit dhe të dividendit regjistrohën në të ardhurat neto të tregtimit sipas kushteve të kontratës ose kur është vendosur e drejta për pagesë. Në këtë klasifikim përfshihen letrat me vlerë të borxhit, që janë blerë kryesisht për qëllime të shitjes dhe riblerjes në të ardhmen e afërt.

8.5.4 Instrumentet e borxhit me VDATGJ

Grupi klasifikon instrumentat e borxhit të matur në VDATGJ kur plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- Instrumenti është mbajtur brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit arrihet duke mbledhur të dyja flukset monetare kontraktuale dhe duke shitur aktivet financiare;
- Kushtet kontraktuale të aktivit financiar plotësojnë testin SPPI.

Instrumentet e borxhit të VDATGJ maten më pas me vlerën e drejtë, së bashku me fitimet e humbjet që lindin për shkak të ndryshimeve në vlerën e drejtë të njohur në te ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Të ardhurat nga interesi, fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit njihen si fitime ose humbje në të njëjtën mënyrë si për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar, siç shpjegohet edhe në Shënimin 2.4.2. Llogaritja ECL për instrumentet e borxhit në VDATGJ shpjegohet në Shënimin 8.7.3. Kur Grupi ka më shumë se një investim në të njëjtin instrument, ato konsiderohen të nxirren me parimin e para që hyn-e para del. Në rast çregjistrimi, fitimet ose humbjet kumulative të njohura më parë në te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse riklasifikohen nga te ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në fitim ose humbje.

8.5.5 Borxhi i emetuar dhe fondet e tjera të huazuara

Pas matjes fillestare, borxhi i emetuar dhe fondet e tjera të huazuara maten më pas me koston e amortizuar. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose prim për fondet e emetuara dhe kostot, të cilat janë pjesë përbërëse e NEI-së. Instrumenti financiar i përbërë që përmban si një detyrim dhe një element kapitali, ndahet në datën e emetimit.

Grupi ka emetuar instrumente financiare me të drejta të konvertimit të kapitalit. Kur përcakton trajtimin kontabël për këto instrumente jo-derivative, Grupi përcakton fillimisht nëse instrumenti është një instrument i përbërë dhe i klasifikon elementet e instrumentit të veçantë veçmas, si detyrime financiare, aktive financiare ose instrumente të kapitalit neto në përputhje me SNK 32. Klasifikimi i detyrimit dhe elementeve të kapitalit të një instrumenti të konvertueshëm nuk është rishikuar si rezultat i një ndryshimi të gjasave se do të zbatohet opsi i konvertimit, madje edhe në rastet kur zbatimi i opsionit mund të duket se është ekonomikisht i favorshëm për disa titullarë. Kur vlera fillestare kontabël e një instrumenti financiar të përbërë alokohet tek përbërësit e kapitalit dhe detyrimit, përbërësi i kapitalit përcaktohet si shuma e mbetur pas zbritjes nga e gjithë vlera e drejtë e instrumentit. Shuma për përbërësin e detyrimit përcaktohet veças. Pasi Grupi të përcaktojë ndarjen midis kapitalit dhe detyrimit, ai vlerëson më tej nëse përbërësi i detyrimit ka derivativë të përfshirë, të cilët duhet të llogariten veçmas (siç është përcaktuar në Shënimin 8.5.2). Informacionet shpjeguese për borxhin e lëshuar të Grupit jepen në Shënimin 36 dhe Shënimin 37.

8.5.6 Aktivet financiare dhe detyrimet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Në këtë kategori, aktivet financiare dhe detyrimet financiare nuk mbahen për tregtim dhe janë përcaktuar nga menaxhmenti pas njohjes fillestare ose kërkohen domosdoshmërisht që të maten me vlerën e drejtë sipas SNRF 9. Menaxhmenti përcakton vetëm një instrument në VDPFH pas njohjes fillestare dhe pasi është plotësuar një nga kushtet e mëposhtme.

Ky përcaktim bëhet në bazë të instrumenteve:

- Emërtimi eliminon ose zvogëlon në mënyrë të konsiderueshme trajtimin e paqëndrueshëm që përndryshe do të lindte nga matja e aktiveve, detyrimeve ose njohja e fitimeve apo humbjeve mbi to në baza të ndryshme; Ose
- Detyrimet janë pjesë e një grupi detyrimesh financiare , të cilat menaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet në bazë të vlerës së drejtë, në përputhje me një strategji të dokumentuar të menaxhimit të rrezikut ose investimeve; Ose

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

8 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

8.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

8.5.6 Aktivet financiare dhe detyrimet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (vazhdim)

- Detyrimet përmbajnë një ose më shumë derivate të përfshira, përveç rasteve kur ato nuk modifikojnë në mënyrë të ndjeshme flukset e mjeteve monetare që në të kundërt do të kërkohej në përputhje me kontratën, ose është e qartë me pak ose aspak analizë kur një instrumenti i ngjashëm merret fillimisht në konsideratë dhe paraqet se ndarja e derivativëve të përfshirë është e ndaluar.

Aktivitetet dhe detyrimet financiare në VDPFH regjistrohen me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar. Ndryshimet në vlerën e drejtë regjistrohen në fitim dhe humbje me përjashtim të lëvizjeve në vlerën e drejtë të detyrimeve të përcaktuara në VDPFH, për shkak të ndryshimeve në rrezikun e kredisë së bankës. Këto ndryshime në vlerën e drejtë regjistrohen në rezervën e kredisë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe nuk riciklohen në fitim ose humbje. Interesi i fituar ose i përfutur nga instrumentet e përcaktuara në VDFH është përlogaritur në të ardhura nga interesat ose shpenzimet e interesit, duke përdorur respektivisht SNRF, duke marrë parasysh çdo zbritje / prim dhe kostot kualifikuese të transaksionit që janë pjesë përbërëse e instrumentit. Interesi i fituar nga aktivitetet kërkohej domosdoshmërisht të matet në VDFH duke përdorur normën kontraktuale të interesit.

8.5.7 Garanci financiare, letra kredie dhe letër angazhimi kredie

Grupi lëshon garanci financiare, letra kredie dhe letër angazhimi kredie. Garancitë financiare fillimisht njihen në pasqyrat financiare (brenda *Provigjioneve*) me vlerë të drejtë, meqë janë primi i marrë. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Grupit sipas secilës garanci matet me shumën më të madhe të shumës së njohur fillimisht pa amortizimin kumulativ të njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe një provigjioni ECL. Primi i marrë (nëse ka) njihet në pasqyrën e të ardhurave në zërin Të ardhurat neto nga komisionet dhe tarifat bazuar në metodën lineare përgjatë jetës së garancisë. Angazhimet e kredive të patërhequra dhe letrat e kredive janë angazhime sipas të cilave, gjatë kohëzgjatjes së angazhimit, Grupit i kërkohej të ofrojë një hua me terma të paracaktuar për klientin. Në mënyrë të ngjashme me kontratat e garancisë financiare, këto kontrata janë në përputhje me kërkesat e ECL-së. Vlera nominale kontraktuale e garancive financiare, letrave të kreditit dhe angazhimeve të huave, ku huatë e pranuar që të jepën janë në përputhje me kushtet e tregut, nuk regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar. Vlerat nominale të këtyre instrumenteve së bashku me ECL-të korresponduese janë paraqitur në Shënimin 45.

8.6 Riklasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Aktivitetet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare, me përjashtim të periudhës pasi Banka ndryshon modelin e saj të biznesit për administrimin e aktiveve financiare. Detyrimet financiare nuk riklasifikohen asnjëherë.

8.7 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

8.7.1 Përmbledhje e parimeve të ECL-së

Grupi ka regjistruar kompensimin për humbjet e pritshme të kredive për të gjitha huatë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në VDFH, së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare, të cilat në këtë seksion janë referuar që të gjitha si “instrumenta financiarë”. Sipas SNRF 9, instrumentet e kapitalit nuk janë subjekt zhvlerësimi. Zbritja ECL bazohet në humbjet nga kredia që pritet të lindin gjatë jetës së aktivitetit (humbja e pritshme nga kredia për jetë ose LTECL), përveç rasteve kur nuk ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi. Në këtë rast, kompensimi bazohet në humbjen e pritshme të kredisë prej 12 muajsh (12 mECL). Politikat e Grupit për të përcaktuar nëse ka pasur një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë janë paraqitur në Shënimin 47.2.

12MECL është pjesa e LTECL që përfaqësojnë ECL-të e rezultuara nga pagesat e vonuara të një instrumenti financiar, të cilat mund të kryhen brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

Si LTECLs dhe 12mECLs janë llogaritur në baza individuale ose në bazë kolektive, në varësi të natyrës së portofolit të instrumenteve financiare. Politika e Grupit për grupimin e aktiveve financiare të matura në baza kolektive shpjegohet në Shënimin 47.2.

Grupi ka krijuar një politikë për të kryer një vlerësim në fund të çdo periudhe raportuese, nëse rreziku i kredisë i një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duke marrë parasysh ndryshimin në rrezikun e mospagesës që ndodh gjatë jetës së mbetur të instrumentit financiar. Kjo shpjegohet më tej në Shënimin 47.2. Bazuar në procesin e mësipërm, Grupi i grupon kreditë e saj në Fazën 1, Fazën 2 dhe Fazën 3 dhe POCI, siç përshkruhet më poshtë:

- Fazë 1: Kur kreditë njihen për herë të parë, Grupi njih një zbritje në bazë të 12mECL. Në kreditë e fazës 1 përfshihen gjithashtu objekte ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Fazë 2.
- Fazë 2: Kur një hua ka shfaqur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga krijimi, Grupi regjistron një zbritje për LTECL-të. Në kreditë e fazës 2 përfshihen gjithashtu objekte, ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Fazë 3.
- Fazë 3: Kreditë që konsiderohen të zhvlerësuara (siç parashikohet në Shënimin 47.2). Grupi regjistron një zbritje për LTECL-të.
- POCI: Aktivitetet financiare të blera ose asetet me origjinë nga kreditë me probleme (POCI) janë aktivitetet financiare që janë të dëmtuara nga kredia që në njohjen fillestare. Aktivitetet e POCI-t regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një NEI të rregulluar nga kredia. ECL-të njihen ose njihen vetëm në masën që ka një ndryshim të mëvonshëm në humbjet e pritshme të kredisë.

Për aktivitetet financiare për të cilat Grupi nuk ka pritshmëri të arsyeshme që të mbulojë ose të gjithë shumën e mbetur papaguar, ose një pjesë të saj, vlera kontabël bruto e aktivitetit financiar zvogëlohet. Kjo konsiderohet një çregjistrim (i pjesshëm) i aktivitetit financiar.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

8 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

8.7.2 Llogaritja e ECL-ve

Grupi llogarit ECL-të bazuar në katër skenarë me probabilitet të ponderuar për të matur mungesat e pritshme të parave, të zbritura me një përafrim me NEI. Mungesa e parave është diferenca mes flukseve të mjeteve monetare që l përkasin një subjekti në përputhje me kontratën dhe flukset e mjeteve monetare që subjekti pret të marrë.

Mekanika e llogaritjeve ECL është përshkruar më poshtë dhe elementët kryesorë janë si vijon:

- PD - *Probabiliteti i mospagimit* është një vlerësim i gjasave së mospagimit për një periudhë të caktuar kohore. Mospagimi mund të ndodhë vetëm në një kohë të caktuar gjatë periudhës së vlerësuar, nëse objekti nuk është çregjistruar më parë dhe është ende në portofol.
- EAD - *Ekspozimi në Mospagim* është një vlerësim i ekspozimit në një datë të vonuar të ardhshme, duke marrë parasysh ndryshimet e pritura në ekspozim pas datës së raportimit, përfshirë shlyerjet e principalit dhe të interesit, qoftë të planifikuara sipas kontratës ose ndryshe, objektet dhe interesin e përlogaritur nga pagesat e humbura.
- LGD - *Humbja e rezultuar nga mospagesa* është një vlerësim i humbjes që ndodh në rastin kur një pagesë nuk kryhet në kohën e caktuar. Ajo bazohet në diferencën midis flukseve kontraktuale të mjeteve monetare dhe atyre që huadhënësi do të priste të merrte, përfshirë edhe realizimin e përmirësimeve të kolateralit dhe kredive, që janë një pjesë përbërëse e kredisë, siç përcaktohet në Shënimin 2.4. Shpesh shprehet si përqindje e EAD. Vlerat e ekspertizës së LGD-së përdoren si 1 duke hequr normat e parase se rikuperuar. Vlerat LGD për portofolin retail ndryshojnë nga 45% në 70% duke u varur nga fakti nëse janë apo jo të siguruara me një pronë rezidenciale ose tregtare. Vlerat për të gjithë portofolet e tjera si korporatë, mikro, i pavarur dhe letrat me vlerë të investuara janë në nivelin 45%.

Kur vlerëson ECLs, Grupi shqyrton katër skenarë (bazë, një optimist, pesimist1 dhe shumë pesimist 2). Secili nga këta është i lidhur me PD, EAD dhe LGD të ndryshme. Kur është e përshtatshme, vlerësimi i skenarëve të shumëfishta përfshin edhe mënyrën se si pritet të mbulohen kreditë e papaguara, duke përfshirë probabilitetin që kreditë do të rimekembën, vlerën e kolateralit ose shumën që mund të merret nga shitja e aktivitetit.

Me përjashtim të kartave të kreditit dhe kredive revolving, periudha maksimale për të cilat janë përcaktuar humbjet e kredisë, është jeta kontraktuale e një instrumenti financiar, me përjashtim të rasteve kur Grupi ka të drejtën ligjore për ta thirrur atë më herët.

Humbjet nga zhvlerësimi dhe rimarrjet llogariten dhe shpjegohen veçmas nga humbjet ose fitimet e modifikimit që llogariten si një rregullim i vlerës kontabël bruto të aktivitetit financiar. Vlerësimi i provigjioneve të ECL-ve për angazhimet e huave të patërhequra bëhet sipas parashikimeve të paraqitura në Shënimin 45.

Mekanizmi i metodës ECL përmbledhet më poshtë:

- Fazë 1: 12M ECL llogaritet si pjesë e LTECL-ve që përfaqësojnë ECL-të që rezultojnë nga mospagimi i një instrumenti financiar, të cilat bëhen të mundura brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Grupi llogarit zbritjen e 12mECL bazuar në pritshmërinë e një mospagimi që ndodh në 12 muajt pas datës së raportimit. Këto probabilitete të pritshme 12-mujore mospagimi aplikohen në një parashikim të EAD dhe shumëzohen me LGD-në e pritshme. Më pas, zbriten nga një përafrim me NEI-në fillestare. Kjo përlogaritje është bërë për secilin prej katër skenarëve, siç është shpjeguar më sipër.
- Fazë 2: Kur një hua ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi, Grupi regjistron një zbritje për LTECL-të. Mekanizmi është i ngjashëm me ato të shpjeguara më lart, përfshirë përdorimin e skenarëve të shumëfishta, por PD-të dhe LGD-të vlerësohen gjatë jetës së instrumentit. Mungesat e pritshme të parave zbriten nga një përafrim me NEI-n fillestare.
- Fazë 3: Për kreditë e konsideruara të dëmtuara nga kredia, Grupi njih humbjet e pritshme të kredisë për këto kredi. Metoda është e ngjashme me atë të aseteve të Fazës 2, me PD të vendosur në 100%.
- POCI: Aktivitetet POCI janë aktive financiare që janë të zhvlerësuara nga kreditë që në njohjen fillestare. Grupi njih vetëm ndryshimet akumulative në jetën e ECL-ve, që nga njohja fillestare, bazuar në një probabilitet të ponderuar të katër skenarëve, të skontuara nga NEI e të rregulluar.

8.7.3 Instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë përmes ATGJ

ECL-të për instrumentet e borxhit të matura në VDATGJ nuk zvogëlojnë vlerën kontabël të këtyre aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar, i cili mbetet në vlerën e drejtë. Në vend të kësaj, një shumë e barabartë me zbritjen që do të lindte nëse aktivitetet maten me koston e amortizuar, njihen në ATGJ si një shumë e akumuluar e zhvlerësimit, me një ngarkesë korresponduese në fitim ose humbje. Humbja e akumuluar e njohur në ATGJ riciklohet në fitim dhe humbje pas çregjistrimit të aktiveve.

8.7.4 Aktivitetet financiare të provigjionuara ose në blerje ose në origjinë (POCI)

Për aktivitetet financiare POCI, Grupi njih vetëm ndryshimet kumulative në LTECL që nga njohja fillestare në zbritjen e humbjes.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

8 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

8.7 Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

8.7.5 Informacioni Forward looking

Në modelet e tij ECL, Grupi mbështetet në një gamë të gjerë informacionesh Forward looking si inpute ekonomike, të tilla si:

- Rritja e PBB-së

- Normat e papunësisë

- Normat bazë të Bankës Qendrore

- Indekset e çmimeve të banesave

Inputet dhe modelet e përdorura për llogaritjen e ECL (HPK) mundet që të mos kapin gjithmonë të gjitha karakteristikat e tregut në ditën e pasqyrave financiare. Për të reflektuar këtë, rregullime cilësore ose sipërfaqësore bëhen here pas here si rregullime të përkohshme kur këto diferenca janë materialisht të rëndësishme. Informacion i detajuar për këto inpute dhe analizës së ndjeshmërisë jepen në Shënimin 47.2.

8.8 Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare janë dërguar dhe shuma neto është paraqitur në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Grupi ka të drejtë ligjore të shlyejë shumat dhe ka për qëllim të shlyejë në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur lejohet nga standardet e kontabilitetit, ose për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup transaksionesh të ngjashme siç është aktiviteti tregtar i Grupit.

8.9 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

8.9.1 Metoda e interesit efektiv

Sipas SNRF 9, te ardhurat nga interesi rregjistrohen duke perdorur metoden e interesit efektiv per te gjitha aktivet financiare te matura me kosto te amortizuar, derivative e normave te interesit per te cilat aplikohet kontabiliteti mbrojtës dhe efekti i amortizimit/riciklimit te lidhur me kontabilitetin mbrojtës. Ngjashëm me aktivet financiare me interes, të ardhurat nga interesi në aktivet financiare me interes të matur në FDTAGJ sipas SNRF 9 rregjistrohen duke përdorur metodën e interest efektiv. Shpenzimet e interesit llogariten gjithashtu duke përdorur metodën e interest efektiv për të gjitha detyrimet financiare të mbajtura me koston e amortizuar. NEI është norma që saktësisht aktualizon arkëtimet e ardhshme në para nëpërmjet jetës së pritshme të aktivit ose pasivit financiar ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër, në vlerën kontabël bruto të aktivit financiar. NEI (dhe për rrjedhojë, kostoja e amortizuar e aktivit financiar) llogaritet duke marrë parasysh kostot e transaksionit dhe çdo zbritje ose tarife për blerjen e aktivit financiar, si dhe tarifat dhe kostot që janë pjesë përbërëse e normës së interest efektiv. Grupi njihet të ardhurat nga interesi duke përdorur një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një norme konstante kthimi gjatë jetës së pritshme të huasë. Prandaj, llogaritja e NEI gjithashtu merr parasysh efektin e normave të interesit potencialisht të ndryshme që mund të ngarkohen në faza të ndryshme të jetës së pritshme të aktivit financiar dhe karakteristikave të tjera të ciklit jetësor të produktit (përfshirë parapagimet, interesat dhe komisionet). Nëse pritshmëritë e flukseve monetare të mjeteve financiare ose të detyrimeve me normë fikse rishikohen për shkaqe të tjera përveç rrezikut të kredisë, atëherë ndryshimet në flukset e ardhshme monetare kontraktuale zbriten në NEI origjinale me një rregullim pasojë në vlerën kontabël. Diferenca nga vlera e mbartur e mëparshme është e rezervuar si një rregullim pozitiv ose negativ në vlerën kontabël të aktivit ose pasivit financiar në bilanc me një rritje ose ulje korresponduese të të ardhurave / shpenzimeve të interesit të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv.Për instrumentet financiare me normë të luhatshme, rivlerësimi periodik i flukseve të mjeteve monetare për të pasqyruar lëvizjet në normat e interesit të tregut ndryshon gjithashtu normën efektive të interesit, por kur instrumentet fillimisht njiheshin në një shumë të barabartë me principalin, duke rivlerësuar të ardhmen pagesat e interesit nuk ndikojnë ndjeshëm në vlerën kontabël neto të aktivit ose pasivit.

8.9.2 Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit

Të ardhurat neto nga interesi përfshijnë të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit të llogaritura duke përdorur si metodën e interesit efektiv ashtu edhe metoda të tjera. Këto janë paraqitur veças në faqen e pasqyrës së të ardhurave për të ardhurat nga interesat dhe shpenzimet e interesit për të siguruar informacion simetrik dhe të krahasueshëm. Në të ardhurat / shpenzimet e tij të interesit të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të ardhura / shpenzime të tjera interesi përfshijnë interesin mbi aktivet / detyrimet financiare të matura në VDPFH, përveç atyre që mbahen për tregtim, duke përdorur normën e interesit kontraktual. siç paraqiten në notën 8.9.1 si më sipër. Të ardhurat / shpenzimet nga interesi në të gjitha aktivet / detyrimet financiare tregtare njihen si pjesë e ndryshimit të vlerës së drejtë në të ardhurat neto të tregtimit. Grupi llogarit të ardhurat nga interesi mbi aktivet financiare, përveç atyre që konsiderohen si të dëmtuara nga kredia, duke aplikuar NEI në vlerën kontabël bruto të aktivit financiar. Kur një aktiv financiar bëhet i zhvlerësuar (dhe për këtë arsye konsiderohet si 'Stadi 3', Grupi llogarit të ardhurat nga interesi duke aplikuar NEI në koston e amortizuar neto të aktivit financiar. me zhvlerësim, Grupi kthehet në llogaritjen e të ardhurave nga interesi në baza bruto. Për aktivet financiare të zhvlerësuara në blerje ose në origjinë (POCI) Grupi llogarit të ardhurat nga interesi duke llogaritur NEI-të rregulluar për zhvlerësimin dhe duke aplikuar atë normë në koston e amortizuar të aktivit financiar. NEI i rregulluar nga kreditë është norma e interesit që, në njohjen fillestare, zvogëlon flukset monetare të ardhshme të vlerësuara (duke përfshirë humbjet e kredisë) në koston e amortizuar të aktivit financiar të POCI.

Grupi mban gjithashtu investime në aktivet financiare të emetuara në vende me norma interesi negative. Grupi zbulon interesin e marrë mbi këto aktive financiare si shpenzim interesi. Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitimet ekonomike të rrjedhin në Bankë dhe të ardhurat mund të maten me besueshmëri.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

8 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

8.10 Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione dhe tarifa

Grupi fiton te ardhura dhe tarifa nga komisione per nje diversitet sherbimesh financiare, te cilat jane ne sherbim te klienteve. Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet konsiderohen ne vleren qe Grupi ka pritshmeri per tu njohur ne kembim te sherbimeve te dhena.

Të tjera tarifa dhe komisione që përfshijnë tarifa për shërbimin e llogarive, tarifa për administrimin e investimeve, komision shitje, tarifat e vendosjes dhe përfaqësimit njihen ndërsa shërbimi i lidhur kryhet.

Shpenzime të tjera për tarifat dhe komisionet që lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimi shpenzohen në momentin që ofrohen shërbimet.

8.11 Të ardhura neto tregtare

Të ardhura neto tregtare përfshijnë fitime dhe humbje në vlerën e drejtë dhe shpenzimet dhe të ardhurat e lidhura dhe dividendët, për aktivet dhe detyrimet financiare të mbajtura për tregtim. Këto janë përfshirë në zërin e të ardhurave nga interesi si të ardhura neto tregtare.

Humbja neto nga instrumentet financiare të mbajtura me VDPFH përfaqëson derivativë jotregtarë të mbajtur për qëllime të administrimit të rrezikut të përdorur në marrëdhëniet e mbrojtjes ekonomike, por që nuk kualifikohen për marrëdhëniet e kontabilitetit mbrojtës, aktivet financiare dhe detyrimet financiare të përcaktuara si VDPFH dhe nga 1 janari 2018, gjithashtu aktive jotregtare maten me VDPFH, siç kërkohet ose zgjidhet sipas SNRF 9. Ky zë përfshin ndryshimet në vlerën e drejtë, interesin, dividendët dhe diferencat e këmbimit valutor.

8.12 Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to

Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qendrore dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rezeqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Grupi në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

8.13 Letrat me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimeve fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe më pas mbarten në varësi të klasifikimit të tyre, si letra me vlerë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ose letra me vlerë nëpërmjet fitimit ose humbjes (e detyrueshme).

8.14 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivi e-drejta-në-përdorim

(i) Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivit. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivit në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimin në vendin në të cilin ato ndodhen. Programi kompjuterik i blerë, i cili është një pjesë integrale e funksionimit të pajisjes kontabilizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e pjesëve të zëvendësuara të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që ne te ardhmen Grupi do te këtë përfitime ekonomike nga këto pjese dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur lindin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura dhe shpenzimeve me anën e metodës linerare mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivit. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit. Toka nuk zhvlerësohet. Metodatat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit. Aktivi e-drejta-ne-përdorim amortizohet në mënyre lineare përgjatë kohëzgjatjes së qerasë. Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve afatgjata	% e amortizimit
Ndërtesa	5%
Pajisje elektronike	25%
Automjete	20%
Mobilie dhe pajisje zyre	20%
Përmirësimet e ambienteve të marra me qira	5%

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

8 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

8.15 Aktivet jomateriale

(i) *Programe kompjuterike*

Programet kompjuterike të blera nga Grupi njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin. Amortizimit njihet në fitim ose humbje me normën 25% mbi vlerën e mbetur prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim.

(ii) *Liçensat*

Liçencat dhe të drejtat e përdorimit blerë nga Grupi janë të paraqitura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi nëse ka. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm atëherë kur ato rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktivin me të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare mbi jetën e dobishme të licencës që nga data që është e vlefshme për përdorim.

8.16 Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë vlerësohet shuma e rikuperueshme e aktivit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivit ose njësia e saj gjeneruese e parave tejkalon shumën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e parave është grupi më i vogël i aktiveve të identifikueshme që gjenerojnë flukset e parave që janë kryesisht të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivit ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim.Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e parashikuara të parave të zbritura zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritje para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parave dhe rreziqet specifike për aktivin.

8.17 Garancitë Financiare

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Grupin që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës. Detyrimet për garancitë financiare fillimisht njihen në vlerën e drejtë dhe vlera fillestare amortizohet mbi jetën e garancisë financiare. Detyrimi për garancinë mbahet me vlerën më të lartë midis vlerës me kosto të amortizuar dhe vlerës aktuale të pagesave të pritshme (kur pagesa nën një garanci është bërë e mundshme). Garancitë financiare përfshihen tek detyrimet e tjera.

8.18 Përfitimet e pensioneve

(i) *Sigurimet shoqërore të detyrueshme*

Grupi paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet e Sigurimeve Shoqërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuara për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime kur ato ndodhin.

(ii) *Leja vjetore e paguar*

Grupi njeh si detyrim shumën e përllogaritur të kostos për lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

(iii) *Sigurimet shëndetësore të punonjësve*

Grupi gjithashtu paguan kontribute të përcaktuara për sigurimin shëndetësor të punonjësve. Kontributi është i pagueshëm ndaj një kompanie sigurimi në raport me shërbimet e kryera në bankë nga ana e punonjësve dhe është regjistruar si një shpenzim nën 'shpenzime të personelit'. Kontributet e papaguara janë të regjistruar si detyrime.

(iv) *Kontribut vullnetar i pensionit për punonjësit*

Grupi ka krijuar një Plan Pensioni Profesional për punonjesit e vetë. Grupi merr përsipër të paguajë kontribute për cdo punonjës që ka firmosur një kontratë individuale për “Planin Profesional të Pensionit.” Shpenzimi vjetor përfaqëson kontributin vjetor të paguar nga Grupi, dhe regjistrohet në zërin “Shpenzime Personeli,” duke prekur pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të Grupit, dhe pa ndikuar në detyrimet e mëvonshme të Grupit.

8.19 Provizione për detyrime të kushtëzuara dhe angazhime

Një provizion është njohur nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare të ardhshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasasë dhe, aty ku është e përshtatshme, rreziqet specifike që lidhen me detyrimin. Një provizion për ristrukturimin njihet kur Grupi ka miratuar një plan të detajuar dhe formal ristrukturimi, dhe ristrukturimi ose ka filluar ose është shpallur publikisht. Shpenzimet operative të ardhshme nuk janë provizionuar.

Një provizion për kontratat e dyshimta njihet kur përfitimet që priten të rrjedhin te Grupi nga një kontratë janë më të ulëta se sa kostoja e pashmangshme e përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet me më të ultën mes vlerës aktuale të kostos së pritshme nga ndërprerja e kontratës dhe kostos së pritshme neto të vazhdimit me kontratën. Para se të njihet provizioni, Grupi njeh çdo humbje nga zhvlerësimi mbi aktivet e lidhura me atë kontratë.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

8 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

8.20 Tatimet

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

(i) *Tatimi aktual mbi fitimin*

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në Pasqyrën e të Ardhurave Përmbledhëse për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshëm ose të zbritshëm në periudhat e ardhshme dhe zërat që nuk taten apo njihen si të zbritshëm asnjëherë.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke rregulluar fitimin para tatimit për shumën e të ardhurave shpenzimeve të caktuara, siç kërkohet nga ligji Shqiptar.

(ii) *Tatimi i shtyrë mbi fitimin*

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllim fiskale. Detyrimet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të disponueshme, ndaj të cilave ato mund të shfrytëzohen.

Vlera kontabël neto e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është e mundur që të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme në dispozicion për të lejuar që e gjitha ose një pjesë e aktivit të mund të rikuperohet. Detyrimet dhe aktivet e shtyra tatimore maten me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet ose aktiv realizohet, bazuar në normat fiskale dhe ligjet fiskale të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit. Matja e detyrimeve dhe aktiveve tatimore të shtyra pasqyron rrjedhojat tatimore që do të vijnë nga mënyra në të cilën Grupi pret, që në fund të periudhës raportuese, të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

(iii) *Tatimi aktual dhe i shtyrë për vitin*

Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveç kur lidhen me zërat që janë njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse, ose direkt në kapital, rast në të cilin tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen edhe në të ardhurat e tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejtë në kapital, përkatësisht.

8.21 Prona të riposeduara

Politika e Grupit është të përcaktojë nëse një aktiv i riposeduar do të përdoret për përdorim të brendshëm nga Grupi apo do të shitet. Aktivet e përcaktuara si të dobishme për aktivitetet e brendshme të Grupit transferohen në klasën përkatëse të aktiveve me vlerën më të ulët mes vlerës së riposedimit dhe vlerës kontabël të aktivit fillestar të siguruar.

Grupi zotëron disa prona të riposeduara të cilat i ka marrë nga ekzekutimi i kolateraleve të huave dhe paradhënieve ndaj klientëve. Grupi i mat këto aktive të riposeduara fillimisht me kosto (çmim blerje). Në fund të cdo periudhe raportuese këto aktive maten me më të voglën mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga çdo ndryshim në vlerën neto të realizueshme të pronave të riposeduara njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën linden. Këto aktive çregjistrohen kur nxirren jashtë përdorimit ose kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga ky pakësim (nxjerrje jashtë përdorimit). Çdo fitim ose humbje që rrjedh nga mosnjohja e pronës (llogaritur si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të aktivit) përfshihet në fitim ose humbje në periudhën në të cilën prona është çregjistruar.

8.22 Depozitat dhe borxhi i varur

Depozitat, letrat me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur janë burimet kryesore të financimit të Grupit. Kur Grupi shet një aktiv financiar dhe hyn në një “marrëveshje riblerjeje” për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktiv vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Grupit.

Depozitat, letra me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur maten fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv përveçse në rastet kur Grupi zgjedh që t'i mbajë detyrimet me vlerën e drejtë në fitim ose humbje. Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një detyrimi financiar dhe i alokimit të shpenzimit të interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skonton deri në vlerën kontabël neto në njohjen fillestare, pagesat monetare të ardhshme të vlerësuara (përfshirë të gjitha taksat dhe shumat e paguara ose të marra që formojnë një pjesë përbërëse të normës efektive të interesit, kostot e transaksionit dhe primet e tjera ose zbritjet) përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose (sipas rastit) përgjatë një periudhe më të shkurtër.

8.23 Rezervat e kapitalit

Rezervat e regjistruara në kapital (të ardhurat e tjera përmbledhëse) në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë:

“Rezervën” që përfshin ndryshimet e bëra siç përcaktohet në rregulloret e Bankës Qëndrore dhe Ligjin Tregtar të zbatueshëm në Shqipëri.

“Rezervën e rivlerësimit” e cila është përdorur për të regjistruar ndryshimet që rrjedhin nga rivlerësimi i letrave me vlerë të vendosjes .

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

8 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

8.24 Çrregjistrimi

Aktivët financiarë çrregjistrohen pjesërisht ose totalisht vetëm kur Grupi nuk ka një pritshmëri për recuperimin e aktivitetit financiar qoftë tërësisht apo pjesërisht. Nëse vlera që do çrregjistrohet është është më e lartë se zhvlerësimi i akumuluar, diferenca ndërmjet tyre njihet fillimisht si zhvlerësim dhe më pas aplikohet mbi vlerën e mbetur. Cdo rimarrje e mëtejshme kreditohet më pas në shpenzimet e humbjeve të kredisë.

8.25 Kreditë e ristrukturuar ose të modifikuara

Grupi ndonjëherë bën lejime ose modifikime në kushtet fillestare të kredive si përgjigje e vështirësive financiare të kreditorit, në vend që të riposdojë ose të marrë me forcë kolateralin. Grupi konsideron një kredi të ristrukturuar kur këto lejime ose modifikime janë prej vështirësive financiare aktuale apo të pritshme të kreditorit dhe Grupi nuk do kishte rënë dakort për to nëse kreditori do ishte i shëndetshëm financiarisht. Tregues të vështirësive financiare përfshijnë vonesa për përmbushjen e kovenantëve, ose rritje të shqetësimit të ngritur nga departamenti i riskut të kredisë. Ristrukturimi mund të përfshijë shtyrjen e angazhimeve të pagesave dhe marrëveshjen për një kredi me kushte të reja. Sapo rinegociohen kushtet e reja, cdo zhvlerësim matet duke përdorur NEI origjinal të llogaritur para modifikimeve të kushteve. Është politikë e Grupit të monitorojë kreditë e ristrukturuara për të siguruar që pagesat në të ardhmen të jenë të mundshme të ndodhin.

Vendimet e çrregjistrimit dhe klasifikimi ndërmjet Stadi 2 dhe Stadi 3 përcaktohen rast pas rasti. Nëse këto procedura identifikojnë një humbje në lidhje me një kredi, ajo shpaloset dhe manaxhohet si e zhvlerësuar në Stadin 3 aktiv i ristrukturuar deri sa ajo të mblidhet apo të çrregjistrohet.

8.26 Qiratë

Grupi vlerëson çdo fillim marrëveshjeje nëse një kontratë është ose përmban një qira. Thënë kjo, nëse kontrata përmban të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë të caktuar në këmbim të kundërshpërblimit të dhënë.

8.26.1 Grupi si qiramarres

Grupi aplikon një metodë njohjeje dhe matjeje për të gjitha qiratë, përveç qirave afatshkurtra dhe qirave për aktivet me vlerë të ulët. Grupi njeh detyrimet e qirasë për pagesat e qirave dhe aktivin e drejta-në-përdorim që përfaqëson të drejtën e përdorimit të aktivit me qira.

Aktivi e drejta-në-përdorim

Grupi njeh aktivin e drejta-në-përdorim në datën e fillimit të qirasë (p.sh., data kur aktivi me qira është i gatshëm për përdorim). Aktivi e drejta-në-përdorim matet me kosto, pakësuar me amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, dhe i korgjuar për çdo ri-matje të detyrimit të qirasë. Kosto e aktivit e drejta-në-përdorim përfshin vlerën e njohur të detyrimit të qirasë, kosto fillestare direkte, dhe pagesta e bëra të qirasë në ose përpara ditës së fillimit pakësuar me ndonjë incentive qiraje të bërë. Aktivët e drejta-në-përdorim amortizohet linearisht përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

Aktivët e drejta-në-përdorim prezantohen në shënimin 31 Aktive të drejta-në-përdorim dhe janë subjekt zhvlerësimi në linjë me politikat e Grupit siç përshkruhen në Shënimin 8.15 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare.

Detyrimet e qirasë

Në ditën e fillimit të qirasë, Grupi njeh detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave të qirasë për tu bërë përgjatë kohëzgjatjes së qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesa fikse (pakësuar me ndonjë incentive të marrë), pagesa variable të qirasë që varen nga një indeks apo normë, dhe vlerat që priten të paguhen nën garancitë e vlerës së mbetur. Pagesat e qirasë përfshijnë gjithashtu cmimin e ushtrimit të opsionit të blerjes nëse është mjaftueshmërisht e sigurtë të ushtrohet nga Grupi dhe pagesat e penaliteteve për përfundimin e qirasë, nëse kushtet e qirasë reflektojnë ushtrimin e opsionit të përfundimit. Pagesat variable të qirasë që nuk varen nga një indeks apo normë njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ndodh ngjarja apo kushti që sjell pagesën.

8.26.2 Grupi si qiradhenes

Qiratë ku Grupi transferon rrezikun dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit klasifikohen si qira financiare. Në pasqyrën e gjendjes financiare, Grupi paraqet në pasqyrën e pozicionit financiar shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën neto të investimit.

Njohja e të ardhurave financiare do të bazohet në një model që pasqyron një normë konstante periodike të kthimit të investimit neto të qiradhënësit mbi qiranë financiare. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, i janë zbritur investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin (kryegjënë), ashtu edhe të ardhurat financiare të pafituara. Të ardhurat nga shitja të njohura nga prodhuesi ose tregtari qiradhënës në fillim të afatit të leasing-ut janë vlera e drejtë e aktivitetit, ose, nëse më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të leasing-ut që i takojnë qiradhënësit, llogaritur me normën e interesit të tregut.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

9 Të ardhura neto nga interesat

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura nga interesat		
Hua dhe paradhënie për klientët	13,060,197	10,986,778
Të ardhura neto tregtare	2,189	5,067
Letra me vlerë	5,520,689	4,719,938
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	306,987	737,523
Hua dhënë bankave	87,888	46,449
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	173,497	183,661
Totali i të ardhurave nga interesat	19,151,447	16,679,416
Shpenzimet për interesa		
Detyrime ndaj bankave	(169,613)	(96,808)
Detyrime ndaj klientëve	(3,983,344)	(3,216,147)
Borxhi i varur	(778,941)	(601,870)
Shpenzim interesi i detyrimit të qerases	(226,626)	(116,892)
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	(17,987)	(51,664)
Totali i shpenzimeve për interesat	(5,176,511)	(4,083,381)
Te ardhura nga interesi	13,974,936	12,596,035

Të ardhura nga interesi përfshijnë edhe të ardhura nga rivlerësimi i aktiveve të investuara në fondet e investimeve alternative Fondi “Sea Land” dhe Fondi “Green View” i cili më 31 dhjetor 2025 ishte në shumën 437,974 mijë Leke (31 dhjetor 2024: 798,208 mijë Leke).

10 Të ardhura neto nga komisionet

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet		
Komisione nga shërbimet bankare	2,897,206	2,669,589
Tarifa dhe komisione nga shërbimet e huadhënies	139,822	102,140
Totali i të ardhurave nga tarifat dhe komisionet	3,037,028	2,771,729
Shpenzime për tarifa dhe komisione		
Tarifa për veprime ndërbankare	(65,346)	(66,188)
Veprime me thesarin	(1,133,740)	(917,733)
Të tjera	(63,313)	(52,043)
Totali i shpenzimeve për tarifa dhe komisione	(1,262,399)	(1,035,964)
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	1,774,629	1,735,765

11 Të ardhura të tjera, neto

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura të tjera		
Rimarrje nga huatë e fshira	172,966	249,693
Të ardhura të tjera (shënimi 28)	59,841	410,624
Totali i të ardhurave të tjera	232,807	660,317
Shpenzime të tjera		
Shpenzime të tjera të lidhura me aktivitetet e grupit	(620,476)	(721,672)
Totali i shpenzimeve të tjera	(620,476)	(721,672)
Të ardhura të tjera, neto	(387,669)	(61,355)

Peshën kryesore të shpenzimeve të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 e përbën shpenzimi që lidhet me rënien në vlerë të pronave të riposeduara, i cili më 31 dhjetor 2025 ishte në shumën 329,033 mijë Lekë (31 dhjetor 2024: 236,676 mijë Lekë) (shënimi 27) dhe rënia në vlerë e investimeve në pjesëmarrje në shumën 81,603 mijë Lekë (31 dhjetor 2024: 42,526 mijë Lekë) (shënimi 24). Peshën kryesore në zërin të ardhura të tjera e zëne të ardhurat nga arkëtimet e huave të regjistruara write off të cilat në vitin 2025 ishin në shumën 172,966 mijë Lekë (2024 249,692 mijë Lekë

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

12 Humbje nga zhvlerësimi i instrumentave financiarë

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Zhvleresimi (ECL) per mjetet monetare dhe te ngjashme me to	16	(30,354)	(75,730)
Zhvleresimi (ECL) shuma të pakushtëzuara me Bankën Qëndrore	17	6,489	(938)
Zhvleresimi (ECL) ne hua dhe paradhenie bankave	18	(7,128)	19,285
Zhvleresimi (ECL) ne letrat me vlere	21,22	13,227	47,969
Zhvleresimi (ECL) hua dhe paradhenie klienteve dhe qira financiare	25;26	3,464,830	3,806,439
Zhvleresimi (ECL) ne te tjera aktive financiare (debitoret)	32	(4,462)	4,090
Zhvleresimi (ECL) ne te tjera aktive financiare (debitore ligjore)		1,200	24,266
Zhvleresimi (ECL) ne garancite dhe letrat e kreditit	45	(7,046)	(20,403)
		3,436,756	3,804,978

13 Shpenzime Personeli

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Pagat e punonjësve	2,376,333	2,145,753
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	293,975	269,081
Primi i sigurimit të jetës për punonjësit	68,556	61,119
Të tjera	189,158	185,397
	2,928,022	2,661,350

14 Shpenzime Administrative

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Sigurime dhe mbikëqyrje	1,219,193	987,977
Tarifa për palë të treta	444,097	479,645
Qira	315,386	91,557
Marketing dhe abonime	864,762	900,017
Mirëmbajtje	647,524	609,886
Ujë, energji	189,844	216,434
Shpenzime zyre	139,904	120,884
Të tjera	135,984	112,318
Taksa lokale dhe të tjera	40,695	40,653
Transport dhe udhëtime	52,420	59,384
	4,049,809	3,618,755

Sigurimi dhe mbikqyrja, shpenzime per qera si dhe për mirembajtjen janë rritur si rezultat i rritjes së aktivitetit të Grupit dhe aktivitetit ditor.

15 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Tatimi aktual	669,992	527,305
Tatimi i fitimit te filialit	115,342	81,603
Të ardhura nga tatim fitimi i shtyrë (shënimi 33)	-	-
Tatimi mbi fitimin	785,334	608,908

Shpenzimet e zhvlerësimit të njohura nga Grupi në përputhje me SNRF do të konsiderohen si shpenzime të zbritshme për efekt tatimi, me kusht që ato të jenë certifikuar nga një auditues i jashtëm. Në përputhje me legjislacionin tatimor në Shqipëri, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2025 është 15% (31 dhjetor 2024: 15%). Rakordimi i normës efektive të tatimit mbi fitimin është përmbledhur si më poshtë:

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

15 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (vazhdim)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Fitimi para tatimit	4,038,353	3,218,100
Tatim fitim i llogaritur si 15%	605,753	482,715
Rregullim për humbjet e panjohura të investimit në pjesëmarrje	88	97
Rregullim për (humbjet)/fitimet e patatueshme të filialeve	(35,938)	(5,295)
Efekti i shpenzimeve të pazbritshme në tatim fitim	100,089	49,788
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	669,992	527,305

Deklaratat tatimore plotesohen cdo vit, por fitimet ose humbjet e deklaruarra për qëllime fiskale konsiderohen provizore derisa deklaratat tatimore dhe llogaritjet e tatimit të inspektohen nga autoritetet tatimore dhe një vlerësim final të lëshohet. Legjislacioni shqiptar mbi tatimin është subjekt i interpretimeve nga autoritetet tatimore. Shpenzimet e panjohura përfshijnë humbje nga kreditë e pambledhshme, rënie vlere të pronave të riposeduara, provigjonet e krijuara, shpenzimin e amortizimit për përmirësimet e ambjenteve me qera të cilat nuk njihen për efekte fiskale, dhe shpenzime të tjera të panjohura sipas legjislacionit fiskal në fuqi.

16 Mjete monetare dhe ekuivalente

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Llogarite rrjedhëse me bankat	1,734,454	2,928,716
<i>Zhvlerësimi HPK për llogaritë me bankat</i>	<i>(460)</i>	<i>(1,085)</i>
Vendosjet në tregun e parasë	3,645,213	3,481,733
<i>Zhvlerësimi HPK për vendosjet në banka</i>	<i>(393)</i>	<i>(9,517)</i>
Aktive monetare në arkë	7,347,072	7,432,538
Llogarite rrjedhëse të pakushtëzuara me Bankën Qendrore	4,523,784	13,708,360
<i>Zhvlerësimi HPK për balancat me with Bankën Qendrore</i>	<i>(14,846)</i>	<i>(35,459)</i>
Në tranzit	(191,801)	(981,340)
	17,043,023	26,523,946

Një analizë e ndryshimeve në vlerën e humbjeve të pritshme paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2025			
	Stadi 1	Stadi 2	Stadi 3	Totali
Gjendja më 1 Janar	46,061	-	-	46,061
Kalim në Stadin 1 (nga 2 ose 3)	-	-	-	-
Kalim në Stadin 2 (nga 1 ose 3)	-	-	-	-
Kalim në Stadin 3 (nga 1 ose 2)	-	-	-	-
Rimatja neto e humbjes	-	-	-	-
Aktive financiare të blera ose të origjinuara	(30,355)	-	-	(30,355)
Çrregjistrimi I aktiveve financiare	-	-	-	-
Të nxjerra jashtë bilanci	-	-	-	-
Ndryshime ne modelin, parametrat e riskut	-	-	-	-
Ndryshime nga kursi këmbimit	(7)	-	-	(7)
Ndryshime në vlerën aktuale të zhvlerësimit	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor	15,699	-	-	15,699
	31 dhjetor 2024			
	Stadi 1	Stadi 2	Stadi 3	Totali
Gjendja më 1 Janar	121,863	-	-	121,863
Kalim në Stadin 1 (nga 2 ose 3)	-	-	-	-
Kalim në Stadin 2 (nga 1 ose 3)	-	-	-	-
Kalim në Stadin 3 (nga 1 ose 2)	-	-	-	-
Rimatja neto e humbjes	-	-	-	-
Aktive financiare të blera ose të origjinuara	(75,775)	-	-	(75,775)
Çrregjistrimi I aktiveve financiare	-	-	-	-
Të nxjerra jashtë bilanci	-	-	-	-
Ndryshime ne modelin, parametrat e riskut	-	-	-	-
Ndryshime nga kursi këmbimit	(27)	-	-	(27)
Ndryshime në vlerën aktuale të zhvlerësimit	-	-	-	-
Gjëndja më 31 dhjetor	46,061	-	-	46,061

Vendosjet në tregun e parasë përfshijnë vendosjet me bankat rezidente dhe jo-rezidente, me maturitet afatshkurtër, deri në 3 muaj. Mjetet monetare në tranzit përfaqësojnë pagesa ndaj Autoriteteve Tatimore të kryera nga klientë të Grupit, për të cilat Grupi vepron si agent për mbledhjen e tyre. Këto transaksione janë kryer brenda datës 31 dhjetor 2025, dhe mbyllen me transferimin e vlerave tek llogaria rrjedhëse e Grupit me Banken Qendrore në ditët e para të Janar 2026. Detajet mbi kompensimi i zhvlerësimit të balancave me Bankën Qendrore jepen në shënimin 17.1.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

17 Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore

	31 December 2025	31 December 2024
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qëndrore	18,953,113	17,973,355
Zhvlerësimi HPK	(57,474)	(50,991)
Balanca me Banken Qendrore, net	18,895,639	17,922,364

Norma e kërkuar e rezervës është përqindja e bazës së rezervës së kërkuar, e cila mbahet në Bankën e Shqipërisë. Norma e rezervës së kërkuar në Lekë llogaritet si më poshtë:

- 7.5 për qind për kategoritë e detyrimeve të përfshira në bazën e rezervës së detyruar ndaj të cilave nuk zbatohet norma 0 (zero) për qind e rezervës së detyruar dhe që kanë një afat maturimi jo më të gjatë se 12 muaj

- 5.0 për qind për kategoritë e detyrimeve të përfshira në bazën e rezervës së detyruar ndaj të cilave nuk zbatohet norma 0 (zero) për qind e rezervës së detyruar dhe që kanë një afat fillestar më të gjatë se 12 muaj deri në 2 vjet

Norma e rezervës së kërkuar në monedhë të huaj llogaritet si më poshtë:

- 12.5 për qind për kategoritë e detyrimeve të përfshira në bazën e rezervës së detyruar ndaj të cilave nuk zbatohet norma 0 (zero) për qind e rezervës së detyruar, kur vlera e raportit “detyrime në valutën përkatëse të përfshira në bazën e rezervës së detyruar ndaj të cilave nuk zbatohet norma 0 (zero) për qind e rezervës së detyruar/totali i detyrimeve të përfshira në bazën e rezervës së detyruar ndaj të cilave nuk zbatohet norma 0 (zero) për qind e rezervës së detyruar” për bankën është deri në 50 (pesëdhjetë) për qind

- 20 për qind për kategoritë e detyrimeve të përfshira në bazën e rezervës së detyruar ndaj të cilave nuk zbatohet norma 0 (zero) për qind e rezervës së detyruar, për vlerën shtesë të këtyre detyrimeve të bankës që tejkalojnë nivelin 50 (pesëdhjetë) për qind të vlerës së raportit “detyrime në valutën përkatëse të përfshira në bazën e rezervës së detyruar ndaj të cilave nuk zbatohet norma 0 (zero) për qind e rezervës së detyruar/ totali i detyrimeve të përfshira në bazën e rezervës së detyruar ndaj të cilave nuk zbatohet norma 0 (zero) për qind e rezervës së detyruar”.

Banka duhet të mbajë rezerva minimale në Bankën Qëndrore me një periudhë mbajtje prej 1 muaj dhe mund të përdorë vetëm rezervën minimale në Lekë, me kusht që mesatarja e tepicës së rezervave në ditën e fundit të periudhës së mbajtjes të mos bjerë nën nivelin minimal të kërkuar të rezervës. Në veprimet e saj të përditshme Banka mund të përdorë deri në 70% të rezervës së depozitave, duke u siguruar që të mbahet niveli i kërkuar në fund të ditës për muajin raportues. Deri në 31 dhjetor 2025 vetëm monedha Lekë ka patur një normë interesi prej 2.5% (31 dhjetor 2024: 2.75%). Balancat e mbajtura në USD dhe EUR kanë në normë interesi 0%.

Llogaritë rrjedhëse me Bankën e Shqipërisë kanë një normë interesi prej 0%.

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore të Kosovës lidhur me rezervën e depozitave për qëllime likuiditeti, Banka duhet të mbajë minimumi 10% të depozitave të klientëve me afat maturimi deri në një vit, në Bankën Qendrore si llogari rezervë. Rezervat e detyrueshme përfaqësojnë instrumente me likuiditet të lartë, duke përfshirë paratë e gatshme, llogaritë në BQK, apo në bankat e tjera në Kosovë, dhe shumat e mbajtura në BQK nuk duhet të jenë më pak se gjysma e rezervave totale. Asetet me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat e saj për likuiditet janë depozitat në euro në BQK dhe 50% e ekuivalentit në euro të parave të gatshme në valuta lehtësisht të konvertueshme. Depozitat në BQK nuk duhet të jenë më pak se 5% e bazës së depozitave të aplikueshme.

17.1 Zhvlerësimi për shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore

Një analizë e ndryshimeve në vlerën e humbjeve të pritshme paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2025			
	Stadi 1	Stadi 2	Stadi 3	Totali
Gjendja më 1 Janar	50,991	-	-	50,991
Kalim në Stadin 1 (nga 2 ose 3)	-	-	-	-
Kalim në Stadin 2 (nga 1 ose 3)	-	-	-	-
Kalim në Stadin 3 (nga 1 ose 2)	-	-	-	-
Rimatja neto e humbjes	-	-	-	-
Aktive financiare të blera ose të origjinuara	6,483	-	-	6,483
Çrregjistrimi i aktiveve financiare	-	-	-	-
Të nxjerra jashtë bilanci	-	-	-	-
Ndryshime ne modelin/ parametrat e riskut	-	-	-	-
Ndryshime nga kursi këmbimit	-	-	-	-
Ndryshime në vlerën aktuale të zhvlerësimit	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor	57,474	-	-	57,474

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

17. Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore (vazhdim)

17.1 Zhvlerësimi për shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore

	31 dhjetor 2024			
	Stadi 1	Stadi 2	Stadi 3	Totali
Gjendja më 1 Janar	51,934	-	-	51,934
Kalim në Stadin 1 (nga 2 ose 3)	-	-	-	-
Kalim në Stadin 2 (nga 1 ose 3)	-	-	-	-
Kalim në Stadin 3 (nga 1 ose 2)	-	-	-	-
Rimatja neto e humbjes	-	-	-	-
Aktive financiare të blera ose të origjinuara	(943)	-	-	(943)
Çrregjistrimi i aktiveve financiare	-	-	-	-
Të nxjerra jashtë bilanci	-	-	-	-
Ndryshime nga kursi këmbimit	-	-	-	-
Ndryshime në vlerën aktuale të zhvlerësimit	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor	50,991	-	-	50,991

18 Hua dhe paradhënie bankave

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Banka dhe institucione e tjera financiare jo-rezidente	1,086,493	1,028,976
Në monedhë të huaj	1,086,493	1,028,976
Banka dhe institucionet e tjera financiare rezidente	1,199,034	2,009,020
Në lekë	950,853	1,827,438
Në monedhë të huaj	248,181	181,582
Totali i hua dhe paradhënie bankave, bruto	2,285,527	3,037,996
Zhvlerësimi HPK	(28,476)	(35,610)
Pakësuar: Interesi për tu arkëtuar	(7,525)	(4,835)
Hua dhe paradhënie bankave, neto	2,249,526	2,997,551

18.1 Zhvlerësimi për hua dhe paradhënie bankave

